RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

RAPORTI VJETOR I PUNËS
I RADIOTELEVIZIONIT TË KOSOVËS
PËR VITIN 2024

Prishtinë
Mars 2025

Përmbajtja

1.Hyrje 5

2. Përmbledhje ekzekutive 7

3.Korniza Ligjore.....9

4. Përshkrimi i Institucionit.....11

5. Fushëveprimi që e mbulon institucioni.....12

5.1 Përshkrimi dhe përbërja e Bordit të RTK-së.....12

5.2 Kompetencat e Bordit të RTK-së.....13

5.3 Drejtori i Përgjithshëm.....14

5.4 Drejtorët.....14

5.5 Kryeredaktorët.....15

5.6 Redaktorët 15

6. Aktiviteti për periudhën raportuese.....17

6.1 RTK1, RTK3, RTK4, RTK SAT 17

6.2 RTK1 18

6.2.1 Programet e përbashkëta 18

6.2.2 Programi i Mëngjesit.....19

6.2.3 Programi i pasdites 20

6.2.4 Redaksia e aktualiteteve 20

6.2.5 Redaksia ekonomike.....21

6.2.6 Redaksia sociale 21

6.2.7 Programi kulturor, edukativ dhe arsimor (PKADF) 22

6.2.8 Redaksia e programit arsimor-shkencor.....22

6.2.9 Redaksia e Dokumentarit.....23

6.2.10 Redaksia për fëmijë dhe të rinj 23

6.2.11 Redaksia për kulturë 24

6.2.12 Programi argëtues, muzikë, film dhe seri 25

6.2.13 Redaksia e sportit....26
6.2.14 Programi i komuniteteve....30
7. RTK2....38
8. Programi satelitor....43
9. RTK3....44
10. RTK4....47
11.TV-Produksioni RTK1, 3, 4....48
12. Tv – teknologjia....52
13.Radio Kosova....58
13.1 RADIO KOSOVA 1....60
13.2 PROGRAMET NË RADIO KOSOVA 1 GJATË VITIT 2024....63
13.2.1 Programi i mëngjesit....63
13.2.2 Emisioni "Morning show"....63
13.2.3 EMISIONI "METROPOL....64
13.2.4 Emisioni "Mesdita në radio"....64
13.2.5 EMISIONI "RADIO FOKUS"....64
13.2.6 Redaksia e dokumentarit dhe reportazhit....64
13.2.7 Redaksia e muzikës....65
13.2.8 Redaksia e sportit....65
14.Radio Kosova 2....67
14.1 Redaksia programit të mëngjesit....67
14.2 Redaksia për kulturë....67
14.3 Redaksia për fëmijë....67
14.4 Redaksia e programit të natës....67
14.5 Redaksia e komuniteteve....68
14.6 Produksioni dhe teknologjia....69
14.7 Digjitalizimi i arkivit....71

15. Shërbimi i administratës dhe burimeve njerëzore.....73

15.1 Struktura e të punësuarve – pasqyrë e përgjithshme 73

15.2 Bashkëpunëtorët e jashtëm.....75

15.3 Qendra e aftësimit profesional.....79

15.4 Siguria në punë 79

16. Mediet online 80

17. Departamenti i prokurimit 83

18. Zyra ligjore.....85

19. Shërbimi i Financave 86

20. Departamenti i Teknologjisë Informative (RTK-IT) 87

21. Departamenti për strategji dhe zhvillim (DSZH) 91

22. Departamenti për marrëdhënie ndërkombëtare dhe komunikim me publikun.....95

23. Departamenti i marketingut.....99

1.Hyrje

Fjala e Nënkryetarit të Bordit të RTK-së, z. Dardan Beqiri

Përgjatë vitit 2024, Bordi i RTK-së ka vazhduar të luajë rolin e tij drejtues si organ kolegjial në përputhje me kompetencat e tij, Ligjin e RTK-së dhe legjislacionin në fuqi. Gjatë marsit 2024, Bordi ka zgjedhur për kryetar Besnik Boletinin për një mandat të dytë. I njëjti, gjatë gushtit, ka dhënë dorëheqje nga pozita e kryetarit dhe anëtarit të Bordit. Krahas tij, dorëheqjen e kanë paraqitur edhe dy anëtarë të Bordit: Arta Berisha dhe Safet Kabashaj. Pozitën e nënkryetares së Bordit, gjatë vitit 2024 deri në muajin tetor, e ka mbajtur Albulena Mehmeti, muaj në të cilin e njëjta është zgjedhur kryetare, ndërsa në pozitën e nënkryetarit është zgjedhur Dardan Beqiri. Më 6 dhjetor, krahas kryetares Albulena Mehmeti, ka përfunduar mandatin edhe anëtarja e Bordit, Fatime Lumi Qehaja. Nga data 7 dhjetor, Bordi përbëhet nga nënkryetari Dardan Beqiri dhe anëtarët Biroll Urcan, Radojica Mrdjinac dhe Ilir Bytyçi. Meqenëse Bordi është organ kolegjial dhe, sipas dispozitave të Ligjit të RTK-së, "kuorumi i mbledhjeve të Bordit të RTK-së është gjashtë (6) anëtarë", nga kjo datë Bordi, duke mos pasur kuorumin për mbledhje, nuk ka pasur fuqinë të shqyrtojë,të konstatojë dhe rrjedhimisht të prodhojë vendime.

Megjithatë, periudha paraprake e vitit 2024 është karakterizuar nga një intensitet i lartë pune. Janë mbajtur 29 mbledhje dhe janë marrë 52 vendime/rekomandime me qëllim përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në RTK, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Paralelisht, janë ndërmarrë një sërë veprimesh dhe takimesh me synim zgjidhjen e sfidave të kahmotshme dhe të reja të RTK-së. Megjithatë, sfida të tilla si definimi i pronës dhe financimi mbeten edhe të pazgjidhura.

Objektet aktuale nuk ofrojnë kushte të përshtatshme për punë, rrjedhimisht shfaqen pengesa të përditshme në realizimin e punës. Po ashtu, RTK-ja përballet me nevojën e domosdoshme të transformimit teknologjik. Shumë nga pajisjet teknologjike tashmë janë të stërvjetruara. Një tjetër sfidë e trashëguar nga e kaluara janë borxhet e akumuluara ndër vite. Këto borxhe kanë ndikuar seriozisht këtë vit në angazhimin dhe përkushtimin e Bordit në rrugën e stabilizimit, reformimit dhe transformimit të RTK-së. Në të tilla kushte, aftësia konkurruese e RTK-së për të siguruar

kompeticione të mëdha sportive, si dhe produkte cilësore të jashtme (produksione të pavarura), është e cenuar seriozisht.

Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare, Bordi ka vazhduar t'i kushtojë një vëmendje të veçantë mbikëqyrjes së aspekteve financiare, duke synuar instalimin e një menaxhimi të përgjegjshëm dhe efikas të financave. Ky angazhim është realizuar përmes monitorimit të rreptë, sikundër janë ndërmarrë hapa për të përmirësuar mekanizmat e raportimit dhe kontrollit. Sikurse në vitin e kaluar, Bordi ka rikonfirmuar edhe për vitin 2024 angazhimin për të shtyrë përpara agjendën e reformimit të RTK-së me qëllim ndërtimin e një sistemi të drejtë dhe funksional, të bazuar në respektimin e plotë të ligjshmërisë; efikas, meritokratik, transparent dhe llogaridhënës. Në këtë drejtim, ka vazhduar procesi i rishikimit të rregullatives së brendshme ligjore. Bordi ka miratuar disa rregullore të reja, si dhe ka plotësuar dhe ndryshuar disa nga rregulloret ekzistuese, duke i harmonizuar njëkohësisht me legjislacionin primar. Po ashtu, ka vazhduar ta ndjekë qasjen proaktive në mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Plani i zbatimit të rekomandimeve ka zënë një vend qendror.

Në vazhdën e identifikimit dhe evidentimit të problemeve, mangësive, keqfunksionimeve dhe të tjera të ngjashme, përgjatë vitit 2024, anëtarët e Bordit kanë vazhduar të komunikojnë shqetësimet e tyre në lidhje me funksionimin e disa departamenteve, por dhe për disa fenomene dhe procese. Gjithashtu, kanë përshëndetur veprimet e mira dhe sukseset e RTK-së

Pavarësisht sfidave të shumta, Bordi ka vazhduar të mbetet i përkushtuar për të avancuar më tej rolin e RTK-së dhe pozicionimin e saj si lider mediatik për besueshmëri, që shërben si zë i qytetarëve dhe si një platformë që ndihmon në forcimin e demokracisë, promovon tolerancën, qytetarinë,diversitetin dhe barazinë.

Bordi i RTK-së, përmes mekanizmave të tij kontrollues - Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) dhe Komiteti i Auditimit (KA) - ka arritur ta rrisë nivelin e performancës dhe kontrollin e brendshëm të proceseve të punës në Transmetuesin Publik. Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2024 ka realizuar gjithsej 11 auditime, prej të cilave 1 ishte në proces. Në kuadër të këtyre angazhimeve janë dhënë 47 rekomandime për fuqizimin e kontrolleve të brendshme dhe përmbushjen e objektivave të përgjithshme. Komiteti i Auditimit gjatë vitit 2024 ka mbajtur 11 takime, duke filluar nga shqyrtimi i raporteve financiare, raporteve finale të NjAB-së, dokumenteve tjera relevante dhe duke zhvilluar intervista me zyrtarë përgjegjës brenda RTK-së. Gjatë këtyre takimeve janë diskutuar 24 pikat kryesore, nga të cilat kanë rezultuar 43

konkluza/rekomandime, të cilat pas çdo takimi u janë dërguar Bordit të RTK-së për veprime të mëtejme. Po ashtu, gjatë vitit 2024, për herë të parë është miratuar Statuti i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, i cili është harmonizuar me Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike. Nga dhjetori i vitit 2024, Komiteti i Auditimit funksionon vetëm me dy anëtarë, pasi mandati i anëtarit nga radhët e Bordit të RTK-së ka përfunduar. Për shkak të mungesës së plotë të Bordit të RTK-së ende nuk është i mundur emërimi i një anëtari të ri në Komitetin e Auditimit. Mekanizmi tjetër në varësi të Bordit, Grupi Këshillues i Publikut (GKP) gjatë vitit 2024 ka mbajtur 4 mbledhje, mandati i anëtarëve të këtij mekanizmi ka përfunduar përgjatë vitit 2024. Sikurse për çdo mekanizëm tjetër në varësi të Bordit, zgjedhja e anëtarëve të rinj të GKP-së, tashmë është i mundur vetëm pasi të plotësohen vendet vakante të anëtarëve të Bordit.

2. Përmbledhje ekzekutive

Nga: U.D. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, Hysen Hundozi.

Pavarësisht sfidave me të cilat është përballur gjatë vitit 2024, Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka demonstruar përkushtim të vazhdueshëm për të përmbushur mandatin e shërbimit publik, duke synuar të forcojë pozitën e vet si medium dhe burim parësor i informacionit për qytetarët e vendit.

RTK gjatë këtij viti ka pasur rol të rëndësishëm në mbulimin profesional të ngjarjeve të rëndësishme lokale dhe ndërkombëtare, përfshirë ato politike, ekonomike, kulturore, sociale dhe sportive. Një vëmendje e veçantë u kushtua mbulimit të ngjarjeve tradicionale vendore, si festivalet e trashëgimisë kulturore, manifestime artistike, aktivitete kombëtare dhe gara sportive vendore dhe ndërkombëtare që kanë zgjuar interes të gjerë të publikut. Një moment kulmor i këtij viti ishte organizimi me sukses i edicionit të dytë të Festivalit të Këngës në RTK, i cili u pozicionua si një prej projekteve më madhore muzikore dhe prodhuese të vitit.

Në aspektin e zhvillimit të përmbajtjes, RTK ka vijuar të zgjerojë ofertën programore në televizion, radio dhe platformat online, duke forcuar përmbajtjen kulturore, arsimore, dokumentare dhe edukative, si dhe programimin në gjuhët e komuniteteve joshumicë.

RTK1, si kanali kryesor i shërbimit publik, ka vijuar të ofrojë një program të balancuar dhe të gjithanshëm me fokus në informim, edukim dhe argëtim, duke garantuar përmbajtje cilësore për audiencën e gjerë. Përmes emisioneve informative, programeve të mëngjesit, aktualiteteve, dokumentarëve, programeve për fëmijë, kulturë, ekonomi, shkencdhe sport, RTK1 ka mbuluar me profesionalizëm temat më të rëndësishme që kanë prekur shoqërinë kosovare gjatë këtij viti.

RTK2, kanali televiziv që transmeton kryesisht në gjuhën serbe, ka vazhduar misionin e vet për ofrimin e programeve të dedikuara për komunitetet joshumicë, duke siguruar hapësirë për

shprehje të lirë, informim të balancuar dhe inkurajim të bashkëjetesës dhe mirëkuptimit ndëretnik. RTK3 ka konsoliduar më tej rolin si kanal informativ, duke ndjekur me kohë dhe profesionalizëm zhvillimet kryesore në Kosovë dhe rajon, ndërsa RTK4 ka vijuar t'i japë përparësi programimit kulturor dhe artistik.

Radio Kosova 1 dhe 2 kanë ruajtur vazhdimësinë në transmetimin e programeve të lajmeve, debateve shoqërore, emisioneve kulturore dhe atyre edukativo-arsimore, duke reflektuar diversitetin gjuhësor dhe kulturor të Kosovës dhe duke garantuar qasje për të gjitha grupet e audiencës. Në mënyrë të veçantë, Radio Kosova ka intensifikuar procesin e digjitalizimit të arkivit, përmirësimin e cilësisë teknike të transmetimit dhe ka siguruar ruajtjen e qëndrueshme të trashëgimisë mediatike të krijuar ndër vite.

Në aspektin teknologjik, RTK ka vazhduar procesin e modernizimit duke punuar në digjitalizimin e arkivave, modernizimin e pajisjeve dhe avancimin e infrastrukturës teknologjike, për të siguruar transmetim stabil dhe sipas standardeve të larta. Në veçanti, për Radio Kosovën janë ndërmarrë hapa konkretë drejt përmirësimit të infrastrukturës së transmetimit dhe sinjalit, duke lehtësuar qasjen e dëgjuesve dhe duke integruar praktika bashkëkohore në menaxhimin e përmbajtjes dhe shpërndarjen mediatike.

Në aspektin institucional, pavarësisht zhvillimeve të vazhdueshme në strukturat udhëheqëse të RTK-së, si pasojë e disa dorëheqjeve në Bord dhe Menaxhment, RTK ka arritur të ruajë funksionalitetin dhe të sigurojë vijueshmëri në ofrimin e shërbimit publik. Në të njëjtën kohë, në aspektin ligjor, RTK është angazhuar që të sigurojë respektimin dhe zbatimin e ligjshmërisë në çdo proces pune dhe vendimmarrjeje.

Nga aspekti financiar, edhe gjatë vitit 2024 RTK është përballur me mungesë të një buxheti optimal, çka ka ndikuar në ngadalësimin e planeve për zhvillim të mirëfilltë. Megjithatë, përkundër kësaj sfide, institucioni ka arritur të mbajë stabilitetin operativ dhe ka vijuar bashkëpunimin me transmetues publik ndërkombëtar dhe organizata si EBU, Bashkimi Evropian, Deutsche Welle, Instituti Goethe e JICA, duke forcuar partneritetet strategjike për shkëmbimin e njohurive dhe standardeve profesionale.

RTK, në kuadër të këtij angazhimi të përgjithshëm, ka vazhduar të mbetet zë i rëndësishëm edhe i komuniteteve joshumicë, duke ofruar program të balancuar dhe gjithëpërfshirës që synon promovimin e tolerancës ndëretnike, integrimin social dhe ruajtjen e kulturës e identitetit të komuniteteve në Kosovë. Me programin e vet specifik në gjuhët e komuniteteve, RTK ka përforcuar ndjeshëm rolin e vet si medium që pasqyron pluralitetin kulturor dhe gjuhësor të vendit.

Përtej sfidave të natyrës financiare dhe strukturore, RTK ka ndërmarrë hapa konkretë drejt avancimit të kapaciteteve teknologjike dhe integrimit të mjeteve të reja për prodhim,

shpërndarje dhe arkivim të përmbajtjes, duke shtruar bazat për një transformim të qëndrueshëm digjiital.

RTK mbetet e përkushtuar në forcimin e pavarësisë editoriale dhe zbatimin e standardeve etike dhe profesionale në gazetari, duke e konsideruar llogaridhënien ndaj publikut si shtyllë thelbësore të besueshmërisë së saj.

Përkundër sfidave evidente, RTK pret që gjatë vitit 2025 të ndodhë funksionalizimi i plotë i Bordit, plotësimi i të gjitha pozitave vakante menaxheriale, filimi i procesit të mirëfilltë të reformës organizative e programore si dhe të fillohet sa më herët trajtimi serioz i çështjes së financimit të qëndrueshëm dhe zgjidhjes së statusit të pronës së RTK-së — si parakusht kyç për avancimin e gjithanshëm të institucionit dhe për garantimin e një të ardhmeje stabile si shërbim publik i pavarur dhe me vlera demokratike.

Në epokën e konsumit të shpejtë të lajmeve dhe përmbajtjes, RTK është e vetëdijshme se transformimi digjital nuk është më vetëm opsion, por domosdoshmëri. Për këtë arsye, krahas digjitalizimit të arkivave dhe rritjes së pranisë në platformat online, RTK synon që në vitet në vijim të avancojë më tej strategjinë “digital-first”, duke forcuar platformën online dhe duke ofruar përmbajtje të personalizuara sipas nevojave të audiencës.

3.Korniza Ligjore

Baza ligjore e cila rregullon funksionimin e RTK-së:

Ligji nr.04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës;

Statuti nr.0001/22 i Radiotelevizionit të Kosovës i datës 16.01.2022 i Ndryshuar dhe Plotësuar me: Vendimin nr.0094/22 të datës 17.05.2022, Vendimin 0006/24 të datës 12.02.2024,

Ndryshim Plotësimi i Statutit të RTK-së nr.0008/24 të datës 12.02.2024, Vendimi nr.0031/24 të datës 13.05.2024 dhe Aneks Statuti i Radiotelevizionit të Kosovës me nr.0103/24 i datës 31.10.2024;

dhe

Rregulloret e Brendshme të RTK-së.

Përmirësimet e bazës ligjore gjatë vitit 2024:

Statuti nr.0001/22 i Radiotelevizionit të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me: Vendimin 0006/24 të datës 12.02.2024, Ndryshim Plotësimin e Statutit të RTK-së nr.0008/24 të datës 12.02.2024, Vendimin nr.0031/24 të datës 13.05.2024 dhe Aneks Statutin e Radiotelevizionit të Kosovës me nr.0103/24 i datës 31.10.2024;

Metodologjia e përcaktimit te ndërlikueshmërisë së vendeve te Punës 1363/18 i datës 26.10.2018 i Ndryshuar me Ndryshim Plotësimin 0131/24 të datës 28.11.2024;

Rregullore për Procedurat dhe Kriteret në Përzgjedhjen e Përmbajtjeve Audiovizuele me nr.1327/18 të datës 10.10.20218 i ndryshuar me Ndryshim Plotësimin nr.0029/24 të datës 07.05.2024;

Miratimi i Statutit për Funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm me nr.0009/24 i datës 12.02.2024

Miratimi i Rregullores së Festivalit të Këngës në RTK nr.0034/24 e datës 22.05.2024

Rregullore nr.0022/24 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në RTK e datës 25.04.2024 e ndryshuar me Ndryshim Plotësimin nr.0102/24 të datës 31.10.2024 dhe Ndryshim Plotësimin nr.0128/24 të datës 20.11.2024;

Miratimi i Marrëveshjes Kolektive e RTK -së nr.1998/24 e datës 09.09.2024.

Vështirësitë Ligjore:

Amendamentimi i Ligjit për RTK-në duhet të konsiderohet prioritet gjatë vitit vijues, në mënyrë që të rritet pavarësia dhe integriteti i Radiotelevizionit të Kosovës, të garantojë transparencë dhe të promovojë standardet më të larta profesionale në fushën e medias. Përfshirja e gjerë e akterëve në këtë proces, është e rëndësishme për të siguruar që ndryshimet e propozuara të reflektojnë nevojat dhe sfidat aktuale të transmetuesit publik.

Një pjese e rregullativës te brendshme duhet të plotësohen/ndryshohen dhe amandamentohen me rregullore të reja për shkak se disa prej tyre nuk janë në harmoni me ligjet aktuale të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

4. Përshkrimi i Institucionit

Radiotelevizioni i Kosovës është transmetues publik i Kosovës. RTK është person juridik joprofitabil, me status të institucionit të pavarur publik me rëndësi të posaçme, i cili i ofron shërbim publikut në fushën e veprimtarisë mediale, të përcaktuar me këtë ligj dhe aktet e tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore.



Aktualisht Radiotelevizioni i Kosovës përbëhet nga:

Dy (2) kanale të Radios dhe

Katër (4) kanale televizive, prej të cilave kanali i dytë (RTK TV 2) është kanal televiziv në gjuhën serbe.

Kanali televiziv RTK TV1 dhe RTK TV2 janë të detyruara të ndajnë 15% të skemës së tyre programore për gjuhët e komuniteteve të tjera të Kosovës. RTK ofron edhe programe satelitore për kosovarët që jetojnë jashtë Kosovës.

Transmetuesi Publik i Kosovës ka mision informues, edukues, kulturor dhe argëtues dhe detyrohet:

- të nxisë, të kultivojë, të avancojë, të prodhojë e të bashkëprodhojë të gjitha modalitetet dhe përmbajtjet e krijimtarisë audio-vizuale, të cilat i kontribuojnë zhvillimit dhe avancimit të kulturës, artit, shkencës dhe të gjitha vlerave të tjera sublime të qytetarëve te Kosovës dhe t`i afirmojë ato vlera jashtë Kosovës;

- të sigurojë kushte dhe mundësi për arritjet maksimale në krijimtarinë audio-vizuale;

- të përgatisë dhe të emetojë programe të tilla, që përshkohen me vlera, me të arritura profesionale dhe etike e që janë në përputhje të plotë me standardet dhe kodekset etike të gazetarisë hulumtuese, objektive, të lirë dhe të pavarur;

- t`i kontribuojë avancimit të demokracisë, lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të harmonisë e koekzistencës në Kosovë dhe më gjerë;

- të kultivojë respektin ndaj dinjitetit, integritetit dhe privatësisë së individit; nderit dhe mirëqenies socio-ekonomike të tij/saj;

- të sigurojë të drejtën e përgjigjes së qytetarëve të interesuar;

- të mos transmetojë programe me intonacione, qoftë edhe diskrete dhe as dykuptimëshe, sidomos të natyrës, animit dhe karakterit propagandues politik, fetar dhe/ose etnik.

- të veprojë sipas detyrimeve të përcaktuara me ligje të veçanta.

5. Fushëveprimi që e mbulon institucioni

Radio Televizioni i Kosovës përbëhet nga organet drejtuese dhe të udhëheqjes: Bordi i RTK-së dhe Drejtori i Përgjithshëm.

5.1 Përshkrimi dhe përbërja e Bordit të RTK-së

Bordi i Radio Televizionit të Kosovës është organ kolegjial - drejtues i transmetuesit publik. Ky organ përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë. Përbërja e Bordit të RTK-së pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Anëtarët e Bordit të RTK-së emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të procedurave të hapura dhe transparente, të cilat janë të përcaktuara me Ligjin për RTK-në, 2012/04-L-046.

Gjate vitit 2024, perberja e Bordit të RTK-së ka qene si ne vijim:

Përbërja e Bordit të RTK-së gjatë vitit 2024 ka qenë si në vijim:

1. **Birol Urcan** – Anëtar i Bordit (janar – dhjetor 2024);
2. **Dardan Beqiri** – Anëtar i Bordit (janar – shtator 2024); Zv. Kryetar i Bordit (tetor – dhjetor 2024);
3. **Radojica Mrdjinac** – Anëtar i Bordit (janar – dhjetor 2024);
4. **Ilir Bytyqi** – Anëtar i Bordit (shtator – dhjetor 2024);
5. **Albulena Mehmeti** – Zv. Kryetare e Bordit (janar – shtator 2024);Kryetare e Bordit (tetor – dhjetor 2024);
6. **Fatime Lumi Qehaja** – Anëtare e Bordit (janar – dhjetor 2024);
7. **Safet Kabashaj** – Anëtar i Bordit (janar – nëntor 2024);
8. **Arta Berisha** – Anëtare e Bordit (mars – nëntor 2024);
9. **Besnik Boletini** – Kryetar i Bordit (mars – nëntor 2024);
10. **Driton Hetemi** – Anëtar i Bordit (janar – maj 2024)

5.2 Kompetencat e Bordit të RTK-së

Bordi i Radio Televizionit të Kosovës (RTK) punën e vet e kryen në përputhje me dispozitat e Ligjit, Statutit të RTK-së, dhe Rregullores për Punën e Bordit. Kompetencat e Bordit të RTK-së janë të përcaktuara me Ligjit e RTK-së, konkretisht me nenin 29 janë:

• E aprovon statutin e RTK-së;

• E aprovon Rregulloren e punës së Bordit, si dhe rregulloret tjera të përcaktuara me Statut;

• Shqyrton dhe miraton programet, bazat dhe standardet programore në përputhje me politikën programore, ligjin dhe standardet ndërkombëtare të informimit publik sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm;

• Shqyrton dhe miraton projekt–programin e produksionit të RTK-së, i cili duhet të jetë në përputhje me mundësitë financiare të RTK-së; • Shqyrton dhe miraton Skemën e përgjithshme programore;

• Emëron dhe shkarkon Drejtorin e Përgjithshëm të RTK-së;

• Emëron dhe shkarkon zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm, drejtorët e Radiove dhe Televizioneve dhe udhëheqësin e Shërbimeve të Përbashkëta me shumicë të thjeshtë votash, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm;

• Miraton strukturën organizative dhe konceptin programor të RTK-së;

• Shqyrton dhe miraton buxhetin vjetor dhe skemën për pagat e menaxhmentit dhe të personelit tjetër dhe siguron që shpenzimet e RTK-së nuk i tejkalojnë burimet e tyre financiare. Buxheti i RTK-së është dokument publik, i cili pas shqyrtimit në Bord i adresohet themeluesit për shqyrtim dhe miratim;

• Shqyrton dhe publikon më së largu deri më 31 mars të çdo viti raportin financiar vjetor të të hyrave dhe të shpenzimeve për vitin paraprak të përgatitur nga menaxhmenti i RTK-së, i cili i nënshtrohet një auditimi të jashtëm të pavarur. Raporti në fjalë më pas i dërgohet Themeluesit për trajtim dhe veprim;

• Miraton planprogramin vjetor, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm, në përputhshmëri me ligjin dhe standardet ndërkombëtare dhe mandatin e RTK-së siç është përcaktuar me këtë ligj;

• Miraton Kodin e Mirësjelljes për RTK-në dhe siguron zbatimin efektiv të saj;

• Mbikëqyrë paanshmërinë, objektivitetin dhe saktësinë e informacionit në programin e RTK-së;

• Miraton kriteret kryesore profesionale për punësimin e personelit, politikave dhe procedurave të vlerësimit të përmbushjes së detyrave;

• Siguron që janë ndërmarrë masat korrigjuese pas konstatimit nga ana e tij ose KPM-së se ka pasur shkelje të standardeve, rregulloreve dhe ligjeve të aplikueshme; dhe

• Vendos edhe për çështje të tjera të rëndësishme në përputhje me autorizimet dhe kompetencat që ka me ligj dhe statut.

5.3 Drejtori i Përgjithshëm

Drejtorin e Përgjithshëm të RTK-së e emëron Bordi, në bazë të ligjit dhe sipas procedurave të caktuara, të parapara me konkurs publik. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së emërohet dhe shkarkohet me 2/3 e votave të anëtarëve të Bordit. Mandati i tij është tre (3) vjet, me mundësi të rizgjedhjes, në bazë të konkursit, vetëm edhe për një mandat pasues.

Bordi i RTK-së e zgjedh drejtorin e kanalit televiziv në gjuhën shqipe, drejtorin e kanalit televiziv në gjuhën serbe, drejtorin e Radios dhe udhëheqësin e Shërbimeve të Përbashkëta, në bazë të kualifikimeve profesionale, pas procesit të hapur dhe transparent të punësimit dhe duke marrë në konsiderim rekomandimin e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së.

5.4 Drejtorët

Drejtori i kanalit televiziv në gjuhën shqipe, drejtori i kanalit televiziv në gjuhën serbe si dhe drejtori i Radios e udhëheqin pjesën profesionale të programit të institucionit dhe harmonizojnë punën e kryeredaktorit. Drejtorët zgjidhen për tre (3) vjet, me mundësi të rizgjedhjes.

5.5 Kryeredaktorët

Secili kryeredaktor i RTK-së zgjidhet nga Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, në bazë të konkursit publik dhe sipas rekomandimit të drejtorit të kanalit televiziv në gjuhën shqipe, drejtorit të kanalit televiziv në gjuhën serbe si dhe drejtorit të Radios. Kryeredaktorët e RTK-së shkarkohen nga Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së, në pajtim me procedurat e përcaktuara me Statut. Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së i raporton Bordit në mënyrë të detajuar lidhur me procedurat dhe mënyrën e emërimit të kryeredaktorit.

5.6 Redaktorët

Me rekomandimin e kryeredaktorit, redaktorin përgjegjës dhe redaktorin e njësisë përkatëse programore e zgjedh dhe e shkarkon drejtori i kanalit televiziv në gjuhën shqipe, drejtori i kanalit televiziv në gjuhën serbe si dhe drejtori i Radios, me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm, në pajtim me procedurat e përcaktuara me Ligjin dhe Statutin e RTK-së.

Nivelet organizative

1	2	3	4	5
				SHERBIMET PUBLIKE
				RADIO DHE TELEVIZIONI I KOSOVES
				NJESIA PROGRAMORE
				SEKTORI
				PROGRAMI
				SHERBIMI
				REDAKSIA
				GRUPI, NJESIA
				VENDI I PUNES

NIVELI I PARË

RTK është një tërësi e vetme programore, ekonomike, teknike-teknologjike, punuese dhe organizative, e cila e kryen veprimtarinë e prodhimit dhe të emetimit të radioprogramit dhe atij televiziv me rëndësi për qytetarët e Kosovës, të përcaktuar në Ligjin për RTK-në. Drejtori i Përgjithshëm, në përputhje me ligjin, me rregullore dhe aktet e tjera, e organizon dhe udhëheq procesin e punës dhe punët e RTK-së.

NIVELI I DYTË

Njësia programore është një tërësi programore, punuese dhe funksionalisht e rrumbullakuar, në të cilën kryhen punët e ndërlidhura dhe të ndërvarura, të cilat e sigurojnë realizimin e programit dhe të funksioneve të tjera të përcaktuara me Ligjin për RTK-në.

Njësia programore është njësia redaktuese-programore e përbërë nga dy kanalet e Radios dhe katër kanalet e Televizionit, në të cilën, sipas rregullave, përfshihen fushat programore, siç janë programet dhe redaksitë.

Në sektorë janë të organizuara Shërbimet e Përbashkëta, ku hyjnë Financat, Burimet Njerëzore, Administrata dhe Zyra Ligjore.

NIVELI I TRETË

Programi është tërësia, në përbërje të njësisë punuese, e cila e siguron realizimin e programit të llojit dhe tematikës së caktuar. Programin mund ta përbëjnë disa redaksi. Në nivel të njësisë programore janë të organizuara Shërbimi Programor, Produksioni, Teknika dhe Mirëmbajtja. Në përbërjen e tyre janë sektorët apo grupet punuese.

NIVELI I KATËRT

Redaksia është një tërësi programore që siguron realizimin e emisioneve të llojit të caktuar të fushave tematike. Redaksia, në përbërjen e saj mund të ketë më shumë rubrika.

NIVELI I PESTË

Vendi i punës është niveli themelor i procesit të punës, përmbajtja e të cilit përcaktohet me tërësinë e detyrave të punës. Të gjitha vendet e punës janë të përshkruara me saktësi në Katalogun e vendeve të punës, i cili është pjesë përbërëse e Aktit mbi sistematizimin.

Burimet njerëzore

Tabela 1 – Burimet Njerëzore / Të punësuarit me kontrata të rregullta në RTK

Sektori/Shërbimi	**Numri i të punësuarve më 01. 01. 2024**	**Numri i të punësuarve më 01. 01. 2025**	**Ndryshimi**

Drejtoria - Menaxhmenti i lartë - Departamenti për strategji dhe zhvillim - Departamenti për marrëdhënie me jashtë dhe komunikim - Marketingu - Prokurimi - TI - Mediet Online - Auditori	**97** 5 8 6 14 11 20 29 4	**89** 4 7 6 12 9 18 29 4	**-08** -01 -01 0 -02 -02 -02 0 0
RTK 1 – TV	**312**	**305**	**-07**
RTK 2 - TV	**74**	**69**	**-05**
RTK 3 - TV	**73**	**68**	**-05**
RTK 4 - TV	**7**	**8**	**+01**
Radio Kosova	**132**	**122**	**-10**
Shërbimet e përbashkëta	**48**	**51**	**+03**
TOTALI	**743**	**712**	**-31**

6. Aktiviteti për periudhën raportuese

6.1 RTK1, RTK3, RTK4, RTK SAT

Radiotelevizioni i Kosovës, përmes tri kanaleve në gjuhën shqipe: RTK1, RTK3 dhe RTK4, e ka përmbushur në mënyrë optimale misionin e tij si transmetues publik në të gjitha fushat e veprimtarisë. Kjo është dëshmuar në raportimin e lajmeve ditore, në edicionet qendrore, në emisionet informative, si dhe në programet e ndryshme që mbulojnë fusha të tilla si arsimi, edukimi, shkenca, politika dhe kronikat e jetës nga të gjitha komunitetet.

Që nga periudha e verës, kur për herë të parë RTK ka prezantuar projektin veror kushtuar diasporës gjatë fundjavave, rrjedha e programeve është pasuruar më tej me transmetimin e festivaleve si: "Etno Fest", Festivali i "Teatrove", si dhe tradicionalisht, Seminari për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Gjithashtu, RTK ka transmetuar ndeshjet nga Liga e Kampionëve dhe Liga e Evropës, finalen e Superkupës së Evropës dhe Ligën e Kombeve. Një vlerë të veçantë ka pasur edhe transmetimi i qindra orëve live nga Lojërat Olimpike "Paris 2024".

Muaji tetor ka qenë veçanërisht dinamik dhe i mbushur me aktivitete. Ajo që e karakterizoi këtë muaj ishte Festivali i Këngës në RTK, edicioni i dytë me radhë, ku u angazhua shumica e stafit prodhues dhe profesional të televizionit. Sipas vlerësimeve, RTK e kaloi me sukses këtë duke organizuar në mënyrë të shkëlqyer eventin më të madh kulturor në vend.

Parafushata për zgjedhjet nacionale paraqiti sfida, por, sipas marrëveshjeve dhe kapaciteteve të saj, RTK u fokusua në mbulimin e ngjarjeve kryesore të liderëve politikë, konferencave të drejtpërdrejta në RTK3 dhe raportimin e ngjarjeve të rëndësishme përmes lajmeve të shkurtra. Është e rëndësishme të theksohet se emisionet e mëngjesit, ato të pasdites dhe programet magazinë ofruan përmbajtje të larmishme për të gjitha shijet, ndërsa mbulimi i mbledhjes së përbashkët të qeverive të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, përfshirë edhe intervistën me Kryeministrin e RMV-së, përbën një tjetër arritje për RTK-në.

Muaji dhjetor kulmoi me një gamë të gjerë aktivitetesh dhe programacionesh nga të gjitha rubrikat. RTK solli para audiencës një edicion të shkëlqyer të fundvitit, i cili u vlerësua pozitivisht nga publiku. Programi festiv për ndërrimin e viteve përfshiu mbi 70 orë transmetim, duke ofruar një mbrëmje të paharrueshme për shikuesit, me pjesëmarrjen e këngëtarëve nga të gjitha zhanret muzikore muzikë popullore, folklorike, jazz dhe rock që e pasuruan atmosferën festive.

Programi i RTK1 ka ndjekur me përpikëri skemën e rregullt programore, me fokus në zhvillimet politike brenda vendit, ndeshjet e futbollit, ngjarjet kulturore në diasporë, si dhe projektin më të ri: programin veror dedikuar komunitetit shqiptar jashtë vendit

6.2 RTK1

Viti 2024 ishte vit i pasur me zhvillime të shumta programore në Radio Televizionin e Kosovës (RTK) përveç programit të rregullt, viti 2024 ka qenë një periudhë intensiv dhe produktiv për Radio Televizionin e Kosovës (RTK), me një gamë të gjerë aktivitete dhe ngjarjesh të rëndësishme. Programet festive të fillimvitit dhe transmetimet për Ditën e Pavarësisë ishin disa nga angazhimet kryesore gjatë vitit. RTK gjithashtu mbuloi Lojërat Olimpike, duke ofruar transmetime të drejtpërdrejta dhe informacion të vazhdueshëm për publikun.

Një ngjarje e rëndësishme ka qenë Festivali i Dytë i RTK-së, ku pjesëmarrësit konkuruan me këngë garuese. Ky festival ka pasuruar programin e RTK-së me performanca të ndryshme. Po ashtu, RTK ka transmetuar ngjarje të rëndësishme si gjykatat speciale, duke siguruar që informacionet të arrijnë në kohë reale dhe me saktësi për publikun. Në përgjithësi, RTK ka ofruar një mbulim të gjerë dhe të detajuar të ngjarjeve, duke ruajtur cilësinë dhe besueshmërinë e përmbajtjes së saj.

6.2.1 Programet e përbashkëta

Gjatë vitit 2024, RTK ka mbuluar rregullisht skemën programore me përmbajtje vendore premierë, duke ruajtur një standard mesatar prej mbi 85% të skemës së përmbushur çdo muaj. Kulmi i transmetimeve vendore premierë u arrit në dhjetor me 87.26%, ndërsa më i ulëti ishte në korrik, për shkak të transmetimeve të Lojërave Olimpike.

6.2.2 Programi i Mëngjesit



Programi i Mëngjesit ka pasur rrjedhë normale gjatë gjithë vitit, duke u transmetuar 5 ditë pune me 2 orë e gjysmë program LIVE, derisa gjatë fundjavës me 2 orë program. Ndër temat që janë trajtuar janë aktivitet kulturore duke përfshi festivalet që janë organizua në vend si Festivalit i këngës në RTK, ReMusica, DokuFest, Sunny Hill, DamFestival, Komedia Fest, Chopin Piano Fest, BeerFest Kosova, Rame Lahaj, Ngom Fest, Etno Fest, PriFilm Fest, Anibar, etj.

Bisedat janë përqendruar edhe tek aktualiteti në vend, në fushën e arsimit, në ekonomi, politikë, personazhe interesant. Një hapësirë e konsideruar i dedikohet edhe shëndetësisë përmes rubrikës së rregullt të dielave "mjeku në studio". Pastaj tema sensibilizuese për shëndetin në përgjithësi, sidomos këtë vit kemi biseduar për shëndetin mendor. Gjithashtu janë mbuluar edhe konferencat e ndryshme që janë organizuar me temë mjekësinë.

Pjesë emisionit janë edhe lidhjet me skype nga Shqipëria, Maqedonia, Presheva, Evropa dhe ShBA. Gjithashtu ka pasur bashkëpunim edhe me kolegët nga RTSH në këmbim të kronikave nga ngjarje e tematika të ndryshme.

Në program janë pasqyruar edhe aktivitet e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë. Në vazhdimësi kemi lëvizur nëpër komunat e vendit, duke pasqyruar ngjarjet kryesore që kanë ndodhur. Deri në fund të vitit gjatë javës është realizuar edhe lidhje e drejtpërdrejtë me DW në Bon, si pjesë e bashkëpunimit RTK-DW.

Çdo ditë redaksia përgatitë edhe lajmet nga sportit. Gazetarët kanë përgatitur kronika që emitohen çdo ditë. Disa nga ato kanë qenë promovimi e traditave dhe kulturës, muze, shtëpitë të kulturës, puna e poçarit, muzetë në Kosovë, për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, të verbrit, për personat më sindromën down, autizmi, qendra për mbrojtjen e grave, për studentë, arkivi i Kosovës, veprat e artistëve. Kronika për ambientin, për mbeturina, digjitalizimi i shkollave, kujdesi për lulet, sera, parqet, astronomia, fitnes, klubet të gjimnastikës, boksit, karatesë, etj.

Ketë vit ka rinisur bashkëpunimin me programin e mëngjesit me Radio Kosovën një lidhje në ora 7 në mëngjes dhe me një skenografi të re. Gjatë verës programi është zhvilluar në ambient të hapur, por për shkak të temperaturave të larta dhe vonesës për studion e improvizuar ka qenë me shkurt se zakonisht.

6.2.3 Programi i pasdites

Pasdite janë trajtuar tema nga më të ndryshme, duke filluar nga kultura, arti, trashëgimia kulturore, sporti, tema sociale, tema për familjen, ekonomi, bujqësi, aktivitete të komunave, personazhe të ndryshme që kanë treguar suksese, si brenda dhe jashtë vendit, tema për të rinj, tema dedikuar raporteve gjinore, tema për lirinë e të shprehurit, tema që ndërlidhen me mjekësinë, me ditët e festave, gjithashtu një kujdes i veçantë i është kushtuar diasporës, ku ka pasur të ftuar nga shumë fusha.

Emisioni **"Pasdite"**, përpos emisioneve në studio, ka realizuar edhe emisione nga terreni si në vijim: **"Java e Çlirimit"; EtnoFest; HardhFest.** Gjithashtu Festivalet e kulturës: Festivali i Teatrit "Teatri i Hapur", në Prizren, "Festivali i Teatrit" në Suharekë (këto dy festivale janë mbuluar përmes ekipit të RTK-së në Prizren), Festivali i Teatrit në Mitrovicë "MITRIXFEST", është mbuluar me ekipin e RTK-së në Mitrovicë. Me lidhje të drejtpërdrejta janë mbuluar edhe festivali i Teatrit në Gostivar dhe festivali i Teatrit në Preshevë. Janë realizuar edhe lidhje të drejtpërdrejta nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, sidomos gjatë muajve veror, kemi pasur disa lidhje të drejtpërdrejta për turizmin veror nga Shqipëria dhe Mali i Zi.

Emri i emisionit	Numri i njësive	Numri i të intervistuarve	Sex/F	Sex/M	Tjera
Pasdite	239	785	312	473	-

6.2.4 Redaksia e aktualiteteve

REDAKSIA POLITIKE

"RTK PRIME "



Emisioni debatues i politikës është realizuar dhe transmetuar me rregull, përveç rasteve kur ka pasur ndryshime të skemës programore. Përmbajtja e emisionit nganjëherë ka pasur probleme konceptuale, por nga kryeredaktorët është vlerësuar në përputhje me standardet editoriale të RTK-së. Janë realizuar debate të shumta për aktualitetin politik dhe intervista me personalitete të ndryshme. Emisioni është transmetuar dy herë në javë, me përjashtim të rasteve kur ka pasur ngjarje me rëndësi dhe ka pasur edhe emision debatues.

6.2.5 Redaksia ekonomike

“EKONOMIKS”

Është realizuar me rregull dhe ka trajtuar me korrektësi aktualitetin ekonomik përmes intervistave, storieve etj. Emisionin është transmetuar me rregull, me përjashtim të rasteve kur ka pasur ndryshim të skemës programore. Emision i është realizuar në studio dhe në terren.

“TOKA”

Emisioni “Toka” është realizuar dhe transmetuar me rregull, me përjashtim të rasteve kur ka pasur ndryshim në skemën programore. Emisionet kanë trajtuar tema interesante nga terreni. Është njëri nga emisionet më të realizuara si në aspektin përmbajtësor, po ashtu edhe emancipues. Ky emision meriton zgjerim stafi dhe pajisje adekuate për realizimin e tij në terrene të vështira.



6.2.6 Redaksia sociale

“SENSE”

Emisioni është realizuar dhe transmetuar me rregull, me përjashtim të rasteve kur ka pasur ndryshime në skemën programore. Të ftuarit kanë qenë në përputhje me konceptin e emisionit.

“PORTA”

Emisioni “Porta” është realizuar dhe transmetuar me rregull, me përjashtim të rasteve kur ka pasur ndryshime në skemën programore. Janë trajtuar tema interesante për publikun. Në kuadër të emisionit të realizuar në studio, ka pasur edhe kronika nga terreni. Moderatorja është në pushim lehonie dhe kemi bërë ndryshim të vogël konceptual duke ju përshtatur moderatores së re.

“RTK GREEN”

Emisioni për mjedisin është emision i ri, i realizuar me rregull, me përjashtim kur ka pasur ndryshime në program. Tematika ka qenë e larmishme, ndërsa kryesisht është realizuar në studio. Nuk është arritur ende të realizohet tërë emisioni në terren për mungesë stafi dhe gazetarësh.



6.2.7 Programi kulturor, edukativ dhe arsimor (PKADF)

Njësia e PKADF-së përfshinë katër redaksi: Redaksinë e programit arsimor-shkencor; 2) Redaksinë dokumentare, 3) Redaksinë për kulturë; 4) Redaksinë për fëmijë dhe të rinj.

6.2.8 Redaksia e programit arsimor-shkencor

“RTK TECH” si vazhdimesi e emisionit MULTIMEDIA, edhe ne vitin 2024 ka vazhduar te transmetohet ne Radiotelelvizionin e Kosoves ne terminet e rregullta javore duke sjelle informacione, storje ekskluzive e tema te shumta inovative nga Shkenca, Teknologjia dhe Automobilizmi.



Disa prej emisioneve kane prezantuar inovacionet dhe risite e prezantuara nga kompanite dhe Start Up–et kosovare ne arenen vendore e nderkombetare, krejt kjo me qellim te promovimit te Kosovës si destinacion i ri për investime në teknologji dhe inovacion.

“ Kriter” cilat trajton emisioni nuk janë të kufizuara në nivele arsimore por prekin tematika që nga edukimi parashkollor deri në nivelin më të lartë arsimor atë të doktoraturës e specializimeve. Fokusi në këtë emisioni është paraqitja e gjendjes reale të secilës çështje që ndërlidhet me sistemin arsimor, ankesat e akterëve të përfshirë në këtë fushë, kërkesat për përmirësim të tyre, dhe përgjegjësinë e institucioneve arsimore përballë personave të përfshirë në sistemin edukativ-arsimor, qofshin nxënës, studentë apo personel arsimor. Në emisionin “KRITER” trajtohen edhe fenomene të cilat janë si pjesë negative e sistemit shoqëror arsimor apo e shoqërisë në përgjithësi, por gjithnjë me në qendër fushën e arsimit. E gjithë puna e emisionit realizohet në terren. Shtirja e terrenit është në të gjithë Kosovën, në secilën shkollë, në secilin qytete e fshat, madje edhe në rajon.

“Medika” Është emision që i dedikohet shëndetësisë dhe problematikave në këtë fushë. Emisioni relizohet në teren. “ Medika” është i konceptuar si emission këshilldhënës dhe informues për

specifika të shëndetit dhe trajtimin e problematikave nga ekspert shëndetësor. Emisioni nuk është i kufizuar në drejtime po trajton problëmatika nga secila fushë e shëndetësisë.

“ Voyage” Emisioni është konceptuar si emision kulturor- historik. Si I tillë emisioni trajton tema të ndryshme duke vënë theksin në ndryshimet që kanë sjellë ngjarjet e caktuara në evoluimin shoqëror. Emisioni realizohet në studio, me të ftuar nga fusha të ndryshme varësisht nga tematika që trajtohet.



6.2.9 Redaksia e Dokumentarit

“Gjurmë” -Në konceptin e “ Gjurmë” bazë patjetër që është misioni i mediumit publik për pasqyrim real, të pa anshëm dhe profesional të çdo teme që trajtohet.

“Paradigma” Emisioni ka në qendër një ngjarje aktuale (sociale) të veçanta që realizohen në një dimension më të gjerë. Ngjarjet e kaluara të cilat nuk kanë marrë trajtim meritor në media. Trajtohen tema me qëllim vetëdijesues për shoqërinë. Reportazhet realizohen tërësisht në teren dhe pa kufizim gjeografik.



“Arkivi” është emision i rregullt i RTK-së i konceptuar të sjellë materiale nga Arkivi me qëllim të pasqyrimit të së kaluarës dhe ndikimit e saj në të tashmen.

E risjellë reale përmes materialeve arkivore e kaluara trajtohet në këndvështime të ndryshme dhe dismensione ndikuese përmes akterëve të kohës apo risjellet si diskutim mbi të tashmen në emisionin “ Arkivi” .

6.2.10 Redaksia për fëmijë dhe të rinj

“Aventurat tona” - Emisioni “ Aventurat tona”, i konceptuar si emission atraktiv që i dedikohet kryesisht grup-moshës 05-10 vjeç tashmë ka krijuar identitet në programin e RTK-së, si emission i

rregullt javor. Emisionet realizohen me përkushtim dhe kujdes çdo herë duke pasur parasysh misionin edukativ dhe argëtues për fëmijët e moshave të vogla.

"Kutia magjike" - Kutia magjike,, është emision javor I rregullt në skemën programore të RTK-së, I konceptuar të përfshijë tema që I dedikohen grup moshës së fëmijëve të ciklit të ultë të lartë, respektivisht nga mosha 11 deri në moshën 14 vjeçare. Emisioni është I konceptuar të përfshijë tema kryesisht edukative-arsimore duke përfshirë të arriturat dhe talentet nga shkollat dhe procesi mësimor.

"NE" - është emision i rregullt javor i prodhuar nga Redaksia për Fëmije dhe të Rinj. Emisioni është I konceptuar të përfshijë tema që kanë të bëjnë me të rinjtë, gjithmonë duke pasur parasysh misionin edukativ.

"Tingujt magjik"- është emision muzikor, kryesisht përmban Festivalet e këngës për fëmijë nga Komunat e ndryshme, dhe po ashtu në kuadër të këtij emisioni përfshihen edhe prodhimet e RTK-së siç janë emisionet festive të Vitit të Ri dhe emisionet e realizuara me rastin e festive si Dita e Pavarësisë së Kosovës, 28 Nëntori etj.

6.2.11 Redaksia për kulturë



"**ArtTema**" është emission i rregullt në skemën programore të RTK-së. Është i konceptuar si magazinë javore kulturore, e cila mbulon ngjarjet javore të kulturës në Kosovë.

Në konceptin e kësaj magazine kulturore mbulohen e pasqyrohen ngjarjet kulturore të një jave, duke përfshirë, festivale të të gjitha lamive, shfaqje teatrore, ekspozita pikturash, filma, portrete artistësh të ndryshëm, prezantimin e kulturës sonë në botë nga artistë tanë të suksesshëm, koncerte muzikore etj.

"Autokton" - Është emision i konceptuar si emission që I dedikohet trashëgimisë kulturore të Kosovës është emission i rregullt në skemën programore të RTK-së. Emisioni realizohet tërësisht në terne në mbarë teritorin e Kosovës dhe sjell për audiencën fakte mbi ekzistencën e pasurive të ndryshme të trashëgimisë, shumë prej tyre ta pa trajtuara në aspektin medial më herët.Përveq kësaj " Autokton" tashmë i njohur për publikun është kthyer në një udhërrëfyes faktik për pasurinë e trashëgimisë kulturore në Kosovë.

“**Qyteti i librit”-** Është emision i konceptuar si përmbajtje që i dedikohet ekskluzivisht librit dhe botimeve duke sjellë për audiencën të rejat më të fundit dhe analiza të thukëta mbi fushën e letërsisë. Emisioni nuk i përmbahet një skeme rigoroze, por është i konceptuar si një bashkëbisedim i shikuesit me librin, autorët apo edhe problematikat e librit. Duke qenë se nuk është i konceptuar sipas një skeme të ngurtë, merr përsipër të variojë që nga portretet e shkrimtarëve, gjuhëtarëve apo albanologëve të ndryshëm, deri te promovimi i librave të rinj, duke përfshirë këtu edhe intervista me shkrimtarë e akademikë si dhe trajtimin e temave të ndryshme që kanë të bëjnë me problematikën e librit dhe botimeve. Në total nga Redaksitë e PKADF-së gjatë vitit 2024 janë realizuar e transmetuar mbi 547 përmbajtje televizive premierë.

6.2.12 Programi argëtues, muzikë, film dhe seri

Të tri redaksitë që funksionojnë në kuadër të Programit Argëtues, të cilat mbulojnë përmbajtjen argëtuese, muzikore, të serive dhe të filmave (PAMS), gjatë vitit 2024 i kanë përmbushur me sukses të gjitha obligimet e përcaktuara në rregulloret e punës dhe në planifikimin vjetor.

Gjatë vitit 2024, në kuadër të këtij programi janë realizuar dhe transmetuar mbi **216 emisione**, me më shumë se **354 të ftuar**, prej të cilëve **220 meshkuj** dhe **134 femra**. Në Redaksinë e Muzikës janë realizuar gjithashtu edhe koncerte me pjesëmarrje të gjerë të personazheve të ftuar, të cilët nuk janë evidentuar nominalisht.Përveç emisioneve të rregullta, janë përcjellë dhe përgatitur për transmetim një sërë aktivitetesh argëtuese dhe kulturore. Janë mbuluar të gjitha aktivitetet sipas kalendarit të **Filarmonisë së Kosovës**, **Baletit të Kosovës**, **Operës së Kosovës**, si dhe ato të **Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota"**. Ndër projektet më të veçanta përmendim **Koncertin Rama Lahaj & Friends**, si dhe **Koncertin e 50-vjetorit të karrierës së këngëtares Shkurte Fejza**, ndër të tjera.

Janë transmetuar gjithashtu edhe koncerte të muzikës klasike, të siguruara përmes programit të shkëmbimit të anëtarëve të **EBU**. Stafi i PAMS ka qenë i angazhuar edhe në projektet më të mëdha të RTK-së, siç janë **Festivali i Këngës në RTK**, **programi festiv i Vitit të Ri**, dhe **programi i verës**.

Gjatë vitit, RTK ka transmetuar edhe **Festivalin Evropian të Këngës "Euro Song"**, si dhe **Festivalin e Këngës në RTSH**. Në kuadër të bashkëpunimeve me **ambasadën norvegjeze dhe italiane**, janë siguruar disa filma për transmetim, si dhe dy seri italiane shumë të pëlqyera nga audienca: **"Cuori"** dhe **"Mina Settembre"**.

Po ashtu, janë transmetuar disa filma vendorë, të kontraktuar përmes shpalljeve publike për produkte audiovizuale. Si projekte të jashtme, janë transmetuar **30 njësi të emisionit "Rrënjët tona"**, si dhe **19 njësi të emisionit "Show i së Premtes"**

Redaksia e filmit dhe e serive

Janë realizuar dhe transmetuar 40 njësi premierë të emisionit javor "Telekino", si dhe aktivitete të tjera të kinematografisë botërore si për shembull "European Film Awards 2024"

Redaksia e argëtuese

Gjatë vitit 2024 në kuadër të kësaj redaksie emisioni "N'ZA" janë transmetuar 40 njësi. Sa i përket emisionit "Show i së Premtes" janë transmetuar 19 emisione.

Redaksia e muzikës

Gjatë vitit 2024 redaksia e muzikës ka transmetuar 107 emisione premierë me më shumë se 116 të ftuar,. Janë transmetuar nga 22 emisione dyjavore "RTK klasik" Po ashtu janë transmetuar dhe 21 emisione "Fjalë dhe Tinguj" Po ashtu gjatë vitit janë transmetuar 34 emisione "Rock N'BLLOK", Janë transmetuar edhe 30 emisione "Rrënjët tona". Po ashtu nga kjo Redaksi MCR është shërbyer në vazhdimësi me materiale muzikore për transmetim, si dhe ka pasur shumë aktivitete muzikore.

6.2.13 Redaksia e sportit

Në vitin 2024, RTK ka ofruar një përmbajtje të pasur dhe të larmishme në programin e saj të sportit, duke përfshirë disa ngjarje dhe iniciativa kryesore.

Lojërat Olimpike: RTK ka siguruar transmetime të drejtpërdrejta dhe analiza të thelluara të Lojërave Olimpike, duke ofruar mundësi të jashtëzakonshme për publikun kosovar për të ndjekur atletët e tyre në garat ndërkombëtare.

Specialet gjatë Kampionatit Evropian: Gjatë Kampionatit Evropian, RTK realizoi speciale dhe raporte të detajuara mbi zhvillimet dhe arritjet e skuadrave, duke përfshirë intervista dhe pasqyra të thelluara për ekipet dhe lojtarët.

Rikthimi i ndeshjeve të kombëtares së Kosovës në futboll: Pas një periudhe pauze, RTK riktheu transmetimet e ndeshjeve të Kombëtares së Kosovës, duke sjellë emocionet e ndeshjeve nëpër kualifikime dhe miqësore, duke mbështetur tifozët kosovarë.

Rikthimi i transmetimeve të UEFA Champions League, UEFA Europa League dhe UEFA Conference League: Pas 10 vitesh pauzë, RTK rinisi transmetimet e këtyre garave prestigjioze, duke ofruar mundësi për pasionantët e futbollit të ndjekin ndeshje të nivelit të lartë nga klubet evropiane.

Promovimi i Sportit Vendor: RTK ka vënë theksin në promovimin e sporteve të ndryshme lokale, duke transmetuar aktivitete dhe ndeshje të sporteve si futbolli, basketbolli dhe sportet dimërore, duke rritur dukshmërinë e atleteve dhe ngjarjeve sportive vendore.

Realizimi i Kuizit të Parë Sportiv në Historinë e Tregut Medial në Kosovë: RTK ka realizuar kuizin e parë sportiv, një iniciativë që ka tërhequr vëmendjen e publikut dhe ka ofruar një mundësi për të shpërndarë njohuri sportive dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e shikuesve.

Emisione të Rregullta Ditore dhe Javore: RTK ka mbajtur një kalendar të ngjeshur të emisioneve të rregullta, përfshirë ato ditore dhe javore, të cilat kanë pasqyruar zhvillimet e fundit në sport, intervista me sportistë dhe analiza të ndeshjeve.

Intervista dhe Materiale Ekskluzive: RTK ka ofruar intervista dhe materiale ekskluzive, duke sjellë histori të pasura dhe pamje të rralla nga prapaskenat e ngjarjeve sportive dhe duke i mundësuar shikuesve të njihen më thellë me sportistët dhe trajnerët e njohur.

Përmbyllja e dokumentarëve sportiv dhe puna me dokumentarët e rinj: RTK ka realizuar dhe përmbyllur serinë e dokumentarëve sportivë, duke ofruar pasqyra të thelluara mbi karrierat e sportistëve të njohur dhe ngjarje të paharrueshme, ndërkohë që ka filluar punën mbi dokumentarët e rinj që do të ofrojnë perspektiva të freskëta dhe inspiruese për sportin kosovar.

Ngjarjet sportive, sidomos ato të nivelit elitë botërore, gëzojnë shikueshmëri të jashtëzakonshme në audiencën në Kosovë. Si të tilla ato po ashtu shihen si produkte televizive, përmes së cilave biznese apo operatorë ekonomikë, mund të promovohen dhe kjo në mënyrë direkte ndikon në performancën e marketingut dhe segmenteve tjera organizative të organizimit të brendshëm të RTK-së.

Ngjarjet e Mbuluara: Emisioni ditor SportPLUS, Emisioni javor AS, IOC Lojërat Olimpike Paris 2024, UEFA EURO 2024 (emision special dhe mbulim ekskluziv), BASKETBOLL: BIBL Liga Ballkanike në basketboll, FUTBOLL: Kombëtarja e Kosovës dhe grupmoshat, FIFA Lojtari i Vitit (ceremonia vjetore), FUTSAL: Ndeshjet e Kombëtares dhe FC Prishtina 01, UEFA Champions League / Europa League / Conference League, VOLEJBOLL: Superliga e Kosovës te djemtë dhe vajzat, HENDBOLL: Kombëtaret A (djemtë & vajzat), HENDBOLL: Superliga, KOMITETI PARALIMPIK: Ngjarjet paralimpike “Lojërat paralimpike”, ATLETIKË: Maratona e Prishtinës, BOKS PROFESIONIST: BOKS OLIMPIK: Turnetë tradicionalë “Adem Jashari”, “Pavarësia”, “Lah Nimani”.

TRANSMETIMET E VEÇANTA

NDARJA E PRIORITETEVE: Sporti vendor, Sigurimi/Negocimi i ngjarjeve të mëdha sportive, Sporti për personat me nevoja të veçanta (lëvizja paralimpike), Sporti ndërkombëtar.

EKSKLUZIVITETET SPORTIVE

RTK gjatë vitit 2024 solli një numër të madh të ngjarjeve që u transmetuan ekskluzivisht vetëm në kanalin e RTK1, RTK2 dhe RTK4. RTK e ka bartur primatin e transmetuesit që ka kontribuuar më së shumti në: **1)** promovimin e aktiviteteve të sportit vendor, **2)** Rritjen e cilësisë, **3)** Luftimin e dukurive negative në sportin tonë, **4) B**artjen e barrës së transmetues vendas (host broadcaster) në ngjarjet e mëdha sportive të realizuara/prodhuara nga RTK.

Më poshtë janë disa prej ngjarjeve që lanë gjurmë në transmetimet dhe mbulueshmërinë nga ana e RTK-së për vitin 2024.

SPORTI VENDOR

Në vitin 2024, RTK realizoi një kalendar të pasur dhe shumë emocionues të transmetimeve sportive, duke sjellë ngjarje të rëndësishme dhe duke ofruar një pasqyrë të thelluar për zhvillimet kryesore në sportin ndërkombëtar dhe atë vendor.

200 Orë transmetim nga Paris 2024, ku Kosova fitoi dy medalje të tjera Olimpike: RTK ka pasur një angazhim të madh në Lojërat Olimpike të Parisit 2024, duke ofruar 200 orë transmetimi të drejtpërdrejtë dhe mbulim të detajuar të ngjarjeve. Kjo periudhë ka qenë e veçantë për sportin kosovar, pasi Kosova arriti të fitojë dy medalje olimpike të tjera, duke shënuar një arritje të madhe dhe duke bërë krenar kombin. Pjesëmarrësit dhe ekipet kosovare ishin në qendër të transmetimeve, me RTK që siguroi një mbulim të plotë të garave dhe momentet kulmore që e çuan ekipin olimpik të Kosovës drejt suksesit.

31 Emisione Speciale për UEFA Euro 2024: RTK realizoi 31 emisione speciale që u dedikuan plotësisht kampionatit evropian UEFA Euro 2024. Emisionet përfshinë analiza të thelluara, raporte nga vendet e ndeshjeve dhe intervista me lojtarët dhe trajnerët. Po ashtu, RTK siguroi mbulim të drejtpërdrejtë të ndeshjeve të Shqipërisë në këtë turne të madh, duke pasqyruar me pasion çdo ndeshje dhe duke ofruar kronika për të sjellë emocionet e shikuesve kosovarë dhe shqiptarë të gjithandej. Ky angazhim pati për qëllim rritjen e dukshmërisë së Kombëtares Shqiptare dhe pasqyrimin e saj në skenën ndërkombëtare.

Rikthimi i ndeshjeve të Kombëtares së Kosovës në futboll: Pas një periudhe pauze, RTK riktheu transmetimet e ndeshjeve të kombëtares së Kosovës në futboll, duke filluar nga ndeshjet miqësore deri te ato të UEFA Nations League. Pasi Kosova vazhdoi përparimin në garat ndërkombëtare, RTK ofroi mbulim të plotë të të gjitha ndeshjeve, duke mundësuar tifozët të shijojnë performancat e ekipit në përpjekjet për të siguruar një vend në garat e ardhshme dhe duke promovuar talentet e reja.

Rikthimi i transmetimeve të ndeshjeve nga UEFA Champions League, UEFA Europa League dhe UEFA Conference League: Pas 10 vitesh pauzë, RTK u rikthye me transmetimet e ekskluzive të ndeshjeve nga UEFA Champions League, UEFA Europa League dhe UEFA Conference League, duke ofruar mundësinë për shikuesit të ndjekin ndeshjet kryesore të xhiros. RTK kishte të drejtën e përzgjedhjes së ndeshjeve më emocionuese të këtyre turneve prestigjioze, duke ofruar një pasqyrë të detajuar të futbollit europian për tifozët kosovarë dhe për të gjithë ata që ndjekin sportin me pasion.

Realizimi i kuizit të parë sportiv në historinë e tregut medial në Kosovë: Për herë të parë në historinë e tregut medial të Kosovës, RTK realizoi një kuiz sportiv që tërhoqi vëmendjen e një audiencë të gjerë. Ky kuiz ishte një mundësi unike për të sfiduar njohuritë e shikuesve mbi sportet dhe për të ofruar shpërblime dhe mundësi për angazhimin e audiencës. Me këtë iniciativë, RTK krijoi një platformë të re dhe emocionuese që kontribuoi në zhvillimin dhe popullarizimin e kulturës sportive në Kosovë.

Në këtë vit të mbushur me ngjarje të rëndësishme, RTK ka realizuar një program të pasur që ka përfshirë transmetime të drejtpërdrejta, emisione speciale, ndeshje ekskluzive dhe iniciativat që kanë pasuruar përmbajtjen e saj sportive, duke kontribuuar në zhvillimin dhe promovimin e sportit në Kosovë dhe përtej saj.

FUTBOLL

RTK gjatë vitit 2024 ka sjellë ngjarje të shumta nga paketa e marrëveshjeve me UEFA-n, sipas së cilës kemi transmetuar UEFA Champions League, UEFA Europa League dhe UEFA Conference League.

Poashtu janë transmetuar ndeshjet e Kombëtares së Kosovës në futboll, në UEFA Nations League si dhe ndeshjet miqësore.

VOLEJBOLL

Bartja e së drejtës televizive për transmetimin ekskluziv dhe promovimin e sportit të vajzave, përmes hapësirës dhënë Superligës së Volejbollit. Të njëjtin ekskluzivitet RTK e pati edhe te Superliga e djemve. RTK ishte bartës i së drejtës ekskluzive për Ligën Gjergj Kastrioti, një format i ri i ligës nga bashkëpunimi ndërmjet Federatave të Volejbollit nga Kosova e Shqipëria.

BASKETBOLL

BIBL: Liga Ballkanike: Transmetimet e KB Sigal Prishtina në transmetimet e sezonit të ri të Ligës Ballkanike 2023/24

HENDBOLL: KOMBËTARET

Kombëtaret A (djemtë dhe vajzat) në fushatat e tyre kualifikuese IHF Kampionatet Botërore apo EHF Kampionatet Evropiane, ishin ekskluzivitet i RTK-së

ATLETIKË: MARATONA E PRISHTINËS

Mbulimi për 100% i shtegut të Maratonës së Prishtinës (42 km), me 3 ekipe mobile dhe me studio të improvizuar në START/FINISH para Teatrit Kombëtar

BOKS: NGJARJET E RINGUT PROFESIONIST

Sigurimi i transmetimeve të drejtpërdrejta të ngjarjeve më të mëdha të boksit, përfshirë edhe serinë “The show must go on”, ku në partneritet me FIDES Sports, RTK i ka transmetuar ekskluzivisht mbrëmjet e boksit profesionist.

SPORTI PARALIMPIK (PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA) - RTK PARTNER I AKTIVITETEVE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Programi i Sportit në RTK, edhe në vitin 2024 mbetet partneri i vetëm i Komitetit Paralimpik të Kosovës në vendin tonë dhe transmetuesi që më së shumti i ka dhënë hapësirë sportistëve me aftësi të kufizuara, duke kontribuuar përmes transmetimeve të drejtpërdrejta, kronikave dhe formave tjera në promovimin e vlerave të kësaj shtrese të shoqërisë

FIFA LOJTARI I VITIT

RTK e pati ekskluzivitetin e transmetimit të ngjarjes gala të Lojtarit të Vitit.

NGJARJET BOTËRORE SPORTIVE NË RTK

NEGOCIMI I MARRËVESHJES ME EBU CHANNEL PËR SIGURIMIN E LOJËRAVE OLIMPIKE NË CIKLIN 2026-2032

Programi i Sportit në RTK-TV ka qenë në linjën e parë të udhëheqjes së negociatave për sigurimin e së drejtës televizive për Lojërat Olimpike në cikin 2026-2032. Ngjarjet në të cilat Kosova potencialisht mund të fitojë medalje tjera olimpike, do të shënojnë një tjetër gjurmë rekordi, duke i dhënë RTK-së të drejtën për transmetimin e 4 Lojërave të ardhshme olimpike (2 verore dhe 2 dimërore)

SPORTI DHE MULTIMEDIA

Përmes iniciativës së Programit të Sportit, është siguruar që gjatë FIFA Kupës së Botës në futboll, të ketë funksionim dhe bashkëveprim në sinkron mes Televizionit, Radios dhe medieve online. Kronikat e sportit, qoftë kur jepen edhe si të ndara e jo si emisione në tërësi, tërheqin vëmendje dhe bëhen virale, duke qenë produkt me potencial të madh të kontributit edhe te sektori i medieve online.

6.2.14 Programi i komuniteteve

Programi i komuniteteve gjatë vitit 2024 është realizuar me sukses, pavarësisht sfidave në procesin e punës. Gazetarët dhe redaktorët kanë treguar punë profesionale e të palodhshme në të gjitha fazat e punës, gjatë raportimit dhe realizimit të emisioneve informative në të gjitha fushat: politikë, arsim, shëndetësi, mirëqenie dhe ekonomi. Gjatë pjesës së dytë të vitit, nga gushti 2024 nuk është realizuar magazina “Nedeljni kolaz”, për shkak të mungesës së stafit në redaksinë serbe dhe pas shkuarjes në pushim të lehonisë edhe të redaktores Mirjana Marinkovic.
Programi i Komuniteteve në RTK 1 gjatë vitit 2024 ka realizuar me sukses edhe edicionet e lajmeve çdo ditë pune në katër gjuhë (serbe, turke, boshnjake dhe rome), me kronika të përgatitura në terren dhe lajme nga vendi, rajoni dhe bota si dhe magazinat javore të shtatë (7) komuniteteve. Konsideroj se me punë të mirë, elan dhe gatishmëri përtej përmbushjes së kontratve të tyre, stafi i ka kryer punën komfor standardeve dhe misionit të transmetuesit publik, duke u fokusuar në nevojën dhe kërkesat e audiencës për informim të drejtë dhe të shpejtë.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar gjithsej **313emisione javore / magazina** të shtatë redaksive, në të gjitha gjuhët e komuniteteve, në emisionet: Mozaik (në gjuhën turke), Mostovi (në gjuhën boshnjake), Jekiphe (në gjuhën rome), Nedeljni Kolaz (në gjuhën serbe), Zëri i Ashkalinjve (në gjuhën shqipe), Ora Egjiptiane (në gjuhën shqipe) dhe Svetlo Gore (në gjuhën gorane).

Të gjitha emisionet janë transmetuar premierë dhe nuk ka pasur asnjë reprizë. Këto magazina janë dominuar me tema nga fusha të ndryshme, nga ato të politikës (dialogu me Serbinë, procesi i integrimit, liberalizimi, çështjet ekonomike e të tjera). Në këto magazina vend të rëndësishëm kanë zënë kronika dhe reportazhe me temë nga fusha e arsimit (gjendja nëpër shkolla me klasë në gjuhë të komuniteteve, raporti i Pisa-s, pasojat dhe ndikimet në aspektin psikologjik te fëmijët), pastaj tema të shëndetësisë, por edhe tema tjera nga kultura e sporti.

Në emisionet 45-minutëshe të redaksive serbe, turke, boshnjake dhe rome **"Mostovi", "Mozaik", "Jekiphe" dhe "Nedeljni kolaz"** ka pasur intervista, reportazhe dhe kronika me tema të ndryshme aktuale, të trajtuara në mënyrë profesionale nga të gjitha segmentet, politika, arsimi, ekonomia, kultura dhe sporti. Të gjitha këto redaksi, të cilat përbëhen nga nje staf i limituar (4 deri 5 persona) gjatë tërë vitit kanë punuar me numër të kufizuar të stafit, pasi kishte mungesa, si pushime të lehonisë, pushime shëndetësore dhe të tjera.
Në emisionet javore 15-20 minutëshe **"Ora egjiptiane"** dhe **"Zëri i ashkalinjve"** (të komunitetit egjiptian dhe ashkalinj) janë trajtuar tema që i preokupojnë pjesëtarët e këtyre komuniteteve. Janë përgatitur kronika me tema sociale dhe nga ekonomia, pasi të gjitha të dhënat dhe sondazhet tregojnë se ajo duhet të jetë prioritet për një të ardhme më të mirë të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve, sidomos për shkak të gjendjes më të vështirë sociale të pjesës dërrmuese të tyre. Në këto redaksi janë realizuar edhe tema për çështjen e arsimit, si kronika dhe debate kundër fenomeneve negative prezente (si diskriminimi, lufta kundër dhunës ndaj grave, antigjipsizmi, martesave të hershme dhe dukurive të tjera negative) por nuk kanë munguar ngjarjet me tema të tjera aktuale, si nga politika, sporti dhe kultura.
Në emisionin dyjavor **"Svetlo Gore"** të redaksisë gorane, i cili i dedikohet këtij komuniteti, janë përgatitur kronika dhe reportazhe në lokalitetin e Gorës, në komunën e Dragashit, ku graviton pjesa më e madhe e komunitetit. Kanë dominuar tema për zhvillimin të turizmit rural, për mangësitë në infrastrukturën rrugore, tema për arsimin, shëndetësinë, pozitën e gruas dhe reportazhe për traditën e komunitetit.

Mbulimi i ditëve nacionale të komuniteteve

Edhe gjatë 2024-s, Programi i Komuniteteve në RTK1 ka mbuluar (transmetuar) ceremonitë nga Ditët Nacionale të të gjitha komuniteteve (7), të organizuara nga Zyra për Komunitete pranë Kryeministrisë, kurse në magazinat javore të të shtatë redaksive në këto gjuhë u është dhënë hapësirë këtyre ngjarjeve të rëndësishme për çdo komunitet.

Sfidat e programit të komuniteteve

Programi i komuniteteve, gjatë vitit 2024, është ballafaquar me problemin e stafit të pamjaftueshëm në disa redaksi. Ndonëse para gati tri viteve RTK ka rekrutuar tri folëse në redaksitë e Ashkalinjve, Egjiptianëve dhe Goranëve (më parë të punësuara në këto redaksi me

kontrata mbi vepër) ka vështirësi në funksionim e këtyre redaksive, pasi stafi përbëhet nga vetëm një person. Problem tjetër i pazgjidhur është se ato kanë mbetur akoma me kontrata të folëseve. Prandaj, si nevojë e menjëhershme shtrohet rritja e stafit aktual në këto redaksi, si dhe rregullimi i kontratave të bartësve të emisioneve "Zëri i Ashkalinjve", "Ora Egjiptiane" dhe "Svetlo Gore", pasi drejtueset e këtyre emisioneve kryejnë edhe punën në terren dhe kujdesen deri në finalizimin e emisionit për transmetim. Si rrjedhojë, shihet e udhës që t`u njihet kontributi faktik dhe kontratat e tyre të ndryshohen nga folëse në gazetare-moderatore.

Nevojat për ndryshim

Në redaksinë serbe, për tri vite ka mungesë të një gazetari, një gazetare ka ndërprerë në mënyrë të njëanshme kontratën, për çka viti 2025 e gjen këtë redaksi me mungesë stafi, ndërsa shkuarja sërish në pushim të lehonisë të redaktores Mirjana Marinkoviq (nga mesi i vitit 2024) e ka vështirësuar edhe më shumë punën në këtë redaksi. Edhe në redaksitë e tjera ka pasur mungesë të stafit për shkak të pushimit të lehonisë (redaksia serbe dhe rome), të pushimeve mjekësore (sëmundjeve kronike gati në të gjitha redaksitë). Kjo ka ndikuar që kapacitetet aktuale të shfrytëzohen maksimalisht për të realizuar të gjitha emisionet/magazinat dhe edicionet e lajmeve në gjuhë të ndryshme. Edhe pas përmirësimit të kushteve në procesin e punës në Dhomën e Lajmeve (pajisja me kompjuterë të rinj dhe rinovimi i saj), stafi ka adresuar ankesa për mungesë të njësive të montazhit dhe të numrit të vogël të montazherëve, por edhe mungesës së kamerave për punë në terren. Edicionet e lajmeve në 4 gjuhë, por edhe moderimi i magazinave javore ka vazhduar të bëhet në një kënd të papërshtatshëm, në studio 2 e kohëve te fundit në studio 1, prandaj është më se e nevojshme një kënd me skenografi të veçantë, pra një hapësirë për programin e komuniteteve, gjë që do të ishte zgjidhje e qëndrueshme.

Programi festiv i komuniteteve

Gjatë pjesës së parë të muajit Dhjetor është planifikuar, përgatitur, shkruar skenari dhe është xhiruar **Programi festiv i komuniteteve**, në kohëzgjatje prej 1 orë e 20 minuta, ku janë përfshirë të gjitha komunitetet në një program të përbashkët e të larmishëm festiv. Ky është viti i tetë që realizohet projekti i programit të përbashkët, i cili shquhet me diversitetin gjuhësor, me moderim në disa gjuhë, me këngë të grupeve dhe këngëtarëve nga shumë komunitete, në lidhje me trashëgimin, identitetin, kulturën dhe specifikat e secilit komunitet. Programi festiv i komuniteteve ka përmbushur standardet profesionale dhe nevojën që komunitetet të kenë hapësirën e tyre edhe në programin festiv të RTK-së. Ky program, me urime e thirrje për paqe, dëshira për paqe dhe barazi për të gjithë është mirëpritur nga publiku. Ka reagime shumë pozitive, është rritur shikueshmëria në RTK YouTube, por kemi marrë lëvdata përmes emailave, telefonatave dhe SMS inkurajues.

Tabelat e emisioneve javore, numri i emisioneve, numri i të intervistuarve dhe gjinia e tyre.

Raportit vjetor të programit të komuniteteve i shtohen edhe tabelat e numrit të emisioneve/magazinave javore në gjuhët e komuniteteve, në të cilat është nxjerrë numrit i të intervistuarve dhe i gjinisë së tyre, dhe nga cili vihet re se edukimi si mision i transmetuesit publik është shumë i rëndësishëm, e kjo vihet re edhe në përfaqësimin e grave në emisionet tona.

MAGAZINAT JAVORE TË PROGRAMIT TË KOMUNITETEVE – JANAR 2024									
Emisionet	**Njësi**	**Xhirim**	**Live**	**Të intervistuar**	**M**	**F**	**Fëmijë**	**Kronika**	**Lidhje LIVE**
MOZAIK **(J)**	4	4	1	45	31	9	5	-	-
NEDELNJI KOLAŽ **(J)**	4	4	1	48	36	10	2	-	-
MOSTOVI **(J)**	4	4	1	69	46	23	-	-	-
JEKHIPE **(J)**	4	4	1	26	17	9	-	-	-
ORA EGJIPTIANE **(J)**	4	4	-	20	15	4	-	-	-
ZËRI i ASHKALINJVE **(J)**	4	4	-	26	19	7	-	-	-
SVETLO GORE **(D-J)**	2	2	-	12	5	7	-	-	-
TOTAL	**26**	**26**	**-**	**226**	**170**	**69**	**7**	**-**	**-**

Shënim: Emisionet ditore janë të shënjuara me (D), javore me (J) dhe emisionet dyjavore me (D-J)

MAGAZINAT JAVORE TË PROGRAMIT TË KOMUNITETEVE – SHKURT 2024									
Emisionet	**Njësi**	**Xhirim**	**Live**	**Të intervistuar**	**M**	**F**	**Fëmijë**	**Kronika**	**Lidhje LIVE**
MOZAIK **(J)**	4	4	1	61	47	11	3	-	-
NEDELNJI KOLAŽ **(J)**	4	4	1	75	56	19		-	-
MOSTOVI **(J)**	4	4	1	38	27	11	-	-	-
JEKHIPE **(J)**	4	4	1	29	27	2	-	-	-
ORA EGJIPTIANE **(J)**	4	4	-	12	6	6	-	-	-
ZËRI i ASHKALINJVE **(J)**	4	4	-	27	22	5	-	-	-
SVETLO GORE **(D-J)**	2	2	-	25	25		-	-	-
TOTAL	**26**	**26**	**-**	**267**	**210**	**54**	**3**	**-**	**-**

Shënim: Emisionet ditore janë të shënjuara me (D), javore me (J) dhe emisionet dyjavore me (D-J)

MAGAZINAT JAVORE TË PROGRAMIT TË KOMUNITETEVE – MARS 2024									
Emisionet	**Njësi**	**Xhirim**	**Live**	**Të intervistuar**	**M**	**F**	**Fëmijë**	**Kronika**	**Lidhje LIVE**
MOZAIK **(J)**	4	4	1	59	48	11	-	-	-
NEDELNJI KOLAŽ **(J)**	4	4	1	53	36	13	4	-	-
MOSTOVI **(J)**	5	5	1	74	45	29	-	-	-
JEKHIPE **(J)**	5	5	1	28	20	8	-	-	-
ORA EGJIPTIANE **(J)**	5	5	-	22	19	3	-	-	-
ZËRI i ASHKALINJVE **(J)**	5	5	-	27	12	15	-	-	-
SVETLO GORE **(D-J)**	3	3	-	25	24	1	-	-	-
TOTAL	**31**	**31**	**-**	**288**	**204**	**80**	**4**	**-**	**-**

Shënim: Emisionet ditore janë të shënjuara me (D), javore me (J) dhe emisionet dyjavore me (D-J)

MAGAZINAT JAVORE TË PROGRAMIT TË KOMUNITETEVE – PRILL 2024									
Emisionet	**Njësi**	**Xhirim**	**Live**	**Të intervistuar**	**M**	**F**	**Fëmijë**	**Kronika**	**Lidhje LIVE**
MOZAIK **(J)**	5	5	-	55	39	5	11	-	-
NEDELNJI KOLAŽ **(J)**	5	5	-	80	28	39	13	-	-
MOSTOVI **(J)**	4	4	-	43	36	7	-	-	-
JEKHIPE **(J)**	4	4	-	32	27	5	-	-	-
ORA EGJIPTIANE **(J)**	4	4	-	22	17	5	-	-	-
ZËRI i ASHKALINJVE **(J)**	4	4	-	18	13	4	1	-	-
SVETLO GORE **(D-J)**	2	2	-	7	6	1	-	-	-
TOTAL	**28**	**28**	**-**	**257**	**166**	**66**	**25**	**-**	**-**

MAGAZINAT JAVORE TË PROGRAMIT TË KOMUNITETEVE – MAJ 2024									
Emisionet	**Njësi**	**Xhirim**	**Live**	**Të intervistuar**	**M**	**F**	**Fëmijë**	**Kronika**	**Lidhje LIVE**
MOZAIK **(J)**	4	4	-	35	30	5	-	-	-
NEDELNJI KOLAŽ **(J)**	4	4	-	37	28	5	4	-	-
MOSTOVI **(J)**	5	5	-	73	60	13	-	-	-
JEKHIPE **(J)**	4	4	-	21	19	2	-	-	-
ORA EGJIPTIANE **(J)**	4	4	-	22	18	4	-	-	-
ZËRI i ASHKALINJVE **(J)**	4	4	-	18	15	3	-	-	-
SVETLO GORE **(D-J)**	2	2	-	12	7	3	2	-	-
TOTAL	**27**	**27**	**-**	**196**	**158**	**32**	**6**	**-**	**-**

Shënim: Emisionet ditore janë të shënjuara me (D), javore me (J) dhe emisionet dyjavore me (D-J)

MAGAZINAT JAVORE TË PROGRAMIT TË KOMUNITETEVE – QERSHOR 2024									
Emisionet	**Njësi**	**Xhirim**	**Live**	**Të intervistuar**	**M**	**F**	**Fëmijë**	**Kronika**	**Lidhje LIVE**
MOZAIK **(J)**	4	4	-	65	53	12	-	-	-
NEDELNJI KOLAŽ **(J)**	4	4	-	40	29	8	3	-	-
MOSTOVI **(J)**	4	3	1	52	35	17	-	-	-
JEKHIPE **(J)**	4	4	-	45	28	17	-	-	-
ORA EGJIPTIANE **(J)**	5	5	-	20	12	8	-	-	-
ZËRI i ASHKALINJVE **(J)**	5	5	-	18	11	7	-	-	-
SVETLO GORE **(D-J)**	3	3	-	36	32	4	-	-	-
TOTAL	**29**	**28**	**1**	**275**	**199**	**73**	**3**	**-**	**-**

Shënim: Emisionet ditore janë të shënjuara me (D), javore me (J) dhe emisionet dyjavore me (D-J)

MAGAZINAT JAVORE TË PROGRAMIT TË KOMUNITETEVE – KORRIK 2024									
Emisionet	**Njësi**	**Xhirim**	**Live**	**Të intervistuar**	**M**	**F**	**Fëmijë**	**Kronika**	**Lidhje LIVE**
MOZAIK **(J)**	5	5	-	39	28	11	-	-	-
NEDELNJI KOLAŽ **(J)**	-	R	-	40	29	8	3	-	-
MOSTOVI **(J)**	4	4	-	55	41	14	-	-	-
JEKHIPE **(J)**	4	4	-	27	20	7	-	-	-
ORA EGJIPTIANE **(J)**	4	4	-	13	10	3	-	-	-
ZËRI i ASHKALINJVE **(J)**	4	4	-	19	13	6	-	-	-
SVETLO GORE **(D-J)**	2	2	-	14	10	4	-	-	-
TOTAL	**28**	**22**	**-**	**207**	**151**	**53**	**3**	**-**	**-**

MAGAZINAT JAVORE TË PROGRAMIT TË KOMUNITETEVE – GUSHT 2024									
Emisionet	**Njësi**	**Xhirim**	**Live**	**Të intervistuar**	**M**	**F**	**Fëmijë**	**Kronika**	**Lidhje LIVE**
MOZAIK **(J)**	4	4	-	24	15	9	-	-	-
NEDELNJI KOLAŽ **(J)**	-	-	-	-	-	-	-	-	-
MOSTOVI **(J)**	5	5	-	70	48	22	-	-	-
JEKHIPE **(J)**	5	5	-	28	20	8	-	-	-
ORA EGJIPTIANE **(J)**	5	5	-	5	2	3	-	-	-
ZËRI i ASHKALINJVE **(J)**	5	5	-	18	17	1	-	-	-
SVETLO GORE **(D-J)**	2	2	-	20	17	3	-	-	-
TOTAL	**26**	**26**	**-**	**165**	**119**	**46**	**-**	**-**	**-**

Shënim: Emisionet ditore janë të shënjuara me (D), javore me (J) dhe emisionet dyjavore me (D-J)

MAGAZINAT JAVORE TË PROGRAMIT TË KOMUNITETEVE – SHTATOR 2024									
Emisionet	**Njësi**	**Xhirim**	**Live**	**Të intervistuar**	**M**	**F**	**Fëmijë**	**Kronika**	**Lidhje LIVE**
MOZAIK **(J)**	4	4	-	75	35	14	26	-	-
NEDELNJI KOLAŽ **(J)**	-	-	-	-	-	-	-	-	-
MOSTOVI **(J)**	4	4	-	55	19	36	-	-	-
JEKHIPE **(J)**	4	4	-	27	25	2	-	-	-
ORA EGJIPTIANE **(J)**	4	4	-	11	8	3	-	-	-
ZËRI i ASHKALINJVE **(J)**	4	4	-	16	15	4	-	-	-
SVETLO GORE **(D-J)**	2	2	-	6	5	1	-	-	-
TOTAL	**22**	**22**	**-**	**193**	**107**	**60**	**26**	**-**	**-**

Shënim: Emisionet ditore janë të shënjuara me (D), javore me (J) dhe emisionet dyjavore me (D-J)

MAGAZINAT JAVORE TË PROGRAMIT TË KOMUNITETEVE – TETOR 2024									
Emisionet	**Njësi**	**Xhirim**	**Live**	**Të intervistuar**	**M**	**F**	**Fëmijë**	**Kronika**	**Lidhje LIVE**
MOZAIK **(J)**	5	5	-	75	39	12	12	-	-
NEDELNJI KOLAŽ **(J)**	-	-	-	-	-	-	-	-	-
MOSTOVI **(J)**	4	4	-	83	60	23	-	-	-
JEKHIPE **(J)**	4	4	-	21	14	7	-	-	-
ORA EGJIPTIANE **(J)**	4	4	-	13	9	4	-	-	-
ZËRI i ASHKALINJVE **(J)**	4	4	-	10	6	4	-	-	-
SVETLO GORE **(D-J)**	2	2	-	12	7	5	-	-	-

TOTAL	**23**	**23**		**201**	**136**	**55**	**12**		

Shënim: Emisionet ditore janë të shënjuara me (D), javore me (J) dhe emisionet dyjavore me (D-J)

MAGAZINAT JAVORE TË PROGRAMIT TË KOMUNITETEVE – NËNTOR 2024									
Emisionet	**Njësi**	**Xhirim**	**Live**	**Të intervistuar**	**M**	**F**	**Fëmijë**	**Kronika**	**Lidhje LIVE**
MOZAIK **(J)**	5	5	-	75	39	12	12	-	-
NEDELNJI KOLAŽ **(J)**	-	-	-	-	-	-	-	-	-
MOSTOVI **(J)**	4	4	-	83	60	23	-	-	-
JEKHIPE **(J)**	4	4	-	21	14	7		-	-
ORA EGJIPTIANE **(J)**	4	4	-	13	9	4	-	-	-
ZËRI i ASHKALINJVE **(J)**	4	4	-	10	6	4	-	-	-
SVETLO GORE **(D-J)**	2	2	-	12	7	5	-	-	-
TOTAL	**23**	**23**	**-**	**201**	**136**	**55**	**12**	**-**	**-**

Shënim: Emisionet ditore janë të shënjuara me (D), javore me (J) dhe emisionet dyjavore me (D-J)

MAGAZINAT JAVORE TË PROGRAMIT TË KOMUNITETEVE – DHJETOR 2024									
Emisionet	**Njësi**	**Xhirim**	**Live**	**Të intervistuar**	**M**	**F**	**Fëmijë**	**Kronika**	**Lidhje LIVE**
MOZAIK **(J)**	5	5	-	91	70	21	-	-	-
NEDELNJI KOLAŽ **(J)**	-	-	-	-	-	-	-	-	-
MOSTOVI **(J)**	4	4	-	56	33	23	-	-	-
JEKHIPE **(J)**	4	4	-	47	30	17	-	-	-
ORA EGJIPTIANE **(J)**	4	4	-	20	14	6	-	-	-
ZËRI i ASHKALINJVE **(J)**	4	4	-	23	18	5	-	-	-
SVETLO GORE **(D-J)**	2	2	-	17	12	5	-	-	-
TOTAL	**23**	**23**	**-**	**254**	**177**	**77**	**-**	**-**	**-**

Shënim: Emisionet ditore janë të shënjuara me (D), javore me (J) dhe emisionet dyjavore me (D-J)

Programi i Komuniteteve, përveç që përkrahet nga shumë instanca, gjithashtu merret shembull i suksesit gjatë vizitave që i bëhen Transmetuesit Publik apo në vizitat tona jashtë vendit. Programi i Komuniteteve në RTK, përveç obligimit ligjor, ka rol kyç në ngritjen e vetëdijes së publikut për diversitetin gjuhësor e kulturor në vendin tonë, në rëndësinë e integrimit dhe rritjen e demokracisë në vend.

7. RTK2

Gjatë vitit 2024 RTK2 arriti rezultate të rëndësishme të prodhimit, duke ofruar një program të pasur dhe të larmishëm për audiencën. Janë prodhuar gjithsej 1, 413 orë e 50 minuta programe vetanake, të cilat përfshijnë formate të ndryshme që përfshijnë emisione në studio, emisione dokumentare dhe etnologjike, si dhe raporte dhe kronika nga terreni.

Nga numri total i orëve të prodhuara, 849 emisione janë prodhuar në studio, duke rezultuar në 1207 orë, 18 minuta dhe 57 sekonda përmbajtje programore. Këto emisione mbulojnë një gamë të gjerë temash, duke përfshirë aktualitetin, kulturën, arsimin, argëtimin dhe fusha të tjera, duke i ofruar audiencës informacion dhe përmbajtje cilësore. RTK2 është përkushtuar në mbulimin e ngjarjeve jashtë studios, siç dëshmojnë 204 transmetime nga terreni, në total 65 orë, 39 minuta e 55 sekonda, që është tregues i përkushtimit dhe një qasje proaktive për raportimin e ngjarjeve të rëndësishme në terren. Gjatë vitit 2024 janë prodhuar 3, 437 raporte, me një kohëzgjatje totale prej 140 orë, 51 minuta dhe 14 sekonda. Këto raporte mbuluan një sërë temash dhe kontribuuan në pasurimin e përmbajtjes së kanalit, duke ofruar një pasqyrë të detajuar mbi ngjarjet, intervistat dhe historitë përkatëse me rëndësi për publikun e gjerë. Në përgjithësi, viti 2024 ishte një vit jashtëzakonisht produktiv për RTK2, i cili mbajti standarde të larta në prodhimin e përmbajtjes dhe përkushtimin për raportim cilësor, si në studio televizive ashtu edhe në terren.

PROGRAMI INFORMATIV I RTK2			
VESTI I DNEVNIK RTK2			
KATEGORIA	**KOSOVA**	**RAJONI**	**BOTA**
POLITIKA	4990	420	3936
EKONOMIA	924	1164	
SHOQËRIA	2496	336	948
SPORTI	3616		
KULTURA	325		
MOTI	2820	2424	216
GJITHSEJ	**15. 171**	**4344**	**5100**

REPORTAZHE, BISEDA, INTERVISTA, NEDELJNI PRESEK, POGLAVLJE, 5 DO 5, U FOKUSU							
KATEGORIA	**KRONIKA**	**INTERVISTA**	**REPORTAZHE**	**EMISIONE**	**SERV. INFO**	**RUBRIKA**	**MYSAFIR**
POLITIKA	497	10					
EKONOMIA	236						
SHOQËRIA	364	5	37	38	98		
SPORTI	498						
KULTURA	49						
GJITHSEJ	**1648**	**15**	**37**	**38**	**98**	**298**	

PROGRAMET E PËRBASHKËTA RTK2						
PROGRAMI i MËNGJESIT						
Kategoria	**Reportazhe**	**Mysafir**	**M**	**F**	**Live**	**Emisione**
POLITIKA	-	221	-	-	-	
EKONOMIA	-	129	-	-	-	
SHOQËRIA	408	295	-	-	-	
SPORTI	-	-	-	-	-	
KULTURA	112	79	-	-	-	
GJITHSEJ	**520**	**724**	**618**	**506**	**428**	**210**
POPODNE						
Kategoria	**Reportazhe/Kronika**	**Mysafir**	**M**	**F**	**Live**	**Emisione**
POLITIKA	-	-	-	-	-	
EKONOMIA	-	-	-	-	-	
SHOQËRIA	158	214	-	-	-	
SPORTI	-	24	-	-	-	
KULTURA	104	160	-	-	-	
GJITHSEJ	**262**	**398**	**193**	**205**	**10**	**202**

EMISIONE, FILMA, DOKUMENTARË RTK2						
KATEGORIA	**NUMRI**	**MYSAFIR**	**M**	**F**	**KOHËZGJATJA**	**EMISIONE**
KULTURO - ARSIMOR	64	97	54	43	72: 28: 38	PROGRAMI KULTUROR-ARSIMOR
MUZIKOR – ZBAVITËS	58	186	90	96	57: 35: 40	PROGRAMI MUZIKOR – ZBAVITËS
DOKUMENTAR	26	214	124	90	34: 46: 25	DOKUMENTAR
I FËMIJËVE DHE TË RINJËVE	24	0	0	0	14: 10: 09	PROGRAMI i FËMIJËVE DHE TË RINJËVE
FILM/SERI	38	-	-	-	28: 30:00	SERI DHE FILMAT RAI
KOMUNITETE	69	0	0	0	67: 30: 20	PROGRAMI i KOMUNITETEVE
SPORTI	7	10	8	2	10: 26: 18	SPORTAK **(0) RIBOLOVACKE STRASTI**
SPORTI / TRANSMETIME	59		0	0	135:00:00	LOJRAT OLIMPIKE, NATION LIGA, UEFA, CHAMPIONS LEAGUE, EUROPE LEAGUE
GJITHSEJ	**27**	**497**	**315**	**182**	**420: 27: 30**	

Që nga korriku i vitit 2024, një numër i konsiderueshëm i shikimeve janë regjistruar në Facebook dhe YouTube, si dhe koha që vizitorët në rrjetet sociale shpenzuan me videopërmbajtjen e prodhimit të RTK2.

Që nga data 30 shtator, kohëzgjatja e Programit të mëngjesit është rritur nga dy në tre orë. Analiza e Programit të mëngjesit të RTK2 tregon për një përmirësim të dukshëm në cilësinë e përmbajtjes programore. Të dhënat krahasuese tregojnë një përmirësim të dukshëm krahasuar me periudhën paraardhëse, veçanërisht për sa i përket freskisë dhe rëndësisë së përmbajtjes së transmetimit. Konkretisht, 18 minuta e 9 sekonda përmbajtje të dukshme të programit të reprizuar u zëvendësuan me përmbajtje të reja premierë nga produksioni vetanak i RTK2. Ky ndryshim përbën deri në 15. 12% të kohës totale të transmetimit, që paraqet një hap të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë. Krahasuar me formatin e mëparshëm, ku kohëzgjatja mesatare e një emisioni ishte 20: 02 orë, emisioni i ri, i cili zgjat mesatarisht 2: 59:00 orë, dëshmon për një ndryshim të rëndësishëm në pasurimin e përmbajtjes. Në orën e tretë të emisionit janë transmetuar edhe 31 minuta e 53 sekonda programe të prodhimit të brendshëm të TV RTK2. Ky segment përfshin kategori të ndryshme, duke përfshirë Programin e Informacionit, Informacionin e Prezantuar në OFF, Programin e Premierës, Ndërhyrjet drejtpërdrejt dhe Intervistat me të ftuarit, gjë që përmirëson më tej cilësinë e përmbajtjes, si dhe rëndësinë e informacionit të paraqitur për shikuesit.

Megjithatë, edhe pse është bërë progres i rëndësishëm në cilësinë e programit, nuk mund të mos vërejmë se sfidat në lidhje me burimet njerëzore dhe pajisjet teknike vazhdojnë të përbëjnë një pengesë të madhe për përparimin e mëtejshëm. Gjatë vitit 2024, autorët e RTK2 kanë marrë pjesë me veprat e tyre në disa festivale vendore dhe ndërkombëtare dhe kanë arritur sukses të konsiderueshëm.

TRANSMETIME TË DREJTPËRDREJTA

RTK2 ka vazhduar praktikën e transmetimit të seancave të Kuvendit të Kosovës edhe në vitin 2024, duke u ofruar qytetarëve mundësinë që të përcjellin drejtpërdrejt punën e legjislativit dhe marrjen e vendimeve kyçe. Gjithashtu, seancat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara u transmetuan drejtpërdrejt, duke i mundësuar publikut të gjerë të informohet për çështjet globale që prekin Kosovën. Gjithashtu, RTK2 ka transmetuar edhe konferenca të shumta ku janë diskutuar çështje me rëndësi për shoqërinë kosovare, duke përfshirë tema nga fusha e ekonomisë, politikës, kulturës dhe arsimit.

Përveç kësaj, RTK2 vazhdoi të transmetojë ngjarje kulturore dhe argëtuese. Nëpërmjet këtyre transmetimeve të drejtpërdrejta, kanali ka kontribuuar në ruajtjen e trashëgimisë kulturore, por edhe në promovimin e përmbajtjeve bashkëkohore artistike dhe argëtuese, duke i ofruar shikuesve një program të pasur dhe të larmishëm që ishte në dispozicion në mbarë Kosovën.

SPORTI

Gjatë vitit, RTK2 transmetoi ngjarjet më të rëndësishme sportive, përfshirë Lojërat Olimpike në Paris, si dhe kronika të shumta olimpike. Përveç kësaj, kanali transmeton ndeshje në kuadër të

Ligës së Kombeve, garave të UEFA-s, si dhe ligave prestigjioze, si Champions League dhe Europa League. Janë bërë edhe disa intervista me punëtorë të shquar të sportit.

PRODUKSIONI DHE TEKNIKA E RTK2

Detyrat dhe rezultatet e produksionit të RTK2 bazohen në bazë të skemës programore, ngjarjeve ditore, si dhe projekteve të veçanta të jashtëzakonshme. Gjithashtu, kërkesat për prodhimin e programit bazohen në vetë kapacitetet prodhuese, fuqinë punëtore dhe teknologjinë.

STRUKTURA E TË PUNËSUARVE

Numri i përgjithshëm i punëtorëve të angazhuar në sektorin e produksionit dhe teknikës në RTK2 është dyzet (40). Punonjësit e këtyre departamenteve janë të angazhuar në xhirimin, postproduksionin, përgatitjen dhe transmetimin e përmbajtjeve të rregullta programore të kanalit RTK2-TV.

Për shkak të largimit dhe braktisjes së përhershme të një numri punonjësish nga RTK2, ka mungesë drastike të punonjësve pothuajse në të gjitha pozitat në repartin e "Montazhit", "Regjisë televizive" dhe të "Masterit", gjë që e bën organizimin e punës dukshëm më të vështirë, sidomos gjatë festave të fundvitit, kur shfrytëzohen pushimet dhe ditët e fituara, shfrytëzimi i pushimit mjekësor me pagesë, mungesat e jashtëzakonshme dhe gjatë një numri të madh të xhirimeve në terren apo xhirimeve në studiot e jashtme të RTK TV (programi i Vitit të Ri, kulturor dhe ngjarje artistike, ngjarje shpirtërore).

Nga struktura e bashkëngjitur e të punësuarve del se është e nevojshme të angazhohen 3 montazherë dhe 7 punëtorë në regji (5 në regji, 1 ndriçim dhe 1 në teknologji) në mënyrë që gjithçka të funksionojë në përputhje me ligjin e punës dhe marrëveshje kolektive të RTK-së dhe në mënyrë që të mund të përmbushen të gjitha kërkesat e përcaktuara programore të kanalit RTK2-TV. Për të kompensuar mungesën e punëtorëve dhe mungesën e zbatuesve, punëtorët angazhohen në pozita të tjera në intervale të caktuara kohore dhe punojnë dy ose tre punë në të njëjtën kohë. Problemi lind edhe me orarin javor të punës (rregulli 5-2), sepse nuk ka fundjavë për prodhim, një numër punëtorësh punojnë jashtë orarit, ndërsa disa punëtorë ekspert janë të angazhuar në kryerjen e detyrave të dyfishta të punës. E gjithë kjo ndikon edhe në orarin e planifikuar të punës dhe kryerjen e rregullt të detyrave të caktuara të punës. Krahas detyrave të rregullta të punës, të cilat janë të përcaktuara me kontratën e punës, të gjithë punonjësit e departamentit të TV regjisë janë të angazhuar në kryerjen e punëve shtesë në baza ditore, në pozita për të cilat kanali RTK2-TV nuk ka punonjës:

Pothuajse në të gjitha departamentet ka mungesë të theksuar të punëtorëve, gjë që e bën shumë më të vështirë organizimin e punës, sidomos gjatë festave të fundvitit, kur shfrytëzohen pushimet dhe ditët e fituara, përdorimi i pushimit mjekësor me pagesë, mungesat e jashtëzakonshme, orët e fundjavës dhe kur ka një rritje të madhe të numrit të xhirimeve në terren apo xhirimeve në studiot e jashtme të RTK-së (programi i Vitit të Ri, ngjarje kulturore dhe artistike si dhe ngjarje

tjera. Numri i ekzekutuesve aktualë dhe nevoja reale për kryerjen e punës janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

	Pozita	Numri i ekzekutuesve	Nevojat e punës
1.	Udhëheqës i produksionit	1	1
2.	TV Regjia		
	Udhëheqës i regjisë dhe realizimit	1	1
	Video mikser/Realizator	**3**	**4**
	Teknik në transmetim të programit	4	4
	Tonist	**3**	**5**
	Operator grafik	**2**	**4**
2.	TV Studio		
	Kameraman	**4**	**5**
3.	Montazhi		
	Regjisor	1	1
	Montazher	**5**	**8**
4.	Xhirues		
	ENG xhirues RTK2-TV	9	10
	ENG xhirues TV Studio Prizren	1	1
5.	Dizajn grafik		
	Udhëheqës i dizajnit grafik	1	1
	Dizajn grafik	1	1
6.	Sektori i teknikës – mirëmbajtja e audio/video IT pajisjeve		
	Teknik në mirëmbajtje të pajisjeve	2	3
7.	Ndriçimi		**1**
	GJITHSEJ	**40 ***	**50**

(SHËNIM: TRE PUNËTORË JANË NË PUSHIM PA PAGESË)

TRAJNIMI DHE AFTËSIMI PROFESIONAL

Për shkak të numrit të madh të modifikimeve të sistemit, zhvillimit dhe zbatimit të zgjidhjeve të reja tekniko-teknologjike, si në të gjitha vitet e kaluara, në vitin 2024, theks i madh i është kushtuar përmirësimit dhe rikualifikimit të vazhdueshëm të punëtorëve në sektorët e produksionit dhe

teknikës së kanalit RTK2. Punonjësit e mirëmbajtjes së sistemit të televizionit RTK2 kanë përgatitur dhe krijuar skenarë dhe udhëzime të shumta pune në mënyrë që të gjithë punonjësit të përshtaten me punën në Full HD. Drejtuesit e departamenteve në sektorin teknik të RTK2, udhëheqësi i regjisë dhe produksionit dhe shefi i sektorit të produksionit gjatë gjithë vitit 2024 kanë testuar vazhdimisht njohuritë e punëtorëve dhe kanë mbajtur kurse me qëllim të trajnimit shtesë dhe zhvillimit profesional të punëtorëve.

8. Programi satelitor

Programi satelitor, përveç obligimit ligjor, ka rol në ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe ngritjen e vetëdijes së publikut në mërgatë dhe rëndësinë që mërgata të jetë sa më afër zhvillimeve dhe jetës në Kosovë. Gjatë vitit 2024 ka ofruar program të rregullt, duke ju përshtatur nevojave programore dhe bashkërendimit me skemën e rregullt të RTK1.

Emisioni i rregullt dy javor që i dedikohet diasporës “Linja Shqip” ka vazhduar realizimin dhe trajtimin e temave të ndryshme për mërgatën ku gjatë vitit janë realizuar 26 emisione nga ngjarjet në vendet ku jetojnë dhe veprojnë mërgimtarët si dhe në studio në Prishtinë me të rinjtë mërgimtar si dhe me zv/kryeministër, ministra e ambasadorë që kanë folur për mërgatën dhe çështjet që lidhen me mërgatën.

Programi satelitor ka realizuar emisione me mërgimtarët nga, Kroacia, Turqia, Greqia, Austria, Gjermania, Zvicra, SHBA, Kanadaja dhe Australia. Temat dhe disa nga emisionet e veçanta në mërgatë kanë qenë data e rëndësisë shtetërore e kombëtare. Mirëpo, në fokus ka qenë edhe promovimi i të rinjve mërgimtar që po kryenin punë praktike në institucionet e Kosovës, promovimi i shkollave shqipe në mërgatë që kanë për synim ruajtjen e gjuhës dhe kultuës tek të rinjtë në mërgatë. Sa i përket skemës së rregullt programore edhe këtë vit është dashur disa herë të ndërhyhet në skemë për shkak të emisioneve, dokumentarëve, filmave, koncerteve dhe ndeshjeve futbollistike për të cilat si kemi pasur të drejtat e transmetimit edhe në programin satelitor. Këta terminë janë mbuluar me emisione në varësi të kohës i është përshtatur edhe zhanri i emisioneve, me mbi 200 terminë të planifikuar dhe paplanifikuar, ndërsa vetëm gjatë lojërave olipmike kanë qenë mbi 170 orë program, ndryshe nga rrjeti tokësor.

RTK Sat, pavarësisht ndryshimeve në skemën tokësore, në rrjetin satelitor ka transmetuar seancat e Gjykatës Speciale në Hagë, pavarësisht ndërhyrjeve në skemën programore që kanë mundur të jenë në RTK1. Prandaj, bazuar në skemën dhe mundësitë për të realizuar programore dhe kapacitetet me burime njerëzore, raportet e punës, vijueshmërisë dhe pranisë në punë mund të themi se ky vit karakterizohet si i suksesshëm. Mirëpo, duhet theksuar se programi satelitor përvec skemës së rregullt ka realizuar edhe projekte shumë të rëndësishme verore kushtuar mërgatës. Me qëllim të pasurimit të skemës dhe përmbajtjes programore të programit satelitor, gjithashtu do të ishte me rëndësi blerja e dokumentarëve dhe filmave shqip me karakter edukativ që i përshtaten moshës sepse diaspora ka nevojë më shumë që t’u ofrojë fëmijëve emisione eduaktive që do të ndikonin tek ta që mos të humbin gjuhën dhe të njihen me historinë e vendit.

Disa nga ngjarjet më të rëndësishme të realizaura nga RTK-sat: Projekti veror "E diela e Mërgatës"; Projekti i reportazheve " Komunat për Diasporën"; Promovimi i aktiviteteve të shkollave shqipe në mërgatë; Manifestimet për Ditën e Flamurit; Festa e pavarësisë së Kosovës në Mërgatë; 30 vjetori i emërtimit të UCK-së në Aarau të Zvicrës; Konferenca shkencore në Zvicër; Promovimi i të rinjve të ardhur nga mërgata për punë praktike në institucionet e Kosovës; Intervista dhe biseda nëpërmjet skype me mërgimtarët e suksesshëm që jetojnë në shtete të ndryshme; Gala koncerti-Marinë të Skenderajt; Koncerti i këndojmë lirisë për tre ditë në Klinë.

9. RTK3

EDICIONI QENDROR I LAJMEVE 19: 30

STATISTIKA VJETORE E LAJMET 19: 30 PËR 2024									
Emri i emisioni t	**Njësi**	**Xhirim**	**Live**	**Të intervistuar**	**M**	**F**	**Kronika të gazetarëve**	**Kronika të korrespondentëve**	**Lidhje LIVE**
EDICIONI QENDROR	366	-	309	36	28	8	2, 238	1. 221	319

LAJMET E DITËS 08:00 – 15:00

Në lajmet e ditës gjatë vitit 2024 në periudhën janar – dhjetor janë transmetuar 2, 182 edicione të lajmeve 08:00 – 15:00

141 - lidhje live me gazetarë, korrespondentë e ngjarje të caktuara, 5 të intervistuar nga ngjarje të caktuara.

LAJMET E DITËS 08:00 – 15:00								
LAJME DITORE	**Njësi**	**Xhirim**	**Live**	**Të intervistuar**	**M**	**F**	**Intervista të xhiruara**	**Lidhje LIVE**
Janar-dhjetor 2024	**2,182**	**-**	**2,182**	**5**	**3**	**2**	**-**	**141**

ZYRA RAJONALE NË MITROVICË

Gjatë vitit 2024 stafi në Zyrën Rajonale në Mitrovicë është reduktuar në tre punonjës. Edhe pse me staf të vogël janë bërë përpjekje të jashtëzakonshme për të përmbushur kërkesat dhe për t'i pasqyruar ngjarjet dhe zhvillimet në rajonin e Mitrovicës. Sfidë ka qenë numri i vogël i stafit dhe siguria e zyrës dhe pajisjeve, pasi nuk disponohet me sistem sigurie adekuat, as nuk ka pajisje identifikimi, as sisteme për kontrollin e qasjes në mjedise të punës. Mungesa e këtyre aparaturave ndikon negativisht në sigurinë dhe mbrojtjen e pasurisë brenda zyrës.

Në tabelën e mëposhtë janë aktivitetet e Zyrës Rajonale në Mitrovicë për vitin 2024.

	Kronika – tema	Emisione, Festivale, Koncerte	Lidhje direkte	Numri i bashkëbiseduesve sipas gjinisë ka filluar të evidentohet nga muaji korrik, duke mundësuar një ndarje të qartë dhe të strukturuar të të dhënave për përdorim të mëtejshëm.
Janar	18	6	9	
Shkurt	22	4	9	
Mars	23	7	15	
Prill	22	6	14	
Maj	18	2	4	
Qershor	12	2 2	4	
Korrik	27		10	Gra - 18 / Burra -47 total = 65
Gusht	24	3	5	Gra - 5 / Burra - 42 total = 47
Shtator	12	2	3	Gra – 6 / Burra - 23 total = 29
Tetor	19	1		Gra – 7 / Burra - 36 total = 43
Nëntor	9	5	6	Gra - 5 / Burra – 23 total = 28
Dhjetor	14	5	7	Gra - 7 / Burra – 33 total = 40
Gjithsej	**220**	**45**	**86**	**Gra – 48 / Burra - 204 total = 252**

ZYRA RAJONALE PRIZREN

Statistika e punëve të kryera nga Zyra Rajonale në Prizren gjatë vitit 2024:

RTK 1, RTK 3 – Gjuha Shqipe – të realizuara: 248 Kronika / 65 Live

Redaksia Boshnjake – të realizuara: 138 Kronika / 129 Storie /15 Realizime

Redaksia Turke – të realizuara: 54 Haber / 40 Mozaik / 9 Realizime

Ora Egjiptiane (Egjiptiane) – të realizuara: 47 Emisione / 64 Kronika / 4 Reportazhe

Svetlo Gore (Gorane) – të realizuara: 29 Emisione / 46 Storie

Radio – Redaksia Turke – të realizuara: 27 Emisione / 46 Aktualitete

Radio – Redaksia Rome – të realizuara: 261 Edicione lajmesh / 262 Kronika / 156 Emisione autorial / 260 Rubrika/ 38 Intervista

Zyra Rajonale në Prizren, ka mbuluar dhe shumë kërkesa të tjera të parashtruara nga RTK 1, 2, 3, 4 si dhe RTK-Radio.

LAJMET NDËRKOMBËTARE

Redaksia e Lajmeve Ndërkombëtare ka përgatitur 1607 kronika me pamje nga NEP. Këto kronika janë transmetuar në edicionet ditore, edicionin qendror të lajmeve 19: 30, në Magazinën Ditore "INFO Plus" si dhe edicionet e mbrëmjes. Nga data 24 korrik 2023 ka filluar një edicion 5 deri 7 minuta, varësisht prej zhvillimeve në botë, që transmetohet në Info Plus, ku përveç lajmit apo lajmeve kryesore të ditës, përgatiten edhe kuriozitete dhe kronika tjera interesante nga rajoni dhe bota.

Aktualisht nuk mund të shfrytëzohen pamjet nga Reuters, sepse nga 2023 korriku është ndërprerë kontrata mes RTK dhe Reuters. Një gjë e tillë ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë si për pamje ashtu

edhe për mbulim sa më të shpejtë te lajmeve nga rajoni dhe bota. Njëherësh nuk kemi qasje as në EVN dhe aktualisht jemi duke përdorur sistemin NEP i cili është mjaft i kufizuar për pamjet që nevojiten të mbulohen kronikat e lajmeve nga bota, si dhe ku News Feeds ruhen vetëm 2 ditë duke na detyruar që shpesh të mbulojmë lajme me pamje nga arkivi.

Sa i përket mbulimit të lajmeve nga bota, brenda vitit 2024 rëndësi e veçantë i është kushtuar luftës Izrael – Gazë si dhe të gjitha zhvillimeve në Lindje të Mesme si armiqësitë ndërmjet Libanit dhe Izraelit si dhe Iranit dhe Izraelit si dhe zhvillimeve tjera të rëndësishme në Lindje të Mesme që ishte një ndër ngjarjet kryesore edhe gjatë vitit 2024. Gjithashtu kemi përcjellë intensivisht luftën në Ukrainë dhe zhvillimet e përgjithshme sa i përket luftë Ukrainë- Rusi e që gjithashtu ka shënuar vitin 2024. Rëndësi e veçantë i është kushtuar zgjedhjeve në SHBA, ku redaksia e Lajmeve Ndërkombëtare edhe pse në mungesë të pamjeve ka mbuluar çdo zhvillim me rëndësi. Redaksia e lajmeve ndërkombëtare me datë 05. 11. 2024 ka përgatitur edicionin special për zgjedhjet në SHBA i cili është transmetuar live nga ora 21 deri në orën 01 pas mesnate.

Ndërkaq nga zhvillimet tjera që janë përcjellë kohëve të fundit janë zhvillimet në Siri, ndërsa rëndësi e posaçme i është kushtuar vërshimeve shkatërruese në Evropë si dhe fatkeqësive tjera natyrore që kanë goditur Evropën, uraganet në SHBA dhe fatkeqësitë tjera natyrore në botë e që gjatë vitit 2024 kanë qenë të shumta. Përveç mbulimit të ngjarjeve më të rëndësishme globale, redaksia e Lajmeve Ndërkombëtare përcjellë çdo lajm të fundit apo zhvillim për të cilin duhet të informohet publiku. Mediet e zakonshme të cilave ju referohen gazetarët për lajmet e fundit dhe ngjarjet tjera, janë BBC, CNN, Reuters, AP. Redaksia e lajmeve ndërkombëtare ka përgatitur edhe edicionin e fundvitit 2024 i cili ka zgjatur rreth 35 minuta me zhvillimet kryesore që e kanë shënuar vitin 2024.

10. RTK4

Gjatë këtij viti ka vazhduar transmetimi i dy emisioneve premierë: magazina informative kulturore "@RTKulturë", e realizuar nga redaksia e kanalit RTK4, e cila është transmetuar çdo ditë pune në RTK4 dhe RTK3, dhe emisioni "Metropol", i realizuar nga Radio Kosova. Po ashtu, gjatë këtij viti janë transmetuar drejtpërdrejt 78 ngjarje kulturore, sportive dhe të aktualitetit.

Janë transmetuar 183 magazina informative kulturore "@RTKulturë" me kohëzgjatje deri në 25 minuta, ku janë pasqyruar të gjitha ngjarjet ditore kulturore në vend, rajon dhe diasporë.

Në "@RTKulturë" kanë qenë të ftuar 201 mysafirë në studio dhe me video-lidhje nga fusha e kulturës dhe artit, të cilëve u është dhënë mundësia që, përmes kësaj magazine kulturore, të pasqyrojnë dhe promovojnë punën dhe veten e tyre në fushat përkatëse si kultura, muzika dhe arti.

Po ashtu, janë transmetuar drejtpërdrejt edhe 178 emisione të programit të mëngjesit "Metropol" të Radio Kosovës.

Në kuadër të ngjarjeve nga kultura, muzika, arti etj., të cilat janë transmetuar drejtpërdrejt, përfshihen: njëmbëdhjetë (11) festivale, dymbëdhjetë (12) koncerte, dy (2) promovime librash dhe dy (2) ngjarje filantropike.

Më poshtë i gjeni të listuara të gjitha ngjarjet me karakter kulturor të transmetuara drejtpërdrejt në RTK4:

Festivale (11):

Festivali i 2-të i Këngës në RTK, Festivali Mbarëkombëtar i Muzikës Popullore në Rahovec, Festivali i Teatrove në Ferizaj (3 ditë), Festivali "Hardh Fest" (3 ditë), Festivali "New Born Festival" (3 ditë), Festivali "Etno Fest", Festivali "I këndojmë Lirisë" Klinë (4 netë), Festivali Ndërkombëtar i Teatrit "Burbuqe Berisha", Festivali "Netët e Klipit Shqiptar" (3 netë), Prishtina Music Conference, Festivali i 63-të i Këngës në RTSH (4 netë).

Koncerte(12):
Koncerti "Sofra Prizrenase", Koncerti i Filarmonisë së Kosovës, Koncert festiv në Sheshin "Zahir Pajaziti" – Prishtinë, Koncerti i Filarmonisë së Kosovës – Prishtinë, Gala koncerti në Marinë – Skenderaj, Koncert festiv "Melodia e Lirisë", Koncertet e Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore nga Shqipëria (3 netë), Koncerti i Ansamblit "Saz'iso", Gala koncerti i solistëve dhe ansambleve vokale, Mbrëmje artistike "Ta zbardhi fytyrën" – Eno Peçi, Koncerti i sopranos Arta Jashari, Koncerti i Ansamblit "Shota".

Përurime librash (2):
Libri "Zërat e padëgjuar", Libri "Ora e Kosovës, Pavarësia dhe Shtetndërtimi".

Ngjarje kulturore-filantropike (2):

"Bashkohu, shpëto jetë", Gara Ndërkombëtare e Kulinarisë.

Një vend të rëndësishëm në skemën programore të kanalit e kanë zënë edhe ngjarjet sportive, ku gjatë këtij viti janë transmetuar drejtpërdrejt 48 ngjarje sportive me karakter nacional, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në kuadër të këtyre ngjarjeve janë transmetuar drejtpërdrejt: pesë (5) ndeshje futbolli, njëzet e dy (22) ndeshje volejbolli, pesë (5) ndeshje basketbolli, një (1) hendbolli, tri (3) futsall, dy (2) meçe boksi, një (1) ndeshje ragbi dhe nëntë (9) ngjarje nga Lojërat Olimpike "Parisi 2024".

Po ashtu, gjatë këtij viti, varësisht nga implikimet në skemën programore të RTK1, në RTK4 janë transmetuar edhe ngjarje të aktualitetit si: seancat nga procesi gjyqësor në Hagë, Akademi Përkujtimore dhe Samiti.

Seanca Hagë: janë transmetuar gjithsej tetë (8) seanca gjyqësore.

Samiti: Samiti për Paqe dhe Demokraci.

Akademi Përkujtimore (1): "Masakra e Reçakut".

Përveç këtyre ngjarjeve që janë transmetuar drejtpërdrejt në RTK4, kemi vazhduar me mbulimin e pjesës tjetër të programit në skemën programore, kryesisht me produktet e RTK1.

Pjesa tjetër programore është plotësuar me transmetime nga RTK1, më pas në RTK4, si dhe me materiale nga arkiva e RTK-së dhe RTP-së.

11.TV-Produksioni RTK1, 3, 4

Në vitin 2024 TV-Produksioni është përballur me mungesë të theksuar të stafit në sektor të ndryshëm të prodhimit, përfshirë montazhin, zërin, dizajnin grafik, ENG-kamerën, dhe shumë njësi të tjera të rëndësishme të TV-Produksionit. Megjithatë, edhe në këtë situatë, TV-Produksioni ka vazhduar të punojë ngushtë dhe me përkushtim në bashkëpunim me të gjitha redaksitë, duke arritur të realizojë me sukses të gjitha kërkesat programore gjatë vitit. Ky angazhim dhe përpjekje kolektive kanë kontribuuar në imazhin e RTK-së.

Muaji janar: Nga janari deri në javën e dytë të muajit prill, është vazhduar në realizimin të gjitha emisioneve në Studio 1, 4 dhe Studio 5, pasi janë vazhduar punimet në skenografinë për rregullimin e Studio 2. Vlen të theksohet se në fund të muajit janar është realizuar me shumë sukses në Studio 5 një UNPLUGGED - "Kangë Zemre", e cila është transmetuar premierë për ditën e Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2024.

Muaji shkurt: Vlen të theksohet se për shkak të ditës së Pavarësisë së Kosovës ka pasur transmetim gjithëditor dhe me OB-van dy transmetime të organizuara për këtë ditë. Pritja shtetërore dhe FILARmonia e Kosovës kanë organizuar një koncert festiv.

Muaji mars: Ka pasur disa ngjarje, ndër më të rëndësishmet janë Epopeja e UÇK-së dhe Epopeja e Gllogjanit. Janë kemi mbuluar me autoreportazh (OB-van), si dhe ka pasur edhe transmetime dhe xhirime të tjera: FSK – parakalimi, Akademi Përkujtimore për Epopenë e UÇK-së, Studio e hapur në Prekaz, program artistik-koncert, intervistë me Kryeministrin - RTK Prime, etj.

Muaji prill: Me 8 prill, jemi rikthyer me xhirime dhe transmetime të drejtpërdrejta të të gjitha emisioneve, të cilat ishin paraparë të realizoheshin në Studio 2, tashmë me skenografi të re. Si ngjarje të rëndësishme mund të theksojmë disa transmetime të sporteve: Futboll, Futsall, Hendboll, Basketboll si dhe Faljen e Fitër Bajramit.

Muaji maj: Kanë vazhduar me ritëm të njëjtë xhirimet e emisioneve, disa xhirime-transmetime të Filarmonisë së Kosovës, boks - turneu i Lah Nimani, Koncert - Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Në fund të këtij muaji kanë filluar përgatitjet për koncertin me rastin e 50-vjetorit të këngëtares Shkurte Fejza.

Muaji qershor: RTK në bashkëpunim me këngëtaren e njohur Shkurte Fejza dhe me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për nder të 50-vjetorit të karrierës së kësaj këngëtareje, ka organizuar një koncert në sallën e djegur të Pallatit të Rinisë, ku ka qenë një bashkëpunim dhe një program shumë madhështor, të cilin e kemi xhiruar dhe transmetuar më vonë. Këtë muaj kemi vazhduar edhe me disa xhirime-transmetime të drejtpërdrejta, një nga ngjarjet më të rëndësishme ka qenë Zambaku i Prizrenit, parakalimi i FSK-së, Turneu Ndërkombëtar i Ping Pongut dhe falja e Kurban Bajramit. Në fund të muajit qershor ka filluar puna në përgatitjen e skenografisë, grafikave dhe gjithçkaje që nevojitet për të filluar me xhirimet e Programit të Verës.

Muaji korrik: TV-Produksioni ka qenë tejet aktiv me realizimin e programeve dhe transmetimeve të ndryshme, duke përfshirë emisione të drejtpërdrejta dhe projekte speciale.

Programi Veror: Programi Veror ka filluar xhirimet në oborrin e RTK-së, ku të gjitha përgatitjet janë bërë në kohë për skenografinë, ndriçimin, zërimin dhe pajisjet teknike. Programi është xhiruar me OB-van dhe deri në fund të këtij muaji janë xhiruar 13 emisione, të cilat kanë shkuar shumë mirë.

Programi i Mëngjesit: Nga data 23. 07. 2024, ka filluar transmetimi i programit të mëngjesit në oborrin e RTK-së, ku Produksioni dhe teknologjia kanë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme, duke përfshirë skenografinë, ndriçimin, teknologjinë dhe OB-vanin.

Kampionati Evropian: Kampionati Evropian ka vazhduar me 15 emisione speciale kushtuar këtij eventi, të cilat janë transmetuar drejtpërdrejt nga studio 2 nga ora 23:00-00:00. Më 14. 07. 2024, ky kampionat ka përfunduar zyrtarisht dhe në RTK është mbajtur edhe një emision special pas përfundimit të tij.

Kuizi Olimpik: Në kuadër të Lojërave Olimpike, është xhiruar "Kuizin Olimpik" në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës. Gjatë këtij muaji, në studio 2 janë xhiruar 4 emisione (kuiza).
Lojërat Olimpike "Parisi 2024": Më 23. 07. 2024, në studio 2, ka shkuar live transmetimi i emisioni special kushtuar LO "Parisi 2024" nga studio 2 në skenografinë e RTK Prime.
Lojërat Olimpike "Parisi 2024" kanë filluar zyrtarisht më 26. 07. 2024, ku ka pasur transmetime të drejtpërdrejta pothuajse gjatë gjithë ditës. Këto transmetime vazhduan deri më 11. 08. 2024.
Muaji gusht: Ngjarja kryesore ka qenë koncerti i "Ramë Lahaj & Friends". Programi i Mëngjesit ka vazhduar të transmetohet nga oborri i RTK-së, ndërsa në javën e fundit të gushtit jemi kthyer në studio. Programi Veror ka vazhduar edhe me xhirimin e 4 emisioneve gjatë këtij muaji.

Muaji shtator: Ka vazhduar mbulimi i të gjitha kërkesave programore dhe vlen të theksohet se në këtë muaj kanë filluar transmetimet e ngjarjeve të sportit, si Champions League dhe Europa League, ku në Studio 2 të RTK 1 janë bërë emisione me analiza para dhe pas ndeshjeve. Në Studio 2 ka filluar gjithashtu xhirimi i emisionit për të rinj "n'ZA", për shkak se Studio Nr. 5 është demontuar për të filluar investimet në skenografi të re. Emisioni i Pasdites është transmetuar disa herë nga Studio 2, kur OB-van ishte në servis. Nga data 27. 09. 2024, dhe deri sa të rregullohet Studio Nr. 4, do të vazhdojë të transmetohet nga Studio 2. Këtë muaj, si ngjarje kryesore në terren ka qenë Hardh Fest – 3 netë kemi xhiruar koncertet, Maratona e Prishtinës.

Muaji tetor: Kanë vazhduar transmetimet e futbollit, si Champions League dhe Europa League, ku në Studio 2 të RTK1 po bëhen emisione me analiza para dhe pas ndeshjeve.

Në dhjetë ditët e fundit të tetorit, TV-Produksioni ka qenë shumë i fokusuar në Festivalin e Dytë të Këngës në RTK. Janë zhvilluar prova, është transmetuar drejtpërdrejt Red Carpet-i, tre netët e Festivalit të Dytë të Këngës, përfshirë edhe emisionin pas Festivalit, Post-festival. Nga studio e RTK 1 është transmetuar gjithashtu edhe emisioni që i ka paraprirë Festivalit - RTK Fest nga ora 17: 20-19:00, si dhe ka pasur çdo ditë prova gjenerale para transmetimit të Festivalit.

Muaji nëntor: Vlen të theksohet se si ngjarje më me peshë në këtë muaj ka qenë takimi i dy qeverive, të Kosovës me qeverinë e Maqedonisë së Veriut; "Ditët e Nëntorit" organizuar nga komuna e Gjakovës, kemi bashkëpunuar me Prishtina Music Conference ku ka pasur disa transmetime, xhirime të koncerteve të FILARmonisë së Kosovës si dhe ngjarje nga sporti.

Muaji dhjetor: TV-Produksioni, në përputhje me kërkesat programore, ka qenë i angazhuar po thuajse gjatë gjithë muajit në xhirimin e programeve festive për Vitin e Ri 2025. Këto programe janë realizuar në bashkëpunim me redaksitë e televizionit me OBV-në, duke përfshirë gjithsej 23 xhirime dhe transmetime të drejtpërdrejta si dhe një xhirim i grupit String String në studio të RTK-së. Më poshtë janë krejt xhirimet, transmetimet e drejtpërdrejta e realizuara me OB-van gjatë vitit 2024.

RTK1

Studio 2

- Në fillim të vitit 2024, Studio 2 ishte në përgatitje të skenografisë për të realizuar emisionet. Pasi përfunduan këto punime, emisionet kanë kaluar në realizimin në Studio 2, përfshirë xhirime dhe transmetime të drejtpërdrejta.
- Nga data 8 prill 2024, Studio 2 ka filluar të realizojë të gjitha emisionet e drejtpërdrejta
- Studio 2 ka qenë e angazhuar për **Kampionatin Evropian** të futbollit, ku janë realizuar **15 emisione speciale**.
- Gjatë **Lojërave Olimpike Paris 2024**, Studio 2 ka realizuar transmetime të drejtpërdrejta dhe ka organizuar xhirime për emisione speciale, duke u shfaqur pothuajse çdo ditë.
- Në muajin **shtator**, Studio 2 ka qenë vendi ku janë realizuar **analizat para dhe pas ndeshjeve të Champions League dhe Europa League**.
- **Emisioni për të rinjtë "n'ZA"** ka filluar të xhirohet në Studio 2 në këtë muaj për shkak të demontimit të Studio 5.
- Studio 2 ka qenë thelbësore gjatë përgatitjeve të xhirimeve dhe transmetimeve për ngjarje të mëdha si **Festivalin e Dytë të Këngës,** ku atë jave nga ora 17:00-19:00 është realizuar emision i drejtpërdrejt RTK Fest.
- Edhe për realizimin e **programet festiv** për Vitin e Ri 2025 në studio 2 është xhiruar grupi String String.

RTK3

Studio 1:

Kjo studio është e dedikuar kryesisht për programe informatikë, ku transmetohen lajmet gjatë gjithë ditës, xhirohen magazinat e redaksive të minoriteteve, lajmet e minoriteteve, RTKulturë pesë herë në javë, Linja Shqip, Ekonomiks, RTK Green, RTK Tech, Fjalë e Tinguj, si dhe shumë transmetime të drejtpërdrejta gjatë gjithë javës (mbledhje e qeverisë, komisionet e Kuvendit, konferenca, Haga, etj.). Vlen të theksohet se në periudhën janar-prill, deri sa është përfunduar skenografia e Studio 2, këtu janë transmetuar RTK Prime, emisionet e sportit, etj.

Kjo është tabela e ENG-kamerave për periudhën janar-dhjetor 2024, ku janë të përfshira vetëm xhirimet e emisioneve, pa llogaritur dhomën e lajmeve dhe transmetimet e drejtpërdrejta.

	ENG	Gjithsej:
MUAJI JANAR	**207**	**207**
MUAJI SHKURT	**234**	**234**
MUAJI MARS	**207**	**207**
MUAJI PRILL	**228**	**228**
MUAJI MAJ	**252**	**252**
MUAJI QERSHOR	**195**	**195**
MUAJI KORRIK	**245**	**245**
MUAJI GUSHT	**185**	**185**
MUAJI SHTATOR	**199**	**199**
MUAJI TETOR	**245**	**245**
MUAJI NËNTOR	**190**	**190**

MUAJI DHJETOR	**163**	**163**
	TOTALI Vjetor:	**2550**

NJËSIA E MONTAZHIT

Njësia e montazhit për vitin kalendarik 2024 është ballafaquar me mungesë të theksuar në burime njerëzore, andaj, edhe pse me vështirësi, ka arritur që prodhimet kryesore t'i realizojë me sukses dhe të mbulojë terminet e programit të aktualiteteve, programin e komuniteteve (përfshirë lajmet e tyre), programin edukativ-arsimor, dokumentarët, programet e përbashkëta, redaksinë e muzikës, redaksinë hulumtuese, koncerte të ndryshme, Festivalin e Dytë të Këngës, si dhe gjithë programin e fundvitit festiv për vitin 2025.

Kjo është tabela e njësisë se montazhit për periudhën janar-dhjetor 2024, ku janë të përfshira vetëm montazhet e emisioneve, pa llogaritur dhomën e lajmeve.

VITI 2024	MONTAZH	GJITHSEJ:
MUAJI JANAR	**184**	**184**
MUAJI SHKURT	**207**	**207**
MUAJI MARS	**244**	**244**
MUAJI PRILL	**261**	**261**
MUAJI MAJ	**278**	**278**
MUAJI QERSHOR	**203**	**203**
MUAJI KORRIK	**265**	**265**
MUAJI GUSHT	**226**	**226**
MUAJI SHTATOR	**202**	**202**
MUAJI TETOR	**225**	**225**
MUAJI NËNTOR	**220**	**220**
MUAJI DHJETOR	**229**	**229**
	TOTALI Vjetor:	**2744**

12. Tv – teknologjia

Gjatë vitit 2024 departamenti i TV Teknologjisë ka planifikuar, organizuar dhe ka udhëhequr tërë procesin e punëve duke ofruar infrastrukturën e nevojshme teknike me standarde të larta profesionale për prodhimin e programit për të gjitha kanalet e RTK-së. Janë projektuar sisteme të ndërlikuara të studiove, të teknologjisë mobile dhe është bërë zgjerimi i sistemit ekzistues duke e mbajtur RTK-në të përditësuar me teknologji sipas mundësive buxhetore që kishim. Ky departament është përgjegjës për teknologjinë audio video prodhuese, sistemin e ndriçimit në studiot televizive, studiot regjionale, OB-van, teknologji mobile, transmetimet direkte,

distribuimet e kanaleve të RTK-së, mirëmbajtjen e pajisjeve teknike dhe sistemin energjetik në RTK.

Në vitin 2024 janë bërë investime kapitale në teknologji si në vijim:

NR.	INVESTIMET GJATË VITIT 2024 NË DEPARTAMENTIN E TV TEKNOLOGJISË	VLERA EURO
1	Videomikser dhe audiomikser me pajisje përcjellëse për studion 2	49, 945
2	Moduli i baterive për UPS 32KVA në server room	8, 000
3	TV 75” për skenografi të studios 2	990
4	Bateri për UPS që furnizon studiot 1&2 dhe montazhit	7, 680
5	Dekodera për pranime të sinjaleve satelitore dhe IP	43, 000
6	Professional satellite demodulatore	23, 000
		132, 615

Transmetim dhe lidhje

Kjo njësi ka planifikuar, organizuar dhe realizuar transmetimet e drejpërdrejta nga terreni për të gjitha kanalet e RTK-së, në të gjitha format e transmetimit si: transmetimet me fibër optik (VPN), transmetimet me Uplink satelitor apo SNG, transmetimet me 4G, skype, zoom, viber, facebook, Youtube etj. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur transmetimet e realizuara gjatë vitit 2024:

Njësia e Transmetimit dhe Lidhjeve mundëson distribuimin e kanaleve të RTK 1, RTK 2, RTK 3 dhe RTK 4 në rrjetet e kompanive kabllore, dhe distribuimin e RTK 1 në rrjetin tokësor përmes KTTN. Sipas kërkesave programore, në koordinim të plotë me njësinë e medieve online janë dërguar sinjalet direkte dhe janë bërë transmetimet e eventeve në platformat online si Facebook, Youtube etj.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar edhe shumë transmetime të ndryshme të eventeve të mbajtura në Kosovë, të realizuara me regji të RTK-së apo në disa raste është marrë sinjali i gatshëm nga produksionet e jashtme në vendin e ngjarjes dhe është transmetuar nga RTK.

Disa nga eventet dhe transmetimet më të rëndësishme gjatë vitit 2024 janë si në vijim: Koncerti i Vjenës, ndeshjet, përmbledhjet dhe magazinat e UEFA 2024-2027 për UCL, UEL, UECL, Lojërat olimpike Parisi 2024, ndeshjet e përfaqësueses së Kosovës në futboll, ndeshjet futbollistike të klubeve kosovare në parakualifikimet për UCL, UEL dhe UECL, Festivali i dytë i këngës në RTK, akademi përkujtimore, programe edukative, kulturore, programe për fëmijë dhe shumë programe tjera të rëndësishme të RTK-së.

Këtë vit në RTK janë rikthyer transmetimet e ndeshjeve të UEFA-së, UCL, UEL, UECL andaj në kuadër të përgatitjeve teknike janë bërë blerë e dy dekodera për pranimin e sinjaleve për ciklin

2024-2027 me standarde dhe formate të reja 1080p si dhe UHD. Gjithashtu në kuadër të përgatitjeve teknike për transmetimin e lojërave Olimpike Parisi 2024 janë blerë dy demodulatorë të domosdoshëm për pranimin e sinjaleve satelitore. Të gjitha transmetimet e këtyre eventeve të rëndësishme janë kryer me sukses pa ndonjë problem.

Kjo njësi ka realizuar transmetime edhe me uplink satelitor për programet e RTK-së siç janë transmetimet e ndeshjeve futbollistike të klubeve Kosovare në parakualifikimet për UCL, UEL dhe UECL. Njësia e Transmetimit dhe Lidhjeve ka mbikëqyrur sistemin e këmbimit të materialeve me EBU përmes IP serverit në koordinim me inxhinierët e EBU, i cili mundëson qasje në ato materiale nga rrjeti i brendshëm i RTK-së.

TEKNOLOGJIA MOBILE

Kjo njësi ka organizuar, planifikuar dhe realizuar tërë procesin teknik të punës që ka të bëjë me xhirimet të cilat realizohen me OB-van dhe është përgjegjëse për të gjithë teknologjinë mobile në RTK.

Gjatë vitit 2024 është rritur dukshëm prodhimi i programit me OB-van si psh. programet e sportit vendore apo ndërkombëtare, programet kulturore, edukative, argëtuese, programe për fëmijë, programe festive si dhe xhirimet e programeve të rregullta në studio 4 dhe studio 5, xhirimet e programeve festive për vitin e Ri**.** Po ashtu janë realizuar edhe xhirime me dron dhe të gjitha kërkesat janë dërguar në Aviacionin Civil të Kosovës për aprovim paraprak.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar xhirimet me OB-van dhe dron si në vijim:

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Numri i xhirimeve	4	10	7	6	8	9	8	15	12	6	4	6
OB-van	**574 xhirime me OB-van**											
Dron	**95 xhirime me Dron**											

Disa nga eventet e rëndësishme që janë realizuar me OB-van gjatë këtij viti janë si në vijim:

Parakualifikimet për garat e UEFA-së në UCL, UEL, UECL, Kampionati Europian i xhudos në Prishtinë, **Koncerti i 50 vjetorit të këngëtares Shkurte Fejza**; **Maratona e Prishtinës 2024; Festivali i Këngës në RTK; Programi Festiv të Vitit të Ri 2024.**

TEKNOLOGJIA E STUDIOS DHE MIRËMBAJTJA E PAJISJEVE TEKNIKE

Njësia e Teknologjisë së studios ka mundësuar kushtet teknike për prodhimin e programit në studiot e RTK-së sipas standardeve të përcaktuara teknike, duke përfshirë: kamerat e studios, pajisjet e regjisë, pajisjet e zërimit, audio video mikserë, prompterët, videuall, sistemi i mikrofonave, interkomi, përkthimet simultane, komentimet, ndërlidhjet mes studiove, ndërlidhjet e studiove me TX dhe MCR etj. Kjo njësi ka kryer mirëmbajtjen e sistemit dhe zgjerimin e sistemit ekzistues duke përcjellë zhvillimet e reja teknologjike dhe aplikimin e risive në sistem me ekipin profesional. Është përgjegjëse për kualitetin e video/audio sinjalit i cili prodhohet apo që reprodukohet në studio. Stafi inxhiniereve në këtë njësi konfiguron, instalon, kalibron, përditëson firmwaret e të gjitha pajisjeve të videos dhe audios, në bashkëpunim me inxhinierin e mirëmbajtjes përpilojnë listën e pjesëve rezervë për pajisje në sektorin përkatës.

ENERGJETIKA

Njësia e energjetikës është përkujdesur për mirëmbajtjen e pajisjeve të sistemit elektroenergjetik në RTK, mirëmbajtjen dhe servisimin e rregullt të gjeneratorëve dhe UPS-ve duke siguruar furnizim të pa ndërprerë me energji elektrike edhe në rastet kur ka ndërprerje të rrjetit të qytetit. Kjo njësi është përkujdesur për mirëmbajtjen e sistemit të ndriçimit në të gjitha objektet e RTK-së, intervenimet permanente në instalimet elektrike të stërvjetëruara, riparimet e nevojshme në objektin e RTK-TV dhe objekteve përcjellëse në aneks te autoparku.

Po ashtu stafi i energjetikës është përkujdesur për mirëmbajtjen sistemit të klimatizimit të studiove, zyrave dhe të gjitha hapësirave teknike në objektet e RTK-së. Në server rom është bërë zëvendësimi i dy kondicionerëve të amortizuar me dy kondicionerë të rinj 24BTU dhe është bërë stabilizimi i temperaturës së dhomës.

LOGJISTIKA

Përgjatë vitit 2024 është bërë koordinimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve dhe ecurisë së punës të cilat kanë qenë të planifikuara, identifikimi dhe zgjedhja e problemeve në të gjitha njësitë, monitorimi i mirëmbajtjes së objekti (pastërtisë), monitorimi i mirëmbajtjes së veturave zyrtare (regjistrimin e rregullt, sigurimin, kontrollimin teknik, mirëmbajtjen dhe servisimin), kontrollimi i shpenzimeve të mallit të nevojshëm si: derivatet për vetura, derivatet për gjenerator, derivatet për nxemja qendrore, ujë dhe mbeturinat për RTK1.

Autoparku

Janë realizuar me sukses transporti i ekipeve në terren me vetura zyrtare, shpërndarjen e materialeve dhe shkresave të ndryshme sipas nevojave te RTK-se dhe kërkesave të shërbimeve të ndryshme brenda RTK-së, mirëmbajtjen e veturave zyrtare siç janë: kontrollimi i vaji të motorit,

ujit, dhe përkujdesja në baza ditore, dërgimi i veturave në servis me kërkesë të Udhëheqësit të Autoparkut, janë përkujdesur që të bëhet lajmërimi me kohë i skadimit të regjistrimit dhe sigurimit të veturave zyrtare. Kanë qenë të përgjegjshëm në shfrytëzimin racional të derivateve. Raportimi i rregullt me shkrim në baza ditore për gjendjen e automjeteve zyrtare nëse ka pasur nevojë, janë angazhuar edhe jashtë orarit të punës sidomos në veri të Kosovës ku ka pasur tensione dhe një veturë është thyer nga huliganet e minoritetit serb. Ngasësit gjithashtu kanë ndihmuar për përgatitjen e festivalit në RTK-ë dhe programit të vitit të ri. Kanë arritur të gjitha objektivat e punës dhe kanë treguar edhe aftësi dhe cilësi të punës gjithnjë sipas përshkrimit të punës.

Përdorimi total i karburantit:

Tabela përmban sasitë e litrave të karburantit për çdo muaj dhe totalin mujor për çdo veturë. Një total vjetor është llogaritur për të pasqyruar përdorimin total të karburantit për vitin 2024.

Shpenzimet e derivateve për periudhën: Janar - Dhjetor 2024

Nr.	Targa e vetures	Org.	Lista e shoferëve të ngarkuar me	Sasia e litr. Janar '24	Sasia e litr. Shkurt '24	Sasia e litr. Mars '24	Sasia e litr. Prill '24	Sasia e litr. Maj '24	Sasia e litr. Qershor '24	Sasia e litr. Korrik '24	Sasia e litr. Gusht '24	Sasia e litr. Shtator '24	Sasia e litr. Tetor '24	Sasia e litr. Nentor '24	Sasia e litr. Dhjetor '24	Totali sipas shoferëve,dhe veturave
1	**01-260-MR**	TV 1	Drejtoria	130.09	137.62	237.63	186.74	215.24	249.69	211.33	211.78	361.89	380.56	130.39	125.80	**2,578.76**
2	**01-896-CE**	TV 1	OBV-Gazmen Gashi	50.00	0.00	84.61	45.00	0.00	243.09	0.00	103.89	0.00	54.00	107.59	173.63	**861.81**
3	**01-461-NA**	TV 1	Gazmend Gashi	98.84	76.36	74.41	152.75	148.90	134.33	172.28	120.02	74.05	120.37	99.53	76.01	**1,347.85**
4	**01-672-NE**	TV 1	Latif Salihu/Latif Rezhepi	204.70	200.61	120.16	210.20	117.62	275.94	125.12	131.35	117.15	200.69	158.13	200.30	**2,061.97**
5	**01-698-NE**	TV 1	Ismet Berisha	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	**0.00**
6	**01-673-NE**	TV 1	Sejdi Ilazi	116.59	77.60	150.78	134.57	183.07	123.66	214.83	105.85	82.66	82.24	117.65	78.27	**1,467.77**
7	**01-990-BI**	TV 1	Besart Krasniqi	141.92	59.49	113.02	28.99	0.00	45.56	50.36	32.00	0.00	84.92	79.29	0.00	**635.55**
8	**01-574-NA**	TV 1	Fatmir Shabani	87.54	133.36	107.62	156.25	199.79	138.32	90.10	132.94	202.45	160.98	115.20	172.30	**1,696.85**
9	**01-860-MT**	TV 1	Nermin Jaha	70.39	108.18	70.00	139.34	164.31	117.17	121.02	129.79	86.58	95.86	178.63	167.36	**1,448.63**
10	**01-458-NA**	TV 1	Lorik Xhoci	308.93	174.17	215.66	235.54	249.20	286.82	205.42	182.73	106.38	83.55	129.15	117.19	**2,294.74**
11	**01-531-CZ**	TV 1	Ismet Berisha	107.76	161.00	111.36	94.21	101.91	191.91	113.23	105.00	33.33	93.68	96.50	106.78	**1,316.67**
12	**01-462-NA**	TV 1	Engin Nuza	64.26	140.46	88.01	139.17	82.00	101.02	115.22	119.45	63.02	146.44	95.01	101.00	**1,255.06**
13	**01-463-NA**	TV 1	Shishmek	32.85	72.33	0.00	108.88	75.56	177.25	113.86	80.00	78.58	88.90	68.27	73.08	**969.56**
14	**01-465-NA**	TV 1	Neki Mustafa	92.20	131.46	88.88	88.81	94.66	130.74	56.92	110.87	68.68	97.85	35.72	65.05	**1,061.84**
15	**01-474-NA**	TV 1	Bardh Bekteshi	37.60	34.25	71.00	40.56	38.97	41.67	59.39	71.61	0.00	40.48	39.84	0.00	**475.37**
16	**01-476-NA**	TV 1	Zymber Leci	126.07	130.95	149.95	159.89	140.68	159.88	168.80	135.70	112.98	91.60	94.63	81.88	**1,553.01**
17	**01-895-CE**	TV 1	Nuk ka të ngarkuar	0.00	27.40	0.00	0.00	0.00	40.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	**67.40**
18	**01-577-AH**	TV 1	Nuk ka të ngarkuar	77.28	65.14	69.00	0.00	0.00	0.00	66.51	110.91	133.70	0.00	0.00	0.00	**522.54**
19	**01-745-EP**	TV 1	Nuk ka të ngarkuar	0.00	71.93	67.85	0.00	0.00	0.00	0.00	63.97	63.97	0.00	0.00	59.91	**327.63**
20	**01-668-AH**	TV 1	Islam Haaxhiu	116.88	111.41	109.77	119.40	147.46	73.55	107.66	84.83	118.12	119.05	119.05	117.19	**1,344.37**
21	**05-634-AT**	TV 1	Driton Ramadani	0.00	35.21	35.46	35.46	36.76	0.00	35.71	25.00	38.76	39.68	0.00	39.06	**321.10**
22	**04-981-IV**		Salif Zeqiri	35.97	26.77	34.72	35.46	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	**132.92**
			Total Litra	**1,899.87**	**1,975.70**	**1,999.89**	**2,111.22**	**1,996.13**	**2,530.60**	**2,027.76**	**2,057.69**	**1,742.30**	**1,980.85**	**1,664.58**	**1,754.81**	**23,741.40**

Shpenzimet e derivateve për periudhën: Janar - Dhjetor 2024

Tabela përmban sasitë e litrave të karburantit për totalin vjetor. Një total vjetor është llogaritur për të pasqyruar përdorimin total të karburantit për ngrohje me kaldajën e vjetër që është me naftë dhe për gjeneratorët për vitin 2024.

13.Radio Kosova

Gjatë vitit 2024 RTK Radio (RK1 dhe RK2) ka realizuar arritjet në këto fusha:

1) Modernizimi teknologjik dhe përmirësimi i infrastrukturës, **2)** Zgjerimi dhe diversifikimi i skemës programore, **3)** Integrimi dhe përfshirja në rrjete sociale
JANAR **1) Fuqizimi i Transmetimit:** Instalimi i dy transmetuesve të rinj në Golesh për RK1 dhe RK2, duke rritur fuqinë transmetuese për 10 herë në frekuencat 95. 7 MHz dhe për RK2 në frekuencat 97. 7 MHz. **2) Rregullimi i Ngrohjes Qendrore:** Instalimi i sistemit të ngrohjes qendrore në hapësirat OnAir dhe produksionit pas 23 vitesh **3) Përmirësimi i Kushteve të Punës:** Blerja e 30 karrigeve të reja për stafin. **4) Inovacion Teknologjik:** Aktivizimi i softuerit vMix për thirrje telefonike dhe video-thirrje.
SHKURT **1) Program Special për Ditën e Pavarësisë:** Transmetime live për 16 orë në RK1 dhe 6 orë në RK2. **2) Nisma të Reja Programore:** Fillimi i emisioneve “Nëpër Kosovë” në RK1 dhe “Night Session” në RK2. **3) Promovimi dhe rritja e angazhimit në rrjete sociale:** Transmetimi live i emisioneve dhe standardizimi i grafikave.
MARS **1) Program Special për Epopenë e UÇK-së:** Transmetime live nga Prishtina, Prekazi dhe Dukagjin. **2) Renovimi i Studiove:** Instalimi i tavolinës dhe skenografisë së re në Studion 1 OnAir.
PRILL **1) Projekte dhe Tenderime:** Lansimi i tenderit për blerjen e transmetuesve të rinj. **2) Inovacion Teknologjik:** Instalimi i softuerit JAZLER për automatizimin e transmetimeve. **3) Zhvillime Programore:** Shtimi i emisioneve “Bulevardi” dhe “Prapaskena” në RK2.
MAJ **1) Transmetime Speciale:** Transmetimi i ciklit të dokumentarëve për Radiodramat e Radio Prishtinës dhe natës finale të Eurovizionit. **2) Performanca Online:** Rritje e arritshmërisë dhe angazhimit me 442% dhe 625% përkatësisht.
QERSHOR **1) Program Special për “Javën e Lirisë”:** Transmetime nga 11 deri më 19 qershor. **2) Përmirësime Teknike:** Fillimi i renovimit të studios dhe gëlqerosja e katit të parë.
KORRIK **1) Zbatimi i Skemës Verore:** Realizimi me sukses i programeve verore në të dy kanalet. **2) Modernizimi i Pajisjeve:** Instalimi i audio miksetave digjitale **3) Përforcimi i aspektit të sigurisë:** Instalimi i kamerave të reja të sigurisë.
GUSHT **1) Modernizim Teknik:** Instalimi i sistemit të ri të antenave dhe transmetuesve në Cërnushë, Maja e Gjelbër dhe Zatriq. **2) Përmirësimi i Infrastrukturës:** Përurimi i pesë kabinave të reja për incizimin e zërit (Boothroom) **3) Digjitalizimi i studios:** Instalimi i miksetave të reja transmetuese në dy studio onair të Radio Kosovës.
SHTATOR **1) Skema Speciale Programore për 25-vjetorin e RTK-së**

2) Transmetimi i dokumentarit për rrugëtimin e Radio Kosovës. **3) Renovimi i Studiove:** Panele akustike në Radio Kosova 2.
TETOR **1) Mbulimi i Festivalit të Këngës:** Transmetime live nga Pallati i Rinisë dhe 98 intervista ekskluzive. **2) Rritja e Performancës Online:** 1, 100 ndjekës të rinj në Facebook dhe reach prej 880, 500.
NËNTOR **1) Zgjedhjet presidenciale në SHBA:** Transmetime live dhe analiza të hollësishme nga ekspertë. **2) Ndeshja e Kombëtares së Kosovës:** Mbulimi i ndeshjes në futboll kundër Rumanisë, në kuadër të Ligës së Kombeve. **3) Prishtina Music Conference:** Mbështetje si sponsor medial dhe transmetim i ngjarjeve kryesore të konferencës **4) Panairi i Librit Tirana 2024:** Promovim i aktiviteteve dhe intervista me autorë pjesëmarrës. **5) Programi special për 28 Nëntorin:** Transmetime live nga Kosova, Tirana dhe Vlora me aktivitete festive.
DHJETOR **1) Programi festiv i Vitit të Ri:** Emisione speciale në RK1 dhe RK2 me performanca live. **2) Digjitalizimi i arkivit të Radio Prishtinës:** 10, 723 shirita të digjitalizuar, 3, 718 orë materiale audio. **3) Nisja e podcast-it "Pawcast":** Program audio-video unik në Kosovë. **4) Mbulimi i Festivalit të 63-të të Këngës në RTSH nga RK2.**

PERFORMANCA E FAQES SË RADIO KOSOVËS NË FACEBOOK GJATË VITIT 2024

RK gjatë vitit 2024, ka arritur sukses në rrjetet sociale, duke shtuar numrin e ndjekësve të rinj dhe të reach-it total të audiencës online, gjë që tregon për përmirësimin e pranisë digjitale dhe të ndikimit të RK në platformat online. Sipas të dhënave të Facebook, gjatë vitit 2024, krahasuar me vitin paraprak, faqja zyrtare e RK-së ka shënuar një rritje prej **2, 512, 455** përdoruesish (+181. 3%).

STATISTIKAT PËR 2024 DHE KRAHASIMI ME VITIN 2023	
TOTAL REACH	**2, 512, 455 përdorues** (rritje prej **181. 3%** nga viti 2023)
NDËRVEPRIME	**6. 2 milionë** (rritje prej **784. 1%** nga viti 2023)
KOHA TOTALE E SHIKIMIT	**2319** ditë dhe **14** orë
VIZITA NË PROFIL	**242. 7 mijë** (rritje prej **402. 9%** nga viti 2023)
KLIKIME NË VEGZA	**2. 9 mijë** (rritje prej **173. 9%** nga viti 2023)
NDJEKËS TË RINJ	11. 3 mijë (rritje prej **607. 8%** nga viti 2023)
PËRMBAJTJA E PUBLIKUAR	Rritje për **57%** nga viti 2023

13.1 RADIO KOSOVA 1

STATISTIKAT E PËRGJITHSHME

Redaksia e Informacionit në Radio Kosova 1

Redaksia e informacionit në Radio Kosovë gjatë vitit 2024 ka qenë e angazhuar në përcjelljen e të gjitha ngjarjeve të rëndësishme në vend nga fushat: politikë, ekonomi, arsim, kulturë, shëndetësi e mirëqenie sociale etj. Radio Kosova, në programin e parë, gjatë ditës fillon edicionet informative nga ora 06:00 e mëngjesit deri në mesnatë, ku përveç edicioneve të shkurtra, transmetohen edhe edicionet e zgjeruara, si: Edicioni i Mëngjesit, Mesditës, Qendror, Mbrëmjes dhe edicioni i Mesnatës. Gazetarët dhe redaktorët e dhomës së lajmeve gjatë vitit 2024 kanë realizuar rreth **427** tema dhe mbi një mijë raporte. Radio Kosova ka mbuluar gjithashtu zgjedhjet në SHBA më 5 nëntor ku nga atje e dërguara jonë, Hyre Tejeci ka realizuar **28** paraqitje nga Nju Jorku për: Programin e mëngjesit, Edicionet e lajmeve, Emisionin "Fokus", Emisionin për bashkatdhetarët, Emisione në Televizion, Uebfaqen, dhe rrjetet sociale (Facebook dhe YouTube).

DISA NGA TEMAT MË TË RËNDËSISHME REALIZUAR NGA DHOMA E LAJMEVE GJATË VITIT 2024		
MUAJI	**NR.**	**TEMAT E VEÇUARA**
JANAR	50	Sfidat e sigurisë; Mungesa e njohjeve; Liberalizimi i vizave dhe ndikimi në punësim; Sigurimet shëndetësore; 25 vjetori i Masakrës së Reçakut; Intervistë me kongresistin amerikan, Ritchie Torres; Zbatimi i rregullores së BQK-së për dinarin.
SHKURT	36	Shënimi i përvjetorit të pavarësisë; Largimi i dinarit, ndikimi në ekonomi; Sanksionet e BE-së ndaj Kosovës; Mbledhja e Këshillit të Sigurimit; Rënia e numrit të nxënësve në shkolla; Vaksinimi kundër kancerit të qafës se mitrës; Punimet në infrastrukturën rrugore, zvarritjet e projekteve.
MARS	36	Darft Statuti për Asociacionin; Vendimi për Manastirin- anëtarësimi në KE; Marrëveshjet ndërkombëtare; 43 vjetori i demonstratave të marsit 81; Dita ndërkombëtare për mbrojtjen e konsumatorëve; Funksionimi i Gjykatës komerciale; Deklarimi i pasurisë; Rregullat e reja te trafikut.
PRILL	33	Takimet në Bruksel për dialogun; Regjistrimi i Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave; Intervistë me diplomatin austriak Volfgang Petrich; Asociacioni në Gjykatën Kushtetuese; Policia gjyqësore; Raporti i DASH-it për Kosovën; Armët pa leje dhe vrasjet; Shuarja e bizneseve.
MAJ	41	Kompensimi i viktimave të luftës; Targat serbe në RKS; Asociacioni, kusht për anëtarësim në KE; Procesi i regjistrimit të popullsisë; Masat e BE-së, ndikimi në ekonomi; Përgatitjet për mësimin tëreditor; Testi i arritshmërisë; Dita Botërore pa Duhan.

QERSHOR	32	Puna e Kuvendit të Kosovës; Dita ndërkombëtare e Fëmijëve; Reformimi i skemës së asistencës sociale; Panairi i librit; Dita botërore e sigurisë ushqimore; Festa e Kurban Bajramit; Degradimi i tokave; Ndotja e mjedisit; Hekurudha Prishtinë-Durrës.
KORRIK	41	Takimi në Bruksel, analiza; Reforma në drejtësi; Lëvizja e Lirë KS- BeH; Matura shtetërore; Fushata e korrje-shirjeve; Ndikimi i temperaturës së lartë; Problemi i qenve endacakë; Siguria në burgjet e Kosovës.
GUSHT	41	Greva e Minatorëve; Dialogu dhe Siguria pas mbylljes se postave në veri; Integrimi i serbeve të Kosovës në veri; Masat e reja të BE-së, ndaj Kosovës; Fushata parazgjedhore, koalicionet parazgjedhore; Hapja e Urës mbi lumin; Zjarret në disa rajone të Kosovës; Shtimi i rasteve me covid-19; Rritja e investimeve të huaja në Kosovë; Fillimi i vitit te ri shkollor, Tekstet shkollore Subvencionimi i teksteve shkollore; Dita Botërore e të zhdukurve
SHTATOR	26	Dialogu Kosovë– Serbi, (jo) transparenca; Vonesat e subvencioneve; Shtimi i sulmeve me arme zjarri në qytete; Realizimi i mësimit tërë ditor; Verifikimi i diplomave; Vaksinimi kundër gripit sezonal, Situata epidemiologjike; 25 vjetori i RK-së, Material për 25 vjetorin e RTK-së; Gërmimet vlerësuese për të pagjeturit Sensorët për diabetikët; Mungesa e digjitalizimit në shkolla
TETOR	30	Statistikat për dëmet e luftës; Festiavli i RTK-së; Përzgjedhja e mjekut familjar; Dita kundër varfërisë; Ashpërsimi i gjuhës së politikanëve; Kushti i BE-së për Kosovën; Tetori muaji për vetëdijesimin kundër kancerit të gjirit; Kolonat në trafik; Vlerat e larta të Mg. në ujin e Liqenit të Badocit; Mbyllja e zyrës ndërlidhëse të Sllovakisë në Kosovë; Edicioni i dyte Festivali i Këngës; Plani i Rritjes për vendet e Ballkanit Perëndimor; Ndikimi i mallrave serbe në ekonominë e Kosovës; Reagimet për rritje të pagave
NËNTOR	30	Mos funksionimi normal i Kuvendit; Vet- lëndimi i nxënësve në Tik-tok; Buxheti - 2025; Tatimet në pronë tek bizneset; Dita ndërkombëtare e radiologjisë; Vlerësimi i mësimdhënësve; Të burgosurit e Danimarkës në Kosovë; Problemet me shikim tek fëmijët; Dita Botërore e Diabetit; Intervistë me ambasadorin Petrit Malaj; Takimi i dy qeverive; Ligji për sigurime shëndetësore; Fëmijët me aftësi të kufizuara
DHJETOR	31	Gripi sezonal; Sulmi në Zubin Potok; Mungesa e infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara; Dialogu-kushtet; Vallja e Tropojës në UNESKO; Kurti në Sarajevë; Edicioni i dytë i festivalit "Aktori dhe Poeti"; Zhvillimi i FSK-së për 6 vjet; Ekspertët e sigurisë; Trajtimi i policëve të aksidentuar dhe shkaqet; Çmimi i banesave; Paralajmërimet e SBASHK-ut për grevë; Humbja e vitit shkollor, braktisja e shkollës; Interneti Starlink në Kosovë; Mos certifikimi i Listës Serbe; Gjendja e rrugëve; Problemet me rrymë; Lija e majmunëve; Licenca për mësimdhënës; Shporta e konsumatorit-qytetar-Selatin Kaçaniku
TOTAL:	**427**	

1.PROGRAMI SPECIAL “JAVA E LIRISË”

Gjatë muajit qershor, RK1 ka realizuar programin special “Java e Lirisë”, që ka mbuluar ngjarjet e përvjetorit të çlirimit të Kosovës, me fokus në aktivitetet e zhvilluara nga komunat në Kosovë. 2. EURO 2024 – TRANSMETIME SPORTIVE

RK1 ka filluar një emision special kushtuar kampionatit evropian të Futbollit, "Euro 2024", nga data 14 qershor duke vazhduar edhe në muajin korrik, ku audiencaka mundur të ndjek çdo ditë ngjarjet më të rëndësishme të kampionatit. Transmetimi ka filluar çdo ditë nga ora 14:00 deri në orën 15:00, duke pasur gjithashtu një segment të veçantë për komentimin dhe analizën e ndeshjeve, si dhe ka ofruar përmbajtje të pasur për të interesuarit për futboll.

3. **PROGRAMI VEROR**

Gjatë periudhës së skemës verore, nga data 15 korrik deri më 14 gusht, RK1 dhe RK2 kanë realizuar program të pasur me **13** edicione speciale. Ky program ka përfshirë **50** intervista të realizuara me mysafirë të ndryshëm, me **22** paraqitje të drejtpërdrejta nga bregdeti shqiptar dhe lokacione turistike brenda Kosovës.

4. FESTIVALI i KËNGËS NË RTK

Projekt i rëndësishëm i vitit 2024 ishte mbulimi i **Festivalit të Këngës** në RTK. Gjatë muajit tetor, RK1 dhe RK2 kanë organizuar një kuiz në emisionet "Fol Shlirë" dhe "Gramafon", ku janë shpërndarë bileta për festivalin, duke krijuar një atmosferë festive dhe interaktive për dëgjuesit. Për një javë para fillimit të festivalit, RK ka organizuar “Java e Festivalit”, duke intensifikuar aktivitete promovuese përmes intervistave ekskluzive me pjesëmarrësit dhe mysafirët e festivalit. Transmetimi i drejtpërdrejtë i festivalit është realizuar në dy kanalet e RK-së, dhe për herë të parë është përdorur një studio mobile e vendosur në Pallatin e Rinisë.

5. PROGRAMI PËR 28 NËNTORIN - DITA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

Për Ditën e Pavarësisë së Shqipërisë, RK ka realizuar një program të veçantë, nga ora06:00 e mëngjesit deri në mesnatë. Ky program ka ofruar një pasqyrë të thellë të ngjarjeve historike që çuan në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe ka përfshirë paraqitje të drejtpërdrejta nga komunat e Kosovës, si dhe nga Tirana dhe Vlora. Programi ka përfshirë aktivitete festive dhe ka pasur edhe një performancë të një grupi folklorik.

6. MARRËVESHJE DHE SPONSORIZIME

Në vitin 2024, RK ka realizuar disa marrëveshje sponsorizimi për ngjarje të rëndësishme kulturore. Disa nga këto janë: Prishtina Music Conference (vlera 300 EUR), Sunny Hill Festival (vlera 3, 000 EUR), dhe një marrëveshje me IPKO për sponsorizimin e emisioneve për vitin 2025 (vlera 6, 000 EUR). Këto marrëveshje kanë pasur një ndikim pozitiv, jo vetëm duke sjellë përmbajtje të pasur programore, por edhe duke mundësuar shpërblime për dëgjuesit, me dy lojëra shpërblyese që kishin vlera 3, 000 EUR dhe 300 EUR.

13.2 PROGRAMET NË RADIO KOSOVA 1 GJATË VITIT 2024

13.2.1 Programi i mëngjesit

Gjatë vitit 2024, në Programin e Mëngjesit në RK1, janë realizuar dhe transmetuar gjithsej **527** intervista, por edhe tema të tjera aktuale nga sfera të ndryshme, në bashkëpunim edhe me Dhomën e Lajmeve nga Departamenti i Informacionit i RK1. Përfaqësimi gjinor ishte **212** gra dhe **279** burra. Skema në kuadër të programit të mëngjesit është realizuar plotësisht, sipas kohës dhe zhvillimit të ngjarjeve. Në fokus kanë qenë tema për të rinj, etj.

Projekte më të mëdha të mëngjesit për këtë periudhë kanë qenë: Shënimi i 25 vjetorit të RTK-së; Mbulimi i zgjedhjeve presidenciale në SHBA; 28 Nëntori – Dita e Flamurit Kombëtar; Përgatitja për festat e fundvitit.

Redaksia e Mëngjesit në RK1 ka publikuar edhe materialet në Facebook dhe Youtube. Për këtë periudhë janë publikuar **135** materiale nga të cilat janë: **122** moderime; **207** intervista; **130** kronika televizive; **32** kronika audio; **135** raporte; **7** reportazhe; **4** anketa; **5** paraqitje të drejtpërdrejta; **100**fjalë shqipe në rubrikën “Ta duam gjuhën shqipe”, **135**postime në Facebook dhe Youtube. Ndarja e mysafirëve sipas gjinisë: **89** gra dhe **118** burra.

Ndërsa sa i përket sportit në Redaksia e Mëngjesit në RK1 janë pasqyruar këto tema: Ndeshjet e Kosovës dhe Shqipërisë në kuadër të xhiros së dytë të Ligës së Kombeve; Trepça fiton Superkupën e Kosovës në basketboll, pasi ka triumfuar ndaj Prishtinës; Kosova fiton tetë medalje në Olbia të Italisë; Ndeshjet e Superligës së Kosovës në futboll; Fitore e Kosovës në grupmoshën ndaj Spanjës në grupmoshën U19; Turneu i 26 ndërkombëtar të Boksit në Kosovë; Ngjarjet më të mëdha të sportit në vendin tonë.

13.2.2 Emisioni “Morning show”

“Morning Show” transmetohet çdo ditë pune (e hënë – e premte) në RK1, nga ora **08: 10 – 09: 30**. Emisioni mbulon përmbajtje informative, argëtuese dhe intervista, si dhe realizon intervista ekskluzive dhe transmetime të drejtpërdrejta nga ngjarje në Kosovë si: Vërshimet në Dragash**,** Zjarret në bjeshkët e Lubeniqit etj.

13.2.3 EMISIONI "METROPOL"

Emisioni "Metropol" transmetohet pesë ditë të javës, nga e hëna në të premte, nga **ora 09: 30 deri në ora 11:00**, dhe deri më **31 dhjetor 2024**duke u transmetuar live edhe në **TV**. Ky emision ka vazhduar të ofrojë përmbajtje të larmishme, duke përfshirë intervista dhe diskutime mbi çështje të ndryshme me interes për audiencën. Gjatë vitit 2024 janë realizuar gjithsej **223** emisione **"Metropol"** me **43** të ftuar.

13.2.4 Emisioni "Mesdita në radio"

Emisioni **"Mesdita në Radio"**transmetohet çdo ditë pune nga **ora 11: 03 deri në orën 14:00** në kanalin e parë të **Radio Kosovës**.

13.2.5 EMISIONI "RADIO FOKUS"

Emisioni katër ditor "Radio Fokus" gjatë vitit **2024**ka trajtuar tema të ndryshme, duke sjellë në studio aktorë të rëndësishëm nga fusha e politikës, ekonomisë, kulturës dhe shoqërisë civile. Emisioni është realizuar edhe me video, ndërsa transmetimi përmes rrjeteve sociale dhe YouTube ka ndikuar në rritjen e dëgjueshmërisë dhe shikueshmërisë.

13.2.6 Redaksia e dokumentarit dhe reportazhit

Gjatë vitit **2024**, Redaksia e Dokumentarit dhe Reportazhit ka realizuar gjithsej **9** radiodokumentarë; **36** reportazhe, nga të cilat **5** reportazhe speciale, të përfshira në ciklin **"Turistë në vendin tënd"**, të transmetuara gjatë **korrikut dhe gushtit** 2024; **3** materiale të dedikuara për festat e **Nëntorit**, duke përfshirë një radio-dokumentar dhe dy reportazhe mbi **simbole dhe identitete shqiptare**; **1** udhëpërshkrim.

ANGAZHIME SPECIALE

Në maj 2024, ka filluar cikli i **10** emisioneve javore për **Radiodramën**. Po ashtu, më 11 maj u transmetua finalja e **Eurovizionit 2024**.

EMISIONI "PA KUFIJ" (RADIO KOSOVA 1; RADIO TIRANA; RADIO SHKUPI; RADIO MALI I ZI)

Emisioni i përbashkët "Pa Kufij" transmetohet çdo të enjte, drejtpërdrejt nga ora **16: 30 – 17: 30** në Radio Tiranë dhe Radio Shkup, ndërsa në Radio Kosovë nga ora 21: 03 – 22:00. Gjatë vitit 2024, janë realizuar **43** emisione, me pjesëmarrjen e **43** të ftuarve. Ky format unik synon të fuqizojë bashkëpunimin mes radiove shqiptare dhe të trajtojë tema me rëndësi për shqiptarët në rajon. Emisioni **"Pa kufij"**gjatë muajve korrik-gusht 2024 ishte në pauzë.

13.2.7 Redaksia e muzikës

Gjatë vitit 2024, Redaksia e Muzikës ka realizuar me sukses pjesën muzikore të dy programeve në Radio Kosovë. Janë shkarkuar mbi **7, 500** këngë të huaja dhe vendore, duke përfshirë edhe këngë ekskluzive që janë transmetuar për herë të parë në Radio Kosovë. Janë edituar **340 këngë** me tekste eksplicite, duke zëvendësuar edhe këngët e arkivit të mëhershëm me përmbajtje të ngjashme. Janë shkarkuar dhe edituar **650** video spote të huaja dhe vendore. Gjatë vitit 2024 janë realizuar **261 emisione "RK Prezanton"**, ku nga e hëna deri të premten janë prezantuar zhanre të ndryshme të muzikës. Po ashtu është bërë instalimi dhe implementimi i softuerit për radio transmetim **Jazzler** në të dy radiot. Nga **4 prilli deri më 31 dhjetor**, është punuar në: Krijimin e kategorive muzikore dhe popullimin e softuerit me muzikë; Klasifikimin muzikor dhe riorganizimin e arkivës.

13.2.8 Redaksia e sportit

Përkundër mungesës së stafit, Redaksia e Sportit ka arritur të mbulojë me sukses aktivitetet e shumta sportive gjatë vitit 2024, si në nivel vendor ashtu edhe ndërkombëtar. Janë transmetuar ndeshjet e **Superligës së Kosovës** në futboll, si dhe janë realizuar paraqitje të drejtpërdrejta në **Televizionin e Kosovës** dhe rrjetet sociale të RTK-së, përmes intervistave dhe kronikave të ndryshme.

TRANSMETIME TË DREJTPËRDREJTA

Nga **14 qershor – 14 korrik 2024**, nga Redaksia e Sportit u transmetuan **32** emisione speciale, me pjesëmarrjen e **51** mysafirëve në studio dhe **27** të tjerëve përmes linjave të drejtpërdrejta**.**

Redaksia e Sportit në RTK-Radio ka përmbushur me sukses misionin gjatë vitit 2024, duke ofruar mbulim të gjerë të sportit vendor dhe ndërkombëtar për dëgjuesit e Radio Kosovës.

PASQYRA TABELARE E EMISIONEVE TË RADIO KOSOVA 1 GJATË VITIT 2024												
Emërtimi	**Emisione**	**Intervista**	**Info**	**Doku mentar**	**Tema**	**Kronika**	**Reportazh**	**Trans. Live**	**Rubrika " A e dini se"**	**Video/ Foto/ Lajme për rrjete**	**M**	**G**
Programi i mëngjesit	**362**	**527**									**279**	**212**
Morning Shou	**263**	**172**								**64**	**80**	**92**
Metropol	**223**	**43**									**24**	**19**
Mesdita në Radio	**194**	**181**	**1,222**						**241**		**97**	**84**
Fokus	**185**											

Redaksia e Dokumentarit dhe Reportazhit	**45**	**259**		**9**			**36**				**104**	**155**
Pa kufij	**43**	**43**									**40**	**3**
Ligjërim		**30**									**17**	**13**
Ekonomi Plus	**5**	**41**					**9**				**61**	**21**
Stetoskop	**48**	**45**									**28**	**17**
Hyjnesha	**41**	**41**									**0**	**41**
Nëpër Kosovë	**76**	**192**									**101**	**91**
Emisioni për fëmijë	**91**	**388**									**235**	**153**
Redaksia e Kulturës		**46**		**6**		**2**	**5**				**23**	**23**
Libri	**53**											
Fol Shlirë	**234**											
Kjo ditë në muzikë	**270**											
Hiti yt	**106**											
RK Prezanton	**261**											
Programi i Natës	**363**	**413**									**303**	**110**
Portat e natës	**52**											
Redaksia e Sportit	**135**	**159**				**229**	**6**	**83**				
Dhoma e Lajmeve					**427**	**<1.000**						
	3, 562	**2, 387**	**1, 222**	**15**	**427**	**1,231**	**56**	**83**	**241**	**64**	1, 372	1, 010

14.Radio Kosova 2

Gjatë vitit 2023, në kanalin e dytë të Radio Kosovës (**RK2**), janë realizuar të gjitha emisionet e parapara sipas skemës programore, duke ofruar një përmbajtje të pasur dhe cilësore për dëgjuesit. Secili muaj është karakterizuar me ngjarjet që kanë përkuar me datat të rëndësishme të vitit si: Programi "Java e Lirisë" realizuar nga RTK, 25 vjetori i hyrjes së trupave të NATO-s dhe çlirimi i vendit, Epopeja e UÇK-së, përkujtime, histori, aktivitete, Program special për 17 shkurtin – Ditën e Pavarësisë, Program special për 28 nëntorin, 25 vjetori i RTK-së, 13 shkurti – Dita e Radios, Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare, Dita e Lirisë së Shtypit, etj.

14.1 Redaksia programit të mëngjesit

Gjatë vitit 2024, janë realizuar **261** emisione të mëngjesit në RK2 me **417** intervista,

14.2 Redaksia për kulturë

Redaksia për Kulturë realizon emisione me ngjarje, kronika dhe mysafirë të ftuar, që pasqyrohen në emisionet: **"Ars"** ; **"Kult"** ; **"Për një botë më të mirë"** ; **"Universi Letrar"** ; dhe **"Edukimi Medial"**. Gjatë vitit 2024, janë realizuar gjithsej **255** emisione me tema të ndryshme me **110** të ftuar.

14.3 Redaksia për fëmijë

Emisionet **"Gramafon"** (**233** episode) dhe **"N'radio"** (**234** episode), gjatë vitit 2024, kanë realizuar të gjitha edicionet e parapara sipas skemës së RK2, duke transmetuar gjithsej **467** emisione, me gjithsej **223** të ftuar.

14.4 Redaksia e programit të natës

Në programin e natës në RTK - Radio 2, në janë realizuar **477** emisione të ndryshme të incizuara. Kështu, gjatë vitit 2024 janë transmetuar emisionet e parapara sipas skemës programore: **"Bulevardi"** (**44** episode), **"Rock & Blues"** (**44** episode), **"Pilot underground"** (**44** episode), **"Ora 22:00"** (**44** episode), **"World Music"** (**43** episode), **"Ecim nëpër qytete"** (**42** episode), **"Muzika Jazz"** (**42** episode), **"Rock Forever"** (**42** episode), **"Prapaskena"** (**45** episode), **"Java në 7 ditë**" (**44** episode), **"Warm Up"** (**43** episode).

Fundjava në RadioKosova2

Emisionet "Top Shqip", **"Top 10"**, **"Retro Shqip"**dhe **"Java në 7 ditë"**

Gjatë vitit 2024, emisionet **"Top Shqip"**dhe **"Top 10" "Retro Shqip" "Java në 7 ditë"** janë realizuar sipas skemës së paraparë në RK2, duke sjellë hite të reja vendore dhe ndërkombëtare. Gjithsej janë realizuar **230** emisione..

Programi i Verës në Radio Kosova2: SUMMERTIME (korrik - gusht 2024)

Emisioni i verës në kanalin e dytë të Radios, **"Summertime"**, ka filluar më 15 korrik dhe vazhduar deri më 16 gusht 2024. Gjatë kësaj periudhe, programi është ritransmetuar gjithashtu në kuadër të programit të natës, duke sjellë një atmosferë të veçantë verore për dëgjuesit. Ky program ka pasur një gamë të gjerë aktivitetesh dhe intervistash, duke përfshirë paraqitje të drejtpërdrejta, rubrika të ndryshme dhe materiale shumë interesante.

14.5 Redaksia e komuniteteve

Në kuadër të **Redaksisë së Komuniteteve** në **RK2** gjatë viti 2024janë trajtuar rregullisht ngjarje ditore, që janë emetuar në gjuhën serbe, turke, rome dhe boshnjake. Katër redaksitë e komuniteteve në Radio Kosovë, gjatë vitit 2024 kanë realizuar gjithsej **1** mijë e **44** edicione lajmesh, **944** tema të ditës**, 1 mijë e 13** kronika, **947** emisione autoriale, **940** rubrika, **1429** bashkëbisedues**,**

Programi në gjuhën serbe

Viti	Edicione lajmesh	Tema e ditës	Kronika, raporte	Emisione autoriale	Rubrika	Rubrika autoriale
2024	262	261	369	189	304	47

Programi në gjuhën boshnjake

Në gjysmën e parë të vitit 2024 (janar-maj), redaksia në gjuhën boshnjake funksionoi me vetëm dy anëtarë të redaksisë, redaktorin dhe një gazetare, sepse njëra kolege ishte në pushim të lehonisë, ajo u rikthye në redaksi më 2 maj 2024. Po ashtu që nga hapja e Zyrës Rajonale të RTK-së në Mitrovicë, në mars 2023, një redaktore është pjesë e asaj zyre, nga ku kontribuon në redaksi, me koordinim të vazhdueshëm me pjesën tjetër të redaksisë në zyrën në Prishtinë, ku shkon sipas nevojës. Gjatë vitit 2024 janë realizuar planet e planifikuara të punës së redaksisë, bazuar në skemën programore, e cila përfshin si më poshtë: Programi ditor i lajmeve **Vijesti** (e hënë-e premte); Rubrika ditore **"Tema e ditës**" (e hënë-e premte); -**Kronika**, **intervista** për tema aktuale nga vendi dhe komunitetet boshnjake në Kosovë, rajon dhe botë; Emisionet autoriale: **ProKult** (e martë) dhe **Usput rečeno** (e enjte); Rubrikat javore: **Sporti, Mjekësia, Ju prezantojmë, Bota e Artit, Shkenca dhe Teknologjija.**

Programi në gjuhën turke

Viti	Edicione lajmesh	Emisione	Informacione	Intervista	Tema	Ritransmetime
2024	258	499	900	235	420	-

Gjatë vitit 2024 redaksia në gjuhën turke në RK2 përpos ngjarjeve kryesore-ditore i ka kushtuar vëmendje zhvillimeve në komunitetin turk të Kosovës. Janë përcjellë dhe transmetuar problemet, sfidat dhe përparimi në arsimimin në gjuhën turke, problemet në punësimin e të rinjve të komunitetit turk të Kosovës, aktivitetet e partive turke në Kosovë (KDTP, YTHP), aktivitete e OJQ-ve turke, aktivitetet e organizatave të Turqisë në Kosovë (TİKA, Yunus Emre).

Programi në gjuhën rome

Viti	Edicione lajmesh	Emisione	Rubrika	Intervista e jave	Kronika	Ritransmetime
2024	261	156	260	53	262	-

Redaksia në gjuhën rome, i ka arritur gjithë objektivat për vitin 2024. Gjatë vitit 2024 ka realizuar **261** edicione të lajmeve në gjuhën rome; **262** kronika; **52** emisione autoriale "RomanoAvazo - Zëri i Romëve"; **52** emisione autoriale "Romane StandardikaneAlavya - Gjuha Standarde Rome"; **52** emisione autoriale "Roma ani Evropa - Romet në Evropë". Po ashtu janë realizuar **260**rubrika (**53** rubrika "Intervista e javës"; **53** rubrika "Kronika sportive"; **50** rubrika "Pro Medika - Pro Mjekësia"; **52** rubrika për fëmijë "Qhavorengi rubrika"; **52** rubrika "Romane muzikakeqerenya - Yjet e muzikës rome").

14.6 Produksioni dhe teknologjia

Objektivat e arritura gjatë vitit 2024**:**

1) Modernizimi i infrastrukturës teknologjike përmes planifikimit, specifikimit, instalimit dhe funksionalizimit të pajisjeve dhe sistemeve të reja; **2) Përmbushja e kërkesave programore**, duke realizuar transmetime live, incizime, editime të raporteve, lajmeve, rubrikave, promovimeve, siglave, dokumentarëve dhe materialeve të tjera; **3) Prodhimi i materialeve audiovizuale**, si podcaste, emisione dhe video, duke zgjeruar gamën e përmbajtjes për audiencën.

Investimet në infrastrukturë

Instalimi i transmetuesve dhe sistemit të antenave në 4 pika transmetuese: **Golesh** – instalimi i transmetuesve me fuqi 5KW; **Zatriq** – rritja e fuqisë transmetuese nga 70W në 3KW; **Cërnushë**– rritja e fuqisë transmetuese nga 30W në 1KW; **Maja e Gjelbër**– rritja e fuqisë transmetuese nga 70W në 1KW. Është bërë monitorimi në distancë i parametrave të transmetuesve përmes lidhjeve të internetit, duke rritur efikasitetin dhe cilësinë e sinjalit. Po ashtu ka përfunduar instalimi i furnizimit me energji elektrike dhe sistemit të mbrojtjes nga vetëtima për mbrojtjen e pajisjeve transmetuese.

Modernizimi i studiove të RK-së

Gjatë vitit 2024 u ndërmorën hapa të rëndësishëm për përmirësimin e infrastrukturës, hapësirave të RK-së, duke u mbështetur në profesionalizmin dhe përkushtimin e stafit të Departamentit të Produksionit dhe Teknologjisë, përfshirë të gjitha punët fizike, dhe punët si në vijim: **1)** Renovimi i dy studiove ON AIR; **2)** Demolimi i mureve të vjetra**,** montimi i paneleve akustike të reja dhe renovimi i dyshemeve; **3)** Sigurimi i paneleve akustike cilësore për përmirësimin e transmetimit; **4)** Ngjyrosja e hapësirave të produksionit**,** vendosja e logove ndriçuese dhe instalimi i radiatorëve të rinj për ngrohje qendrore.

Teknologjitë e implementuara

Instali**mi i audio miksetave digjitale:** 1) **CalrecTypeR në RK1,** 2) **CalrecTypeR në RK2**

Funksionalizimi i boothroom-it

1) Instalimi i 5 kabinave të reja për incizim me mikrofon dinamikë dhe audio kartela moderne. **2)** Eliminimi i zhurmave dhe krijimi i mundësisë për incizime pa ndihmën e teknikëve. **3)** Realizimi i thirrjeve audio/video përmes WhatsApp dhe Viber**.**

Zbatimi i sistemit rds (radio data system)

Me sukses është instaluar sistemi RDS (Radio Data System) për RK1 dhe RK2, duke mundësuar një përvojë të avancuar për dëgjuesit. Ky sistem përdor enkoderët RDS për të shfaqur në kohë reale informacion programor në marrësit FM, veçanërisht në automjete. Përmes RDS, dëgjuesit tani mund të kenë qasje në informacion të rëndësishëm dhe të dobishëm, duke përfshirë: **1)** skemat programore, **2)** titujt e këngëve dhe artistët, **3)** numrat e telefonit dhe adresën në internet, **4)** Frekuencat e të dy kanaleve të radios.

Modernizimi i transmetimit online

Përdorimi i softuerit "Spycorder" për transmetimin online me metadata.

Shpërndarja e përmbajtjes programore është modernizuar gjatë vitit 2024 me përdorimin e softuerit të ri "**Spycorder**", i cili mundëson një proces të thjeshtuar dhe të avancuar të menaxhimit dhe shpërndarjes së përmbajtjes. Për audiencën që dëgjon RK-në përmes internetit, ky softuer gjithashtu siguron shfaqjen e përmbajtjes programore, ballinat e albumeve dhe titujve të këngëve që transmetohen.

Listimi i Radio Kosovës në platformën ndërkombëtare SHOUTCAST.

RK1 dhe RK2 janë të listuara në platformën ndërkombëtare të shpërndarjes së sinjalit të radiove, **SHOUTCAST.**

Instalimi i një kamere 360° në shtyllën e antenës, që ofron pamje live të qytetit.

Në vitin 2024, është instaluar një **kamerë 360°** në shtyllën e antenës, e cila ofron pamje të qendrës së qytetit në kohë reale. Këto pamje përdoren si grafika në emisionet që transmetohen me video, duke pasuruar përmbajtjen vizuale.

14.7 Digjitalizimi i arkivit

Procesi i digjitalizimit të materialeve audio të Radio Prishtinës, që ka filluar më 24. 05. 2023**, ka përfunduar më** 27. 12. 2024**. Ky projekt ka qenë thelbësor për ruajtjen e trashëgimisë institucionale dhe kombëtare.** Statistikat e digjitalizimit**:** 10723 shirita magnetikë të digjitalizuar**, me gjithsej**3718 orë e 48 minuta përmbajtje**:** Muzikë zbavitëse **– 3144 shirita (742 orë e 3 min),** Muzikë popullore **– 3684 shirita (887 orë e 51 min);** Radiodrama **– 1019 shirita (512 orë e 32 min);** Fjalime politike **– 938 shirita (738 orë e 22 min);** Muzikë serioze **– 1561 shirita (636 orë e 51 min);** Efekte dhe materiale të tjera **– 377 shirita (201 orë e 9 min)** LOGJISTIKA (Autoparku, shtëpiaku, mirëmbajtja dhe pastrimi)

Gjatë vitit 2024 në sektorin e Logjistikës janë zgjidhur disa probleme të rëndësishme si: **1)** Ndërrimi i gypit të ujërave të zeza, **2)** Zhbllokimi dhe pastrimi i kanalit të ujërave atmosferikë, që ka rrezikuar trafot 10 kW, **3)** Largimi i skrapit nga të gjitha hapësirat brenda dhe jashtë objektit.

Kilometrat dhe litrat në njësinë e autoparkut në RTK-Radio

Pasqyra e shpenzimeve për çdo veturë (01. 01. 2024 – 31. 12. 2024)

LISTA E VETURAVE TË RTK-RADIO KOSOVA						
Nr.	**Tabelat**	**Tipi i makinës**	**KM paraprake**	**KM e tanishme**	**KM për 2024**	**Derivate për 2024**
1	01-502-BA	Opel Antara	252323	263278	10955	152.06
2	01-459-NA	Peugeot	76249	100648	24399	882.96
3	01-699-EP	Opel Antara	241902	246564	4662	137.79
				TOTALI	**40016**	**2337.45**
				Mesatarja vjetore	**5.85 litër për 100 Km**	

Shpenzimet mujore të derivateve për 2024


2024	**Shpenzimet**	**Litrazhi**	**Mesatarja në €**
Janar	144.44 €	105.15Lt.	1.37 € për Lt.
Shkurt	412.75 €	284.13Lt.	1.45 € për Lt.
Mars	420.31 €	300.76Lt.	1.39 € për Lt.
Prill	271.77 €	190.05Lt.	1.43 € për Lt.
Maj	378.40 €	281.55Lt.	1.34 € për Lt.
Qershor	204.13 €	153.16Lt.	1.33 € për Lt.
Korrik	292.99 €	211.5Lt.	1.38 € për Lt.
Gusht	205.07 €	156.57Lt.	1.31 € për Lt.
Shtator	144.87 €	114.98Lt.	1.26 € për Lt.
Tetor	283.73 €	225.18Lt.	1.26 € për Lt.
Nëntor	241.88 €	191.44Lt.	1.26 € për Lt.
Dhjetor	157.42 €	122.98Lt.	1.28 € për Lt.
Totali	**3, 157.76 €**	**2337.45 Lt.**	

15. Shërbimi i administratës dhe burimeve njerëzore

15.1 Struktura e të punësuarve – pasqyrë e përgjithshme

Tabela 1 – Të punësuarit në RTK

Sektori/Shërbimi	Numri i të punësuarve më 01. 01. 2024	Numri i të punësuarve më 01. 01. 2025	Ndryshimi
Drejtoria	**97**	**89**	**-08**
- Menaxhmenti i lartë	5	4	-01
- Departamenti për strategji dhe zhvillim	8	7	-01
- Departamenti për marrëdhënie me jashtë dhe komunikim	6	6	0
- Marketingu	14	12	-02
- Prokurimi	11	9	-02
- TI	20	18	-02
- Mediet Online	29	29	0
- Auditori	4	4	0
RTK 1 – TV	**312**	**305**	**-07**
RTK 2 - TV	**74**	**69**	**-05**
RTK 3 - TV	**73**	**68**	**-05**
RTK 4 - TV	**7**	**8**	**+01**
Radio Kosova	**132**	**122**	**-10**
Shërbimet e përbashkëta	**48**	**51**	**+03**
TOTALI	**743**	**712**	**-31**



Bordi i RTK-së

Në fund të dhjetorit 2024, Bordi i RTK-së ka nënkryetarin e Bordit dhe tre (3) anëtarë.
Në bazë të obligimeve ligjore gjatë vitit 2024 dhe sipas kërkesës së Bordit të RTK-së, Shërbimi i Administratës dhe Burimeve Njerëzore në RTK, ka bërë shpallje për thirrje publike për anëtarë të Bordit të RTK-së të cilat pastaj procedohen në Kuvendin e Kosovës.

Pakot për nominim të anëtareve të bordit të shpallura gjatë viti 2024 janë si në vijim:

- Pako për nominim të 1 (një) anëtari të komunitetit shqiptar nga data 01. 03. 2024 -15. 03. 2024;
- Pako për nominim të 3 (tre) anëtarë të komunitetit shqiptar nga data 21. 08. 2024 -04. 09. 2024;
- Pako për nominim të 2 (dy) anëtarë të komunitetit shqiptar nga data 18. 09. 2024 -02. 10. 2024.

Bordi i RTK-së	Numri më 01.01.2024	Numri më 01.01.2025	Ndryshimi
Anëtarët e Bordit	7	4	-3

Tabela 2 – Kronologjia e konkurseve/rekrutimeve të brendshme

#	Vendi i punës	Shpallja e konkursit prej - deri	Shërbimi programor	Nr.i pozitave	Statusi	Data e fillimit të punës
1	Menaxher i Operativës financiare	12.12.2023 - 26.12.2023	RTK	1	I rekrutuar	01.02.2024
2	Redaktor i programit	20.12.2023 - 03.01.2024	RTK 2	1	I rekrutuar	01.02.2024
3	Redaktor i edicionit	20.12.2023 - 03.01.2024	RTK 2	1	I rekrutuar	01.02.2024
4	Udhëheqësi Produksionit në RTK Radio	21.06.2024 - 05.07.2024	Radio	1	I rekrutuar	01.08.2024

5	Redaktor i redaksisë 2 / Redaksia në gjuhën turke / RTK Radio	12.12.2024 - 18.12.2024	Radio	1		
6	Gazetar 2/Redaksia turke/Radio	12.12.2024 - 18.12.2024	Radio	2	I anuluar	

Tabela 4 – Rekrutimet/Konkurset e jashtme (publike)

Rekrutimet	RTK 1, 3 dhe 4	RTK 2 - TV	RTK - Radio
Nëpërmjet konkursit të jashtëm (publik)	**6** -Zyrtar ligjor; -Zyrtar ligjor; -Teknik në Facebook; -Zyrtar Ligjor (për përshtatshmëri ligjore); -Udhëheqës i Prokurimit; -Udhëheqës i Administratës dhe i Burimeve Njerëzore.	**2** -Gazetar komentator i sportit. -Drejtor i RTK 2 – TV (në konkurs të jashtëm ka aplikuar kandidatja e brendshme dhe është përzgjedhur)	**0**

15.2 Bashkëpunëtorët e jashtëm

Me kërkesën e menaxhmentit, Shërbimi i Administratës dhe Burimeve Njerëzore në RTK, ka bërë shpallje për thirrje publike për angazhimin e bashkëpunëtorëve profesionalë të jashtëm, për pozitat në vijim:

- Përkthyes nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga data 19. 01. 2024 - 24. 01. 2024;
- Përkthyes nga gjuha italiane në gjuhen serbe, nga data 19. 01. 2024 - 24. 01. 2024;
- Thirrje publike për gazetar nga rajoni për nevojat e medieve online, nga data 01. 03. 2024 - 15. 03. 2024;
- Thirrje publike për emërimin e shtatë anëtarëve të Grupit punues për përzgjedhjen e drejtorit të kanalit televiziv në gjuhën serbe në RTK.


RTK, në fillim të vitit 2024, ka filluar me 5 bashkëpunëtorë të jashtëm profesionalë.

Tabela 6 – Bashkëpunëtorët e jashtëm

Sektori/Shërbimi	Numri i të angazhuarve më 01. 01. 2024	Numri i të angazhuarve më 01. 01. 2025	Ndryshimi
RTK 1 - TV	5	11	+6
RTK 3 - TV	0	0	0
Radio Kosova	0	0	0
RTK 2 - TV	0	0	0
Grupi këshillues për publikun	5	0	-5
Komiteti i Auditimit	2	2	0
Totali	12	13	+1

Shënim: Në numrin e përgjithshëm të bashkëpunëtorëve profesionalë nuk është përfshirë numri i bashkëpunëtorëve të jashtëm për nevojat e Festivalit të dytë të Këngës në RTK dhe të programit të Vitit të Ri 2024.





NDËRPRERJET E MARRËDHËNIES SË PUNËS

Tabela 7 – Ndërprerjet e marrëdhënies/kontratës së punës

Ndërprerja e marrëdhënies së punës	RTK 1, 3 dhe 4	RTK 2 - TV	RTK - Radio
Nga i/e punësuari	**9** - Gazetar 1; - Menaxher për Projekte dhe Zhvillim; - Inxhinier në TI 1 – TV; - Xhirues 2; - Skenograf; - Zyrtar i pasurisë; - Zëvendësdrejtor i përgjithshëm; - Mjeshtër i montazhës; - Montazher 1.	**6** -Gazetar 2; -Gazetar 2; -Gazetar 2; -Montazher 2; -Vozitës; -Montazher 2.	**3** -Teknik i zërit 2; -Teknik në energjetikë; -Gazetar 2.
Nga punëdhënësi	**4** -Xhirues 1 -Montues i pajisjeve teknike; -Inxhinier në mirëmbajtje; -Xhirues 2.	**0**	**0**
Sipas fuqisë ligjore/Pensionimi	**8** -Mbikëqyrës i arkivit dhe bartjes; -Organizator 1; -Asistent i marketingut – monitorues; -Autoskripta; -Asistent redaktor; -Gazetar 1; -Arkivist; -Mjeshtër i montazhës.	**0**	**2** -Teknik i zërit 1; -Teknik në transmetues.
Për shkak të mospërfundimit me sukses të periudhës provuese	**0**	**0**	**0**
Si masë disiplinore për shkeljen e detyrave të punës/nga Komisioni disiplinor	**5** -Teknik në YouTube; -Gazetar korrespondent; -Menaxher për Teknologji dhe Transmetim; -Kameraman 1; -Dizajner grafik.	**0**	**0**
Sipas fuqisë ligjore/me vdekjen e të punësuarit	**1** -Mbikëqyrës artistik i programeve të veçanta	**0**	**0**

PROJEKTET 2024

Gjatë vitit 2024 janë organizuar këto projekte: Festivali i dytë i Këngës në Radio Televizionin e RTK–së i mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Projekti dhe Viti i ri 2025. Nëpërmjet kontratave për shërbime janë angazhuar bashkëpunëtorë të jashtëm si: Këngëtarë, instrumentistë, violinistë, trombonistë, saksofonistë, ritëm seksioni, dirigjentë, orkestrues, grupi vokal, kori i fëmijëve, vokalistë, aktorë etj.

Aktivitetet	Lënda	Statusi
Projektet	Festivali i Këngës – 93 të angazhuar Viti i Ri 2025 – 17 të angazhuar (4 të angazhuar në RTK Radio, 4 të angazhuar në RTK 2 – TV dhe 9 të angazhuar në RTK – TV)	I përfunduar

Shërbimi i Administratës dhe Burimeve Njerëzore ka planifikuar, organizuar dhe ka mbikëqyrë proceset e punës në domenin e vet, duke respektuar politikat dhe rregulloret e brendshme.
Duke menaxhuar sistemet e brendshme të menaxhimit të burimeve njerëzore, ABNJ:

- ka mbikëqyrë përgatitjen e të gjitha llojeve të kontratave dhe vendimeve që kanë të bëjnë me Administratën dhe Burimet Njerëzore;
- ka mbikëqyrë çështjet disiplinore në bazë të rregulloreve të RTK-së;
- ka bashkëpunuar ngushtë me Qendrën për aftësim profesional në përgatitje të planeve për arsimim, aftësim profesional dhe trajnim të stafit;
- ka përpiluar raporte operative për nevojat e Menaxhmentit të lartë të RTK-së;
- për të gjitha komisionet/grupet punuese janë mbajtur procesverbale, janë hartuar vendime dhe janë përpiluar kontrata (sistemime), ndërprerje të marrëdhënies së punës, pushim pa pagesë, vendime për shpërblime/ kompensime, ndihma solidare, për korrigjim të pagës; përgatitja e kartelave të punës, protokollimi i dokumenteve dhe faturave etj.
- janë vendosur të dhënat për të punësuarit e rinj në sistemin elektronik të menaxhimit të të dhënave të Burimeve Njerëzore si dhe të dhënat e bashkëpunëtorëve tjerë të angazhuar, për realizimin e projekteve në periudha të ndryshme;
- Në baza mujore është bërë mbledhja e konfirmimeve të pagave për muajin respektiv, duke përfshirë orët e realizuara të natës dhe jashtë orarit, angazhimin shtesë të të punësuarve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm;
- ka përpiluar raporte, lista dhe analiza të natyrës së Administratës dhe Burimeve njerëzore;
- ka vazhduar të aplikojë regjistrimin e pranisë në punë në mënyrë elektronike, në baza javore dhe mujore ka përpiluar raporte të pranisë në punë për të gjithë të punësuarit në të gjithë sektorët e RTK-së. Raportet janë dërguar tek Udhëheqësit e sektorëve dhe tek të punësuarit;
- ka vazhduar me punët rutinore si: përgatitja, shpërndarja dhe regjistrimi i formave të pushimeve vjetore dhe mjekësore, përditësimi i listave të punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm, puna me palë rreth kërkesave për sqarime, shpjegime dhe sugjerime sa i përket të punësuarve, përditësimi i dosjeve personale të punëtorëve;
- ka marrë pjesë në të gjitha seancat e Komisionit disiplinor duke grumbulluar dëshmi të dokumentuara, duke përgatitur oraret e seancave, njoftimin e personave që kërkohet të janë

prezent lidhur me detajet e takimit, datën dhe kohën e seancës, mbajtjen e procesverbalit për seancën disiplinore dhe vendosjen e tij në lëndën konfidenciale disiplinore. Janë iniciuar gjithsej 20 raste disiplinore, në Komision disiplinor në nivel të RTK së, me ç'rast janë marrë masa konform dispozitave ligjore dhe Rregullores për përgjegjësi materiale dhe disiplinore të RTK-së.

Tabela 8 – Rastet disiplinore

Aktivitetet	Lënda	Statusi
Masat e rënda disiplinore	5 masa disiplinore - Shkëputje të kontratës 8 masa disiplinore - Suspendim i përkohshëm nga puna me 50% të pagës 2 raste - Ulje në pozitë	Të përfunduara
Masat e lehta disiplinore	6 masa disiplinore - Vërejtje me shkrim 4 masa disiplinore - Vërejtje me gojë 5 raste nuk kanë qenë për komision disiplinor	

15.3 Qendra e aftësimit profesional

Qendra e Aftësimit Profesional e RTK-së në vitin 2024, ka realizuar një sërë detyrash dhe angazhimesh të planifikuara sipas planit vjetor të edukimit dhe trajnimeve. Gjatë vitit 2024 janë mbajtur gjithesej 65 trajnime.

15.4 Siguria në punë

Aktivitetet kryesore të punës gjatë vitit 2024

Në fushën e shëndetit dhe të sigurisë në punë janë bërë aktivitetet në vijim:

- Mbi 100 inspektime brenda vitit në hapësirat e RTK-së; Dy herë servisimi i aparateve për fikjen e zjarrit dhe hidrantëve;
- Disa takime me udhëheqësen e Qendrës së Aftësimit Profesional për organizimin e trajnimeve për personelin tonë;
- Korrespondencë me zyrtarët e 'Akademinë për Siguri Publike' në Vushtrri (për trajnime);
- Biseda formale me të punësuarit në RTK lidhur me rëndësinë për sigurinë në punë;
- Identifikimi i vendeve 'të rrezikshme' nga rrezatimi, fusha elektromagnetike etj, në RTK;
- Kërkesat e nevojshme zyrtare (drejtuar) për zyrën e prokurimit dhe administratë;
- Shqyrtimi i Planit Emergjent për RTK;
- Vizitë dhe mbikëqyrje (çështjeve të sigurisë) në Festivali i RTK;
- Raportimi (njoftimet) me shkrim për çështjet me rëndësi nga fusha e sigurisë;
  Hulumtim dhe planifikimi i buxhetit për fushën e sigurisë për vitin 2025

16. Mediet online

Viti 2024 është karakterizuar me shtim të volumit të video ndarjeve nga emisionet që prodhohen në RTK. Stafi është trajnuar për përdorim bazë të programit Adobe Premier, në ndarje dhe përshtatje të formateve për rrjete sociale.

Gjatë vitit janë mbuluar me sukses ngjarjet kryesore politike, kulturore e sportive, me theks të veçantë Festivalin e Këngës në RTK. Më poshtë, të ndara në kategori, janë pasqyruar shifrat dhe top materialet nga secila platformë online e RTK-së.

FACEBOOK

Gjatë vitit 2024 mesatarja e postimeve për një muaj në Facebook është rreth 800 poste, afërsisht 200 poste më shumë në muaj sesa vitin paraprak. Gjatë kësaj periudhe 1 vjeçare, **(Reach)** apo shfaqja e përmbajtjes tek përdoruesit është 28. 3 milionë, që është shumëfish më e lartë sesa vitin paraprak, që ishte 7. 5 milionë.

- Postime totale: **9767** (foto, video, story dhe live)
- Shfaqje totale (reach): **28. 3** milionë
- Shikime totale (views): **114. 3** milionë
- Vizita të profilit (profile visits): **2. 9** milionë
- Ndjekës të rinj (new followers): **25. 3** mijë

Video materialet që janë postuar në Facebook, gjithsej janë shikuar **42, 902, 564 minuta.**

INSTAGRAM

Gjatë vitit 2024 mesatarja e postimeve për një muaj në Instagram është rreth 660 poste. Për këtë periudhë, këto poste kanë arritur 6. 53 milionë **(Reach),** apo shfaqje të përmbajtjes te përdoruesit, që është shumëfish më e lartë sesa vitin paraprak, që ishte 1 milion.

YOUTUBE

Gjatë vitit 2024, në kanalin zyrtar të RTK-së në youtube janë postuar gjithsej **14, 099** video. **Impressions** (Shfaqje e Thumbnails si sugjerim te shikuesit) është 855. 5 milionë. Viti është përmbyllur me asnjë strike në këtë kanal, që dëshmon renditjen e mirë të kanalit në algoritmin e kësaj platforme.

TIKTOK

Gjatë vitit 2024, ka rritje prej 99% në reach, krahasuar me vitin paraprak. Gjatë këtij viti janë postuar rreth 500 video (në muajin shtator dhe tetor platforma nuk ka lejuar gjenerimin e të dhënave).

RTK Live

Publikimet e ndara në kategori: JANAR - DHJETOR 2024
Totali i lajmeve të publikuara: **25, 288**

Brenda një viti, në faqen e RTKlive janë regjistruar mbi 1. 7 milion përdorues. Faqja RTKlive ka shënuar 10 milionë shikime (page_views) brenda një viti. Mesatarja e qëndrimit në faqe (page_engagement) është 2 min e 55 sekonda. Më së shumti lexues ka nga Kosova, pastaj Gjermania, Zvicra, Shqipëria, Serbia, SHBA, Maqedonia e Veriut, etj.

RTK 2 - Facebook

Gjatë vitit 2024, reach në faqen RTK2 në Facebook ka arritur në 1. 2 milion, ngjashëm me vitin paraprak.

RTK 2 - Youtube

Në kanalin e RTK2 në YouTube gjatë vitit 2024 janë postuar 1092 video.

- Gjatë periudhës kohore 01. 01. 2024 -31. 12. 2024, në total janë regjistruar **419. 9 mijë** shikime në YouTube.
- Gjithsej, janë regjistruar **27. 4 mijë** orë të shikuara në YouTube.
- Në YouTube, në vitin 2024, kemi pasur **1. 100** abonentë të rinj

Radio Kosova - Youtube

Në kanalin e Radio Kosovës në YouTube gjatë vitit 2024 janë postuar 1, 000 video.

- Gjatë periudhës kohore 01. 01. 2024 -31. 12. 2024, në total janë regjistruar **95. 6 mijë** shikime në YouTube.
- Gjithsej, janë regjistruar **5. 3 mijë** orë të shikuara në YouTube.
- Në YouTube, në vitin 2024, kemi pasur **580** abonentë të rinj

Radio Kosova - Facebook

Në vitin 2024, në faqen e Radio Kosovës në FB janë postuar 3, 960 materiale. Reach është rritur shumëfish gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin paraprak, duke arritur në 6. 9 milionë.

- **Postime totale:** 3, 960 (foto, video, story dhe live)

- **Shfaqje totale (reach):** 6. 960 milionë
- **Shikime totale (views):** 3 milionë
- **Ndjekës të rinj (New Followers):** 13, 444
- **Vizita në profil:** 253, 000

RTK – Roma Facebook

Reach: 10. 5 mijë **Views:** 11. 5 mijë
RTK – Türkçe Facebook

Për komunitetin turk në FB, për vitin 2024**Reach:** 85. 7 mijë **Views:** 765. 4 mijë

RTK na Bosanskom – Facebook-Për komunitetin boshnjak në FB, për vitin 2024**Reach:** 14. 9 mijë **Views:** 5. 3 mijë

Festivali i Këngës në RTK – **Instagram**
Shikime totale (Total Views): 661, 300

17. Departamenti i prokurimit

Departamenti i Prokurimit: janë kryer këto prokurime	
Aktivitetet e prokurimit të publikuara mbi vlerën 1000 euro	86
Aktivitetet e prokurimit të publikuara sipas vlerës minimale nën-1000 euro	36
Kontratat e Nënshkruara	84
Kontratat e Nënshkruara të vlerës minimale nën-1000 euro	36
Aktivitetet e prokurimit të Ritenderuara	2
Aktivitetet e prokurimit që janë në vlerësim	1
Aktivitetet e prokurimit të anuluara mbi vlerën -1000 euro dhe vlerës minimale nën-1000 euro	2
Kërkesa të vlerës minimale nën-100 euro	138

Gjatë vitit 2024 janë regjistruar gjithsej 311 kërkesa për shërbime të ndryshme për RTK, të cilat janë regjistruar si kërkesa në tabelën e regjistrimeve.

Ndërsa të nënshkruara gjithsej janë 84 kontrata: nga të cilat mbi 1, 000 Euro janë 48 kontrata të nënshkruara që janë vlera të mesme dhe të larta, ndërsa nën 1, 000 Euro janë 36 kontrata të nënshkruara që janë vlera minimale.

Ndërsa nën 100 Euro janë 138 kërkesa, Televizioni 82 kërkesa, Radio 40 kërkesa, RTK-2 14 kërkesa dhe Marketingu 2 kërkesa të realizuara.

Tabelat:

Departamenti i Prokurimit: janë kryer këto Prokurime	
Aktivitetet e prokurimit të publikuara mbi vlerën 1000 euro	48
Aktivitetet e prokurimit të publikuara sipas vlerës minimale nën-1000 euro	36
Kontratat e Nënshkruara	84
Kontratat e Nënshkruara të vlerës minimale nën-1000 euro	36
Aktivitetet e prokurimit të Ritenderuara	2
Kërkesa të vlerës minimale nën-100 euro	138

Kërkesa në tabelen e regjistrimeve	Numri i kontratave	Vlera
Kontrata me vlerë të mesme dhe të lartë	48	1,712,960.10 €
Minimale nën 1000 €	36	22,159.97 €

Kërkesat e realizuara nën 100 euro :

Departmenti	Kërkesat e realizuara	Vlera e kërkesave
Televizioni	82	4,285.02 €
Radio	40	2,445.24 €
RTK -2	14	594.79 €
Marketingu	2	161.50 €
Totali	138	7,486.55 €

18. Zyra ligjore

Çështjet gjyqësore:

Gjatë vitit 2024, Zyra Ligjore ka pranuar gjithsej gjashtëdhjetë e shtatë (67) Aktvendime/Aktgjykime; Nga Gjykata Themelore në Prishtinë kemi pranuar tetëmbëdhjetë (18) aktvendime/aktgjykime, nga Gjykata e Apelit katër (4), nga Gjykata Supreme katër (4), ndërsa nga Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë gjithsej njëzet e një (21) dhe nga Shkalla e Dytë e Gjykatës Komerciale kemi pranuar njëzet (20) aktvendime/aktgjykime.

Në favor të RTK-së janë gjashtëmbëdhjetë (16) aktvendime/aktgjykime; Katër (4) nga Gjykata Themelore në Prishtinë, një (1) nga Gjykata e Apelit, një (1) nga Gjykata Supreme, katër (4) nga Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë dhe gjashtë (6) nga Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë.
Përgjatë këtij viti, janë iniciuar gjithsej tetë (8) Padi në Gjykatën themelore në Prishtinë, ndërkaq kemi pranuar njëzet e gjashtë (26) Padi të paraqitura kundër RTK-së.
Gjithashtu, janë përpiluar dhe proceduar në Gjykatën Supreme të Kosovës një (1) Kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit, nëntë (9) Ankesa në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimeve të Gjykatës Themelore në Prishtinë, njëmbëdhjetë (11) Ankesa në Gjykatën Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, dhe një (1) Ankesë në Prokurorinë e Apelit.

Zyra ligjore gjatë vitit 2024 ka përfaqësuar Radiotelevizionin e Kosovës në tridhjetë e pesë (35) seanca gjyqësore të natyrave të ndryshme, që përfshijnë mosmarrëveshje komerciale, çështje të punësimit dhe zbatimin e procedurave administrative.Seancat janë zhvilluar në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe në Gjykatën Komerciale të Kosovës.

19. Shërbimi i Financave

Gjatë vitit 2024, në bashkëpunim me departamentet e tjera, Departamenti i Financave ka arritur të mbajë likuiditetin e institucionit sipas planifikimeve, duke e ruajtur qëndrueshmërinë financiare pavarësisht sfidave të hasura gjatë vitit.

2. Performanca financiare e RTK-së për vitin 2024

- **Të hyrat:** 10,861,000.00 euro
  - 83% e të hyrave janë siguruar nga Qeveria e Kosovës
  - 17% e të hyrave janë nga burimet vetanake
- **Shpenzimet:** 10,794,000.00 euro
  - 72% e shpenzimeve janë dedikuar për paga
  - 28% për shpenzime operative

Viti 2024 është mbyllur me bilanc pozitiv financiar në vlerë prej 67,000 eurosh.

3. Investimet kapitale

Në bashkëpunim me njësitë kërkuese dhe Zyrën e Prokurimit, gjatë vitit 2024 janë realizuar të gjitha investimet kapitale të planifikuara, në vlerë prej 640,000 eurosh. Këto përbëjnë nivelin më të lartë të investimeve në historinë e RTK-së nga buxheti vetanak. Ndër investimet kryesore përfshihen edhe ato strategjike kombëtare, si pajisjet për shpërndarjen e sinjalit radio në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

4. Rivlerësimi i aseteve

Gjatë vitit 2024 është kryer rivlerësimi i të gjitha aseteve të RTK-së, duke adresuar dhe përmbushur tërësisht gjetjen e vetme të evidentuar në Raportin e Auditimit për vitin 2023, e cila kishte ndikuar në opinionin e dhënë për atë raport.

20. Departamenti i Teknologjisë Informative (RTK-IT)

Zgjerimi i kapacitetit të arkivit digjital me mbi 1 Petabyte përmes instalimit të dy serverëve të rinj që do të jenë kopje identike e njeri-tjetrit (mirror).


RTK mesatarisht prodhon 10 Terabyte përmbajtje programore çdo muaj, dhe ka qenë esenciale që të bëhet zgjerimi i kapacitetit të arkivit digjital në mënyrë që të gjitha sistemet dhe prodhimi të mos ngecin. Përveç kësaj, zgjerimi i arkivit digjital do të ndihmojë në përmirësimin e efikasitetit të punës, pasi gjithçka mund të ruhet dhe menaxhohet në mënyrë digjitale.



Përveç rritjes së kapacitetit të ruajtjes së përmbajtjes programore përmes këtyre serverëve bëhet dhe optimizimi i performancës të arkivës digjitale dhe sistemit të prodhimit FBPS.

- ☑ **Migrimi i serverëve kryesor (Hi-Res) në server më të avancuar**

Zëvendësimi i serverëve te vjetër të blerë në vitin 2013 ka qenë i domosdoshëm pasi që ata server kanë përfunduar ciklin e tyre të punës sipas instruksioneve të prodhuesit. Këta server bartin barren kryesore në sistemin e prodhimit FBPS duke përpunuar dhe të ruajtur mesatarisht 10 Tb/Muaj dhe duke ofruar shërbime për më shumë se 500 përdorues 24/7.



Përveç rritjes së sigurisë në aspektin e ruajtjes së integritetit të të gjitha përmbajtjeve programore te RTK-se, këta server ofrojnë performancë dukshëm me të mirë sesa paraardhësit e tyre.


Modifikimi i formatit të stream të RTK2 për distribuim të përshtatshëm për operatorët kabllor në veri të Kosovës

Pas njoftimit nga ana e stafit të RTK 2 se operatorët kabllor në pjesën veriore të Kosovës nuk kanë resurse teknike për ta dekoduar sinjalin e RTK 2 (audio) departamenti i TI-së pas identifikimit të problemit ka krijuar një stream të veçantë të dedikuar për distribuimin e sinjalit të RTK 2 në veri të Kosovës duke u përshtatur me kapacitetet e teknike të operatorit kabllorë.



Krijimi i mundësisë për transmetime live në media online për RTK2

Krijimi i lidhjes se re mundëson transmetimin e sinjalit të RTK 2 pa vonesa dhe pa humbje në cilësi tek mediet online në mënyrë që të mundësohet transmetimi i ngjarjeve live të programit RTK 2 në platformat online.



Krijimi i web modulit për aplikim në Festivalin e Këngës

Krijimi i modulit për aplikim online në Festivalin e Këngës së RTK-së që ka mundësuar aplikimin për pjesëmarrje në Festival përmes plotësimit të formës me informatat e kërkuara si dhe ngarkimin e audiomaterialit të pakompresuar. Përveç këtij moduli është krijuar dhe landing page për Festivalin e këngës në RTKLive.

Instalimi dhe Konfigurimi i Touch Screen TV në Studion 2

Në studion 2 në RTK-TV është vendosur një 85” TV me mundësi operimi përmes prekjes (touch screen) i cili mund të shfrytëzohet për sistemet e analizave sportive (telestrator) si dhe çfarëdo sistemi tjetër i cili është i bazuar në ueb.



Instalimi, konfigurimi dhe shpërndarja e 80 njësive kompjuterike në RTK-TV

Instalimi dhe konfigurimi i 80 njësive të reja kompjuterike që zëvendësojnë pajisje të stërvjetëruara të cilat ishin rrezik permanent për të gjithë sistemin në përgjithësi në aspektin e sigurisë kibernetike si pasojë e resurseve të limituara të tyre për përdorim të sistemeve moderne operative.

Të gjitha 80 njësite e reja janë vendosur në objektin e RTK-TV, për të zgjidhur përfundimisht problemin e njësive kompjuterike të stërvjetëruara nevojiten dhe 100 njësi të reja në total që do të vendoseshin në RTK-TV, RTK 2 dhe Radio Kosova.



Instalimi dhe konfigurimi i 10 njësive të reja për montazhe jolineare.

Instalimi dhe konfigurimi i 10 njësive të reja të montazhit të vendosura në RTK-TV, RTK 2, Medie Online si dhe Radio Kosova.

Procesi i Digjitalizimit të arkivave të RTP-së dhe RTK-së

Procesi i digjitalizimit të arkivave të RTP-së dhe RTK-së shënon një hap të rëndësishëm në ruajtjen dhe qasjen e materialeve historike audiovizuale. Me kalimin e viteve, fondi arkivor i televizioneve publike është ruajtur në formate fizike, të cilat janë të ndjeshme ndaj degradimit dhe vështirësive në përdorim.Ky projekt ka për qëllim të transformojë këto materiale në formate digjitale, duke siguruar një ruajtje më të sigurt dhe një qasje më të lehtë për gazetarët dhe autorët e emisioneve.

Krijimi i kopjes fizike të arkivës së RTK-së në lokacion të dytë

Krijimi i një kopjeje fizike të arkivit të RTK-së në një lokacion të dytë është një masë strategjike për të siguruar ruajtjen dhe mbrojtjen afatgjatë të materialeve arkivore.Arkivi përmban një pasuri të madhe të materialeve audiovizuale historike, të cilat përbëjnë një trashëgimi të rëndësishme kulturore dhe mediatike.Duke krijuar një kopje rezervë në një lokacion të sigurt, DTI synon të minimizojë rreziqet e humbjes së të dhënave për shkak të faktorëve të jashtëm si fatkeqësitë natyrore, dëmtimet teknike apo ndonjë incident.

DTI gjatë tërë vitit 2024 ka bërë bartjen e përmbajtjes arkivore në serverët e vendosur në objektin e Radio Kosovës.

Digjitalizimi dhe ruajtja e dokumentacionit të RTK-së

Digjitalizimi dhe ruajtja e dokumentacionit të RTK-së është një hap i rëndësishëm në modernizimin dhe menaxhimin e të dhënave institucionale. Dokumentet e arkivuara në format fizik janë shpesh të ekspozuara ndaj degradimit, dëmtimit apo humbjes, prandaj kalimi në format digjital siguron një ruajtje më të sigurt dhe qasje më të lehtë. Ky proces synon të rrisë efikasitetin operacional të RTK-së duke mundësuar kërkimin, shpërndarjen dhe administrimin e dokumenteve në mënyrë më të organizuar dhe të shpejtë.

Mirëmbajtja dhe Zhvillimi i Sistemeve Ekzistuese

- Sistemi i produksionit FBPS për krijimin, transmetimin dhe arkivimin e përmbajtjes programore.
- Sistemi i Transmetimit të bazuar në IP (Master Control Room).
- Sistemet ABNj dhe Financa.
- Sistemi për monitorimin e hyrje/daljeve.

- Implementimi i politikave të sigurisë.
- Rekordimi i të gjitha kanaleve RTK 1, 2, 3, 4, Sat, RK 1 dhe RK 2, 24/7.
- Menaxhimi i rrjeteve kompjuterike prodhuese dhe jo prodhuese.
- Administrimi me ueb faqen e RTK-së për të siguruar funksionalitet **24/7**.

21. Departamenti për strategji dhe zhvillim (DSZH)

Departamenti për Strategji dhe Zhvillim në Radiotelevizionin e Kosovës (RTK) ka rol kyç në përpilimin e projekteve si dhe rekomandimin e proceseve zhvillimore, strategjike dhe programore në RTK. Gjatë vitit 2024 DSZH ka pasur një dinamikë të re të angazhimit, posaçërisht në pjesën e dytë të vitit.

Në vazhdimësinë e obligimeve në baza ditore si përmbledhje e të arriturave të këtij departamenti veçohen si në vijim:

STRATEGJIA ZHVILLIMORE E RTK-së 2025-2028
Bazuar në strategjinë e punës të Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe nën drejtimin e udhëheqëses së DSZH-së, gjatë muajit nëntor 2024 është përfunduar dhe i është dorëzuar UD Drejtorit të Përgjithshëm drafti "Strategjia Zhvillimore e RTK-së 2025-2028".
Ky dokument i rëndësishëm parasheh segmentet kryesore të transformimit të RTK-së, në një medie moderne dhe të pavarur të transmetimit gjithnjë duke pasur parasysh sfidat dhe nevojat e kohës adekuate. Duke pasur parasysh rëndësinë dhe rolin që ka ky dokument për shkak të funksionimit të mirëfilltë të RTK-së në hap me transmetuesit tjerë në Europë, ende nuk është miratuar nga Bordi. Strategjia është dokument i ndryshueshëm dhe ka për qëllim paralajmërimin e vazhdueshëm për obligimet, misionin bazë dhe vizionin gjithnjë duke u modernizuar, plotësuar dhe mbajtur hapin me ndryshimet në shoqëri dhe mjedis.
DSZH veçanërisht gjatë 4-mujorit të fundit të vitit 2024, ka nxjerrë raporte me opinionet ligjore përkitazi me nevojën për ndryshime në rregullativën ligjore të RTK-së. Në mbledhjet e rregullta javore të DSZH-së, janë dorëzuar disa rekomandime dhe opinione ligjore, për amendamentim ose ndryshim të disa prej rregulloreve ekzistuese, të cilat është vlerësuar se bien ndesh me ligjet ekzistuese dhe rregullativën e përgjithshme ligjore të RTK-së.
Këto rekomandime dhe raporte i janë dorëzuar Menaxhmentit për shqyrtim.Gjatë vitit 2024 është themeluar grupi punues për hartimin e rregullores së brendshme për rekrutim të punonjësve në RTK dhe përfaqësuesi i DSZH-së e ka kryesuar këtë grup.Puna në rregullore ka qenë intensive, janë punuar disa versione dhe drafte të cilat janë paraqitur në Menaxhment për shqyrtim, deri në dorëzimin e draftit përfundimtar.

SKEMA PROGRAMORE

Departamenti për Strategji dhe Zhvillim, gjatë vitit ka zhvilluar monitorimin dhe analizën e programeve dhe përputhshmërinë e tyre me misionin e transmetuesit publik.Janë rekomanduar ndryshime në skemë programore për t'u përshtatur me kërkesat e audiencës, përfshirë heqjen e disa emisioneve, rishikimin përmbajtësor të disa emisioneve tjera si dhe krijimin e disa emisioneve që i mungojnë skemës programore, si në RTK-TV, po ashtu edhe në RTK-Radio.Gjithashtu, me qellim të zhvillimit të strategjisë së ndërtimit të skemave programore të qëndrueshme për kanalet e Televizionit dhe ato të Radios janë propozuar skema programore
sezonale, duke pasur parasysh se ky koncept, do t'i mundësonte transmetuesit publik të Kosovës të përmbushte kërkesat e audiencës për program informativ, edukativ e argëtues, me ç'rast do të evitohej paqëndrueshmëria e skemave aktuale programore në RTK-TV dhe RTK-Radio si dhe do të mbyllte hapësirën për eksperimentimin me projekte programore të pa studiuara mirë nga stafi i brendshëm, dhe në mënyrë të posaçme për shfrytëzimin e asaj hapësire për përfshirjen e projekteve të dobëta nga producentë të jashtëm.

HARTIMI i PROJEKTEVE

Gjatë shtatorit 2024 DSZH ka hartuar edhe projektet në vijim: "Rritja e angazhimit dhe përfshirjes së audiencës përmes podcasteve", "ASST për qasje të barabartë në informacion për personat me nevoja të veçanta", "Mundësi të barabarta pune për gazetarët e verbër në media". Po ashtu gjate shtatorit është përgatitur edhe 1 projekt-propozim për krijimin e një emisioni televiziv për fëmijë të moshës 0-6 vjeç. Në bashkëpunim me kolegët nga RTK, është hartuar propozimi për krijimin e Departamentit të Fact-Checking dhe Gazetarisë Hulumtuese në RTK. Gjatë vitit 2024, me dokumentarin e RTK-së "Burnt to Fluorish" ka aplikuar në gjashtë (6) festivale ndërkombëtare si në vijim: URTI, Grand Prix Italia, Japan Prize, Montreal Independent Film Festival, Close UP Edinburgh Docufest, dhe Filmmakers for Change.
Gjatë kësaj periudhe kohore menaxheri për Projekte dhe Zhvillim e ka shkruar dhe përgatitur për aplikim projektin "Mundësi të Barabarta për Gazetarët e Verbër në Media" duke e dorëzuar bashkërisht me udhëheqësen e DSZH-së, në thirrjen për grante nga KUSA, me fokus në përmirësimin e kushteve të punës për gazetarët e verbër në RTK Radio.

Po ashtu janë hartuar edhe projektet në vijim:
"ASST për qasje të barabartë në informacion për personat me nevoja të veçanta" dhe
"Rritja e angazhimit dhe përfshirjes së audiencës përmes podcasteve". Projekti për podcaste është hartuar në bashkëpunim me drejtorin e Radio Kosovës, me synim krijimin e tre podcasteve të reja dhe rinovimin e hapësirave në Radio Kosovë. DSZH ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me organizata vendore dhe ndërkombëtare për të zhvilluar projekte me Radiotelevizionin e Kosovës.

ARRITJET KRYESORE TË DSZH-së GJATË VITIT 2024

- Përfundimi dhe dorëzimi në Menaxhment i Draft Strategjisë Zhvillimore 2025-

2028

- Udhëheqja në hartimin e projektit për krijimin e Departamentit të Fact-Checking dhe Gazetarisë Hulumtuese në RTK.

Janë hartuar konceptet dhe projektet:

- Rritja e Angazhimit dhe Përfshirjes së Audiencës përmes Podcasteve
- ASST për Qasje të Barabartë në Informacion për Personat me Nevoja të Veçanta
- Mundësi të Barabarta për Gazetarët e Verbër në Media

Aplikimet në Festivale Ndërkombëtare

Me dokumentarin "Burnt to Flourish" është aplikuar në gjashtë festival kryesore:

- URTI
- Grand Prix Italia
- Japan Prize
- Montreal Independent Film Festival
- Close UP Edinburgh Docufest
- Filmmakers for Change

DSZH ka organizuar takime me kompaninë QuantiX për të eksploruar mundësitë e përdorimit të softuerit të transkriptimit Shqip.ai në programet e RTK-së. Për shkak të zhvillimeve lidhur me kompletimin e Menaxhmentit, çështja e shumicës së këtyre projekteve ka mbetur të miratohet gjatë vitit 2025.

Gjatë muajit dhjetor 2024 janë zhvilluar takime me ekspert të fushës teknologjike, lidhur me projektin e digjitalizimit të Gjuhës së Shenjave me IA me të ashtuquajturën MAGIC GLOVE, projekt ky i cili mbetet të shqyrtohet dhe finalizohet përgjatë vitit 2025.

Gjatë vitit 2024, DSZH ka prezantuar gjithashtu projektin e përfunduar për themelimin e Zyrës Rajonale në Gjilan, projekt ky që ende nuk është miratuar nga Bordi. Zyra Rajonale në Gjilan synon të lehtësojë realizimin e programit të përgjithshëm të RTK-së dhe të jetë adresë më e afërt e raportimit të problemeve të qytetarëve të komunës së Gjilanit.

Synimi i kësaj zyre është që të jetë multietnike, pasi në këtë komunë jetojnë komunitete të ndryshme: Shqiptarë, serbë, boshnjakë, turq, romë, ashkalinj, egjiptianë, dhe goranë.RTK e mbulon rajonin e Anamoravës me ekipet nga qendra, pasi aktualisht nuk ka as korrespondent nga ky rajon. Për shkak të largësisë dhe infrastrukturës së dobët rrugore, mbulimi i aktiviteteve por edhe hulumtimi dhe trajtimi i temave nga kjo pjesë bëhet edhe më i vështirë, si në aspektin kohor ashtu edhe në aspektin logjistik. Nisur nga këto rrethana¸ për të qenë sa më afër qytetarit propozohet operimi në një lokacion në qytetin e Gjilanit, ku do të realizohen kronika dhe storie nga të gjitha komunitetet, për nevojat e lajmeve dhe të emisioneve të tjera javore, të ketë paraqitje të drejtpërdrejta, të ketë lidhje të drejtpërdrejta nga studioja për nevojat e edicioneve të lajmeve ditore dhe emisioneve të ndryshme. Me krijimin e këtyre kushteve, Gjilani, Vitia, Kamenica, Novobërda, Ranillugu, Parteshi, dhe Kllokoti do të pasqyrohen denjësisht në mediumin publik, ndërsa adresë e problemeve të qytetarëve të kësaj ane do të ishte qyteti i Gjilanit.

RTK në Asamblenë e Përgjithshme të EBU-së



Asambleja e Përgjithshme e Unionit Evropian të Transmetuesve (EBU), e mbajtur më 4–5 dhjetor 2024 në Lozanë, mblodhi përfaqësues të transmetuesve publikë nga e gjithë Evropa, duke përfshirë edhe UD Drejtorin e Përgjithshëm të RTK-së, Drejtorin Programor të RTK-së si dhe Udhëheqësen e Departamentit për Strategji dhe Zhvillim të RTK-së.

Në këtë ngjarje të rëndësishme, u diskutuan sfidat kryesore, zhvillimet dhe strategjitë që po formësojnë të ardhmen e medieve të shërbimit publik (PSM).Si anëtar, RTK mori pjesë aktivisht në sesionet dhe diskutimet, duke kontribuuar në vizionin e përbashkët për të forcuar RTK-në në një peizazh mediatik që ndryshon me shpejtësi. Temat kryesore dhe diskutimet që u zhvilluan në Asamblenë e EBU-së ishin kryesisht të koncentruara në Inovacionin në Mediet e Shërbimit Publik, duke adoptuar teknologji të reja, si Inteligjenca Artificiale (AI), për krijimin, shpërndarjen dhe qasshmërinë e përmbajtjes.



Po ashtu u shtjellua rëndësia e integrimit të sistemeve automatike për shndërrimin e të folurës në tekst (AST) për qasshmëri dhe gjithëpërfshirje gjuhësore, gjithnjë në shërbim të qasjes dhe angazhimit më të lehtë të audiencës, sidomos angazhimi i audiencave të reja, duke përfshirë platformat si TikTok, Instagram dhe YouTube për shpërndarjen e lajmeve dhe argëtimit të përshtatur për brezin Z dhe brezin e mijëvjeçarit.Pjesë e veçantë e Asamblesë ishte diskutimi i ruajtjes së pavarësisë dhe financimit të transmetuesve publik.Në Asamblenë e EBU-së u trajtua edhe pavarësia dhe financimi i medies, përmes praktikave më të mira për diversifikimin e burimeve të të ardhurave duke ruajtur pavarësinë editoriale.Në këtë kontekst, EBU riafirmoi angazhimin për të mbështetur anëtarët që përballen me presione politike ose financiare.

Gjatë takimeve me përfaqësues të transmetuesve publik të Evropës, udhëheqësja e DSZH-së theksoi forcimin e partneriteteve midis anëtarëve të EBU-së si një prioritet, duke propozuar investim në strategji të përmbajtjes të përshtatur për platformat digjitale, për të tërhequr shikues më të rinj.Ajo po ashtu kërkoi angazhim në projekte të përbashkëta, sesione trajnimi dhe nisma për shkëmbim njohurish për të përfituar nga ekspertiza dhe përvojat e partnerëve nga transmetuesit publik në Evropë.

22. Departamenti për marrëdhënie ndërkombëtare dhe komunikim me publikun

DMNK është angazhuar në përmirësimin e marrëdhënieve të RTK-së me Unionin Evropian të Transmetuesve Publik (EBU) duke punuar në sigurimin e pjesëmarrjes së RTK-së në Eurovizion 2025.Janë zhvilluar takime në Asamblenë e Përgjithshme të EBU-së në Limasol të Qipros, si dhe takime virtuale me drejtues të EBU-së dhe të Komitetit Ekzekutiv.
Në maj 2024, RTK ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me akademinë e Deutsche Welle dhe institutin gjerman Goethe, në kuadër të projektit Innovation.Media.Minds" të financuar nga BE, DMNK e ka mbikëqyrur zbatimin e marrëveshjes me ambasadën e Italisë në Kosovë për transmetimin e serive dhe filmave, duke siguruar përkthimin adekuat dhe koordinimin me RTK1 dhe RTK2 për transmetim.Pas hapjes së zyrave rajonale të RTK-së në Prizren dhe Mitrovicë, DMNK ka vazhduar bashkëpunimin me Agjencinë Japoneze për Zhvillim Ndërkombëtar (JICA) për hapjen e zyrës rajonale të RTK-së në Pejë, ku projekti është në fazën e zhvillimit.
DMNK ka aplikuar tek Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) për ndërtimin e një studioje LED për programet e komuniteteve në RTK.
Gjatë muajit maj 2024 DMNK ka organizuar debatin me publikun për Raportin e Punës së RTK për vitin 2023.Debati u zhvillua në Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjilan dhe në qendrën mediale në Çagllavicë, ku ka pasur biseda me qytetarët për vërejtjet dhe kërkesat e tyre për programin e RTK-së.

Aplikimet për grante dhe projekte

DMNK ka fituar një grant prej 60 mijë euro për ndërtimin e studiove dhe mini-regjisë në RTK.Projekti është në fazën e zbatimit dhe pritet të përfundojë në mars 2025.Studiot janë për programin për të rinj dhe fëmijë, dhe për emisionin kushtuar mjedisit "RTK Green".
DMNK ka realizuar disa emisione të transmetuara në RTK1 për fuqizimin e grave në Kosovë, të mbështetur financiarisht me 7 mijë euro nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), me presidentet Vjosa Osmani dhe Atifete Jahjaga, deputetet Saranda Bogujevci, Vlora Çitaku, Time Kadriaj, dhe zëvendëskryeministren Emilia Redžepi.
Gjatë vitit 2024, në RTK1 është transmetuar rubrika "Këshilla juridike", e realizuar nga OJQ"Clard Kosovo" mbështetur nga Ambasada e SHBA-së, duke i sjellë RTK-së të hyra financiare prej 21 mijë dollarësh amerikanë.
DMNK ka siguruar të drejtën e transmetimit të 52 serive "SKULD, a look into the future", pa kosto financiare për RTK-në, për transmetim në RTK1 dhe RTK2.
Janë zhvilluar takime online me përfaqësuesit e ERNO-së që RTK të jetë pjesë e projektit për Podcasts, në vlerë prej 21 mijë eurosh, për krijimin e një këndi, dhe sigurimin e pajisjeve të nevojshme, në kuadër të medieve online, për realizimin e podcasteve.

RTK është përfituese e projektit për fuqizimin e të rinjve në avancimin profesional, duke e bërë dallimin e lajmeve të rreme. Vlera e projektit është 1, 200 euro dhe dy gazetarë të rinj të medieve online kanë ndjekur trajnimet dhe kanë prodhuar storie për mediet online.

Trajnimet e stafit

DMNK ka siguruar trajnime për stafin e RTK-së në bashkëpunim me DW Akademie. Trajnimet kanë përfshirë In house training për gazetarët dhe redaktorët e RTK-së dhe trajnime për verifikimin e fakteve (Fact-Checking).Rreth 20 gazetarë, përfshirë edhe ata të komuniteteve, kanë marrë pjesë në trajnimin pesëditor me trajnerët e DW-së për "Storytelling"; dhe trajnerë për produksion, me inkuadrime online të trajnerëve të tjerë nga akademia e DW-së.

DMNK ka fituar një grant për trajnimin e stafit të RTK-së nga "Fulbright Specialist Program"me një specialist amerikan, i cili do të fillojë trajnimet në qershor 2025. DMNK ka koordinuar pjesëmarrjen e gazetarëve të RTK-së në trajnimet e organizuara nga COPEAM në Turqi përkatësisht në TRT që janë mbajtur në janar 2025.

DMNK ka vazhduar me zbatimin e projekteve nga memorandumi i bashkëpunimit me Goethe Institute dhe DW, "Innovation Media Minds", në ofrimin e ndihmës për stafin për aplikim në "International Mobility Grant". Nga ky projekt ka përfituar një redaktor i RTK-së duke qëndruar për 12 ditë në DW.DMNK në bashkëpunim me distribucionin e DW-së dhe Redaksinë e DW Evropa, është dakorduar për marrjen e një magazine të re televizive "Europeo", të realizuar nga DW për RTK-në, dhe një përmbledhje javore video material për zhvillimet në Gjermani, që zbatohet nga shkurti i vitit 2025.

Në koordinim me udhëheqësen e Qendrës për Aftësim Profesional në RTK është hartuar plani për fazën e tretë të trajnimit të stafit të RTK-së për Fact Checking me akademinë e DW-së. Po ashtu është planifikuar me departamentet për pjesëmarrjen e RTK-së në konferencën Brave New Media, ku u prezantua RTK.

Në koordinim me drejtoren e RTK 2, kryeredaktorët e RTK-TV dhe RTK-Radio kolegë janë dërguar disa në organizimin një javor të DW-së "NextGen Media Lab", që u mbajt në Tiranë.

DMNK ka kontribuuar në organizimin e edicionit të dytë të Festivalit të Këngës së RTK-së, duke siguruar transmetimin e ngjarjes me teknologji moderne dhe bashkëpunimin me transmetuesin publik të Malit të Zi (RTCG).

DMNK ka organizuar shënimin e 25-vjetorit të themelimit të RTK-së, duke përfshirë intervista me ish-drejtuesit e RTK-së dhe mbulimin medial të ngjarjes.

DMNK e ka realizuar ndarjen e mirënjohjes për "JICA-n", me rastin e përvjetorit të RTK-së. DMNK-së ka zhvilluar takime dhe është koordinuar me përfaqësues të organizatave dhe mediave të ndryshme ndërkombëtare, si NDI, Zyra e BE-së në Kosovë, USAID, GIZ, Prix Italia, RAI, DW, JICA, NHK, për të biseduar mbi projekte dhe bashkëpunime të mundshme.





Studiot e reja te financuara nga fondet e BE-se, implementuar nga Goethe Instituti.

Shtojca- Tabela e projekteve

Projektet e realizuara	Përshkrimi i Projektit	Përfitimet e RTK-së
RTK- DW-Goethe	Ndërtimi i skenografive për të rinjë dhe për RTK Green si dhe regjia ditore	60 mijë euro
RTK-NDI	Prodhim programor-Fuqizimi i gruas	Realizimi teknik është mbështetur nga NDI dhe USAID, në vlerë prej 7,000 Euro.
CLARD KOSOVO	Transmetimi i emisionit për Këshilla Juridike	21,000 USD
FULBRIGHT SPECIALIST PROGRAM	Trajnimi i stafit të RTK-së nga një ekspert amerikan	Avansimi profesional i stafit (kostoja e udhëtimit dhe pagesa e trajnimit nga specialisti mbulohen nga programi Fulbright)
RTK-DW-GOETHE	Projekti i mobilitetit- Një redaktor është dërguar në Gjermani	Avansimi profesional i stafit (Shpenzimet e redaktorit janë mbuluar komplet nga Goethe Institute)
ERNO	Trajnim për gazetarë rreth realizimit të videove në mediet online- Fuqizimi i të rinjëve që të dallojnë fake news.	1,200 euro
DW Akademi	Trajnimi “IN HOUSE’ i stafit të Dhomës së Lajmeve	Avansimi profesional i stafit (Shpenzimet e trajnerëve janë mbuluar komplet nga Goethe Institute)
DW Akademi	Trajnimi i stafit për ‘Fact Checking’	Parapërgaditje për themelimin e departamentit (Shpenzimet e trajnerëve janë mbuluar komplet nga Goethe Institute)
RTK - JICA	Hapja e zyrës rajonale në Pejë	Shtrirja e pranisë në të gjitha rajonet

COPEAM	Trajnimi i stafit të RTK-së	Avansimi profesional i stafit (Akomodimi dhe trajnimi i stafit të RTK-së është mbuluar nga COPEAM)
RTK - NHK	Realizim i dokumentarit për të mbijetuarit e Dhunës seksuale në Kosovë	Vlera e përgjithshme e realizimit të dokumentarit nga ana e NHK-së është 140,000 euro, ndërkaq që kontributi i RTK-së me pajisje teknike dhe asistencë nga resurset humane është vlerësuar të jetë 18.400 euro

23. Departamenti i marketingut

Sikur edhe vitin paraprak plani strategjik i **Departamentit të Marketingut (DM)** bazohet mbi programin e ofruar si në **RTK-TV** ashtu edhe në **RTK-Radio**. Pika kryesore e përqëndrimit për vitin 2024 është **UEFA Liga e Kampionëve** dhe transmetimi i drejtpërdrejt i edicionit të dytë të **"Festivalit të Këngës së RTK-së".**

Gjatë vitit 2024 nga Departamenti i Marketingut në RTK janë realizuar të hyra nga reklamat në vlerë prej **715,578.74** euro. Këto të hyra në masën prej **96 për qind** janë realizim kryesisht në **RTK1**. Struktura e të hyrave për vitin 2024 është pothuajse a barabartë nga të hyrat me pagesë në krahasim nga të hyrat me kompensim, përkatësisht: **336,025.64** euro ose rreth **47 për qind** me pagesë dhe **379,553.10** euro ose rreth **53 për qind** me kompensim.

Gjatë vitit 2024 në mesin e terminëve me te kërkuara ishin blloku i reklamave para dhe pas Lajmeve Qendrore, Programi i Mëngjesit, Blloku 21:00, Emisioni i Pasdites.

Festivali i Këngës në RTK, përveç tjerash pati ndikim pozitiv edhe në marketing me përkatësisht **77,616.00** euro të hyra nga oferta speciale dedikuar hapësirës reklamuese për 3 ditë të Festivalit.

Hapësira reklamuese ka qenë e shpërndarë në **384,434 sekonda** (**1053 sekonda** mesatarisht për çdo ditë) nëpër blloqe të rregullta të reklamave të paraqitura në çmimore si dhe në oferta speciale për ngjarje të ndryshme kulturore dhe sportive.

Gjatë vitit 2024 në RTK, në RTK dominoi blloku i reklamave që transmetohet para dhe pas lajmeve kryesore si për nga sasia e sekondave ashtu edhe për nga vlera. Më 2024 sipas statistikave rezulton se Festivali i Këngës edhepse ka zgjatur vetëm tri ditë ka realizuar reklama më shumë se çdo emision tjetër i transmetuar në RTK, përveç bllokut para lajmeve qendrore.

Gjatë vitit 2024 është përcjellë trendi i njëjtë me vitin paraprak, ku ka pasur dy sponsor për këtë ngjarje të madhe kulturore . Viti 2024 si risi e ka pasur UEFA Ligën e Kampionëve që ka ngjallë

interesim më të madh krahasuar me vitet e kaluara.
Në vitin 2024, nga marketingu ka pasur të hyra në vlerën prej **13,611.05 euro**, dhe kjo vlerë është vetëm prej muajit shtator, gjë që nënkupton se priten hyrje të reja edhe gjatë vitit 2025.

VLERA TOTALE E KONTRATAVE TË NËSHKRUARA GJATË VITIT 2024 NË RTK-TV DHE RTK-RADIO				
RTK	**NUMR I KONTRATAVE**	**VLERA**	**KOMPENSIM**	**PAGESA**
	52 kontrata	**719,296.33€**	**318,786.85€**	**400,509.45€**
	TOTALI	**719,296.33 €**		
	PËRQINDJA		**44.3%**	**55.7%**
TOTAL				**719,296.33 Euro**

OFERTAT SPECIALE

Për ngjarje të ndryshme sportive dhe kulturore gjatë vitit 2024 klientëve u janë ofruar oferta speciale varësisht nga periudha kohore e vitit. Brenda 12 muajve të vitit janë përpiluar 11 oferta me mundësi të ndryshme reklamimi në RTK. Oferta që ka sjellë më së shumti të hyra është Oferta Speciale e Festivalit të Këngës, pasuar nga oferta e programit të Vitit të Ri. Gjatë vitit 2024 janë dhënë gjithsej 14 oferta.

Ofertat speciale të publikuara gjatë vitit 2024 janë si në vijim: Oferta speciale për Ligën e Kampionëve + aneksi; Oferta për emisionin Arena; Oferta speciale për Festivalin e këngës ne RTK; Oferta speciale për futboll–muaji mars; Oferta për emisionin e Metropol; Oferta promocionale-PopUP; Oferta speciale për Lojërat Olimpike; Oferta futboll për muajin korrik; Oferta Speciale e majit me pako; Oferta e emisionit "Vera n'RTK"; Oferta verore për Radio Kosovën; Oferta për banka; Oferta Speciale e Nations League; Oferta e Vitit të Ri 2025.